



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Libohovë

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
MBI
Auditimin Financiar

BASHKIA LIBOHOVË

Tiranë, Korrik 2024

PËRMBAJTJA		Faqe
I.	PËRMLEDHJE EKZEKUTIVE	3-6
1	Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit	3-4
2	Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4-5
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	5-6
II.	HYRJA	6-11
1	Objektivat dhe qëllimi	7-7
2	Identifikimi i çështjes	7-7
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	7-8
4	Përgjegjësitë e audituesve	8-8
5	Kriteret e Vlerësimit	8-9
6	Standartet e auditimit	9-10
7	Metodat e auditimit	10-11
8	Dokumentimi i auditimit	11-11
III.	PËRSHKRIMI AUDITIMIT	11-64
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	11-11
2.	Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit	11-64
2.1	Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin	11-14
2.1.1	Mbi auditimin e brendshëm	14-16
2.2	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit për vitin 2023	16-38
2.3	Opinioni mbi pasqyrat financiare të vitit 2023	38-58
2.4	Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme	59-64
2.5	Të ndryshme të dala gjatë auditimit	64-64
IV.	REKOMANDIME	64-76
V.	ANEKSE	76-84

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim.

Bashkia e Libohovës është njësi vendore institucion i pavaruar, ku pas ndarjes së re territoriale është një bashkim mes qytetit dhe dy ish-komunave në afërsi të tij, pra në total ka 3 njësi administrative si vijon: njësia administrative Libohovë (qyteti), njësitë administrative Qendër Libohovë dhe Zagorie, Qyteti Libohovë.

Misioni i Bashkisë Libohovë është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve, duke garantuar vetë-qeverisjen në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore.

Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

Buxheti i Bashkisë Libohovë si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavaruar, nga transfertat e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transfertat specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave ndërkombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore” nenit 50 “Auditi i jashtëm” pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: “1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësisve të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë”. Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Libohovë si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

c. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare, e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësim me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Bashkia Libohovë. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.
- mbi planifikimin, zbatimin e monitorimin e planit të buxhetit.
- mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në pasqyrat financiare.
- mbi zbatimin i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme. Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

e. Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 18 gjetje dhe ka dhënë 22 rekomandime, nga ku masa organizative me 10 gjetje dhe 12 rekomandime, 1 gjetje-rekomandime për eliminimin e efekteve negative financiare, 7 gjetje dhe 9 rekomandime

në vlerën 27,870,634 lekë në fushën për uljen e borxhit tatimor, për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore. Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me:

▪ **Procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave**

- Të ardhura të munguara në vlerën 5,693,659 lekë nga mosarkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga debitorë e biznesit.

- Të ardhura të munguara në vlerën 11,524,426 lekë nga mosarkëtimi i taksës së nga debitorë familje.

- Të ardhura të munguara në vlerën 8,820,702 lekë nga mosarkëtimi i taksës së tokës nga fermerët debitorë.

- Të ardhura të munguara në vlerën 138,887 lekë nga mosarkëtimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë nga 5 persona debitorë.

- Të ardhura të munguara nga mosarkëtimi i tarifës së qirasë në vlerën 374,003 lekë nga 11 qiramarrës, për 7 kontrata nuk janë shlyer detyrimet në vlerën 285,586 lekë të kontratave për dhënien me qira të tokës bujqësore si dhe për 4 kontrata qiraje të pyjeve dhe kullotave nuk janë shlyer detyrimet në vlerën 88,417 lekë.

-Nga auditimi konstatohet se, në gjendjen e **llogarisë 214** “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” për vlerën historike 15,330,645 lekë, është përfshirë vlera prej 742,167 lekë me emërtimin “Vlerë tjetër”, e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunave të Bashkisë Libohovë e paanalizuar e cila ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Poashtu u konstatua se: **Kjo llogari ka pasaktësi në vlerat e paraqitura për mos kontabilizimin e vlerës 14,265,168 lekë**, për mallra të ndryshme të bëra hyrje në magazinë si më poshtë:

-Me flete hyrje nr. 15 datë 23.03.2023 janë bërë hyrje në magazinë mallra si: Tuba plastike, shtylla metalike ndricimi, krahë shtyllash, kabëll elektrik, puseta plastike dhe artikuj të ngjashëm në vlerë prej **5,358,874 lekë**, ardhur nga Fusha shpk.

-Me fletë hyrje nr.27 datë 03.05.2023 janë bërë hyrje në magazinë mallrat, cemento dhe hekur betoni në vlerën **6,795,276 lekë**, ardhur nga furnitori V shpk.

-Me fletë hyrje nr.29/1 janë bërë hyrje në magazinë mallrat, cemento në vlerën **2,111,018 lekë**, ardhur nga furnitori V shpk.

Mos kontabilizimi i vlerës **14,265,168 lekë**, në Bilancin Kontabël të vitit 2023 ka sjellë një paraqitje jo të saktë për këtë llogari ekonomike dhe me deformim të informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2023 të **llogarisë 214** “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune”.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore: Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Sektori i Tatim Taksave Bashkia Libohovë, të marrë masa për identifikimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitetet në territorin administrativ të bashkisë, me qëllim përditësimin e regjistrit të taksave dhe tarifave për bizneset, si dhe në vijim nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët.

-Sektori i Tatim Taksave Bashkia Libohovë të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët e mundshme ligjore për arkëtimin e debitorëve në vlerën **5,693,659 lekë**.

- Sektori i Tatim Taksave Bashkia Libohovë të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej **138,887 lekë**, me qëllim eliminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë.

- Sektori i Tatim Taksave në bashkëpunim me sektorin e Bujqësisë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitorë **374,003 lekë**, të cilat janë detyrime kontraktuale të papaguara nga 11 qiramarrësit e tokës bujqësore.

- Sektori i Tatim Taksave Bashkia Libohovë në bashkëpunim me Administratorët e Njësisë Administrative, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve të pataksuara me taksat/tarifa vendore, përditësimin e regjistrit të familjeve, me qëllim reduktimin e të ardhurave të munguara, si rrjedhojë e mostaksimit të plotë të kategorisë “Familje”, ku vetëm në përllogaritjen e tarifës së pastrimit dhe shërbimit për vitin 2023, rezultojnë **1,769,280 lekë** të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Libohovë.

- Kryetari i Bashkisë Libohovë dhe Sektori i Tatim Taksave, të marrë masat e nevojshme, për të analizuar situatën e krijuar me efekt mosarkëtimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore nga abonentët familjarë, si dhe vlerësimin e mundësisë për lidhjen e marrëveshjes me agjentin tatimor UK Sh.A Libohovë me qëllim që taksat dhe tarifat vendore për kategorinë “Familjar” të mblidhen nëpërmjet faturës së ujit të pijshëm.

- Sektori i Tatim Taksave Bashkia Libohovë të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej **11,524,426 lekë**, me qëllim eliminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë.

- Sektori i tatim Taksave Bashkia Libohovë të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej **8,820,702 lekë**, me qëllim eliminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë.

-Kryetari i Bashkisë Libohovë dhe Sektori i Financës të marrë masa për likuidimin në kohë të të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, duke paraqitur pranë degës së thesarit, të gjithë dokumentacionin përkatës brenda afatit 30 ditor nga momenti i prerjes së faturës.

-Planifikimin e grafikut të likuidimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

Nëpunësi zbatues të marrë masa për identifikimin e aktiveve që përfaqësojnë shumat e rregjistruara në kontabilitet me emërtimin “Vlerë tjetër”, dhe kjo vlerë të shtohet në vlerën e aktivitetit përkatës, në mënyrë që llogaritë përkatëse të pasqyrave financiare të jenë të mbështetura me dokumentacion të qartë vërtetues.

-Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore të marrë masa për:

-Kryerjen e ndryshimeve të nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit me qëllim përcaktimin e qartë të detyrave për çdo pozicion pune.

-Gjithashtu të kryhen ndryshimet e nevojshme në strukturën organizative, ku për çdo sektor të jenë punonjës në përputhje me funksionet dhe përshkrimet e punës që kryejnë.

-Hartimin dhe zbatimin e programit të trajnimit të stafit të bashkisë, me qëllim zhvillimin profesional të tyre, si dhe hartimin e hartës së proceseve të punës në Bashkinë Libohovë.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit

Opinion mbi Pasqyrat Financiare të vitit 2023:

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Libohovë për periudhën ushtrimore 01.01.2023–31.12.2023, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

*"Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Libohovë janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të modifikuar, me rezervë**”, e shprehur kjo në bazën për opinionin.*

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare:

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare- Udhëzues për SAI. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 8,3 milion lekë, llogaritur mbi shpenzimet faktike të vitit 2023, si dhe anomalitë e mëposhtme:

-Për llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” pasqyrohen aktive në vlerën 5,645,745 lekë, me emërtimin “Vlerë tjetër”, në llogarinë 212 “Ndërtime konstruksione” pasqyrohen aktive në vlerën 4,687,737 lekë, me emërtimin “Vlerë tjetër”, në llogarinë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” pasqyrohen aktive në vlerën 8,296,835 lekë, me emërtimin “Vlerë tjetër” dhe në llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” pasqyrohen aktive në vlerën 742,167 lekë, me emërtimin “Vlerë tjetër”. Për këto katër zëra sipas klasave respektive në shumën totale 19,372,484 lekë nuk disponohet dokumentacion kontabël, mbi origjinën e tyre, duke mos evidentuar se çfarë përfaqësojnë këto vlera në kontabilitet dhe në inventarin fizik.

-Për llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” dhe llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” 215 “Mjete Transporti” për vitin ushtrimor 2023 nuk është përlllogaritur vlera e amortizimit.

-Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” nuk paraqet gjendjen reale, pasi në këtë llogari nuk përfshihet vlera e trojeve nën objekt, si trualli i godinës së bashkisë, trojet e ndërtesave të shkollave, kopshteve e çerdhe, shtëpisë së kulturës, të zyrave në Njësi Administrative etj.

-Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione”, paraqitur në vlerën 0 lekë në bilancin kontabël, nuk paraqet gjendjen reale, pasi për këtë llogari nuk është kryer vlerësimi i gjendjes fizike dhe vlerësim monetar i 12,140 ha prona, nga të cilat 7,918 ha kullotë verore, 3.006 ha pyll, 1,027 ha kullotë dimërore, 146 ha tokë inproduktive, 42 ha djerrë, 1 ha tokë buke, 814 ha kullotë dimërore, 864 ha kullotë të transferuara sipas VKM-ve përkatëse.

-Llogaria 212 “Ndërtime e Konstruksione” paraqitet në vlerën 272,570,167 lekë, por kjo llogari nuk paraqet gjendjen reale të pasurisë së njësisë vendore, sepse për një pjesë e objekteve të mbartura nga ish komunat nuk disponohet dokument pronësie.

-Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, nuk paraqet vlerën reale pasi nuk është vlerësuar dhe evidentuar në këtë llogari vlera e rrugës prej 29 kilometra, kaluar në pronësi të Bashkisë Libohovë me VKM nr. 915, datë 11.11.2015.

-Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” nuk paraqet vlerën reale pasi nuk është bërë kontabilizimi i vlerës 14,265,168 lekë, mallra të adhur pa pagesë nga FSHZH dhe të bëra hyrje e dalje nga magazina.

- U konstatuan detyrime për taksat dhe tarifatat vendore në vlerën 27,870,634 lekë;

- U konstatua mos taksim i plotë i kategorisë taksapaguese “Familje”, për tarifatat e ndriçimit, gjelbërimit dhe pastrimit për vitin 2023, në vlerën 11,524,426 lekë;

- Vlera e detyrimeve për taksën e tokës bujqësore është 8,820,702 lekë.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. prot., 435/1, datë 03.04.2024, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 08.04.2024 deri në datë 10.05.2024, në subjektin Bashkia Libohovë për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023 u krye auditimi “Mbi Auditimin Financiar”, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. A. G., përgjegjës grupi;
2. A. D., auditues;
3. R. L., auditues.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objektivat e auditimit.

Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Bashkinë Libohovë kishte si objektiva kryesore:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;
- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)³;
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

Qëllimi i auditimit.

Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Libohovë është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim 2023, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

Identifikimi i çështjes.

Raporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësi të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Libohovë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Fushat të cilat u audituan janë si vijon:

1. Aktiviteti i Njesisë së Auditit të Brendshëm;
2. Implementimi dhe zbatimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit;
3. Planifikimi dhe zbatimi i planit të buxhetit;
4. Raportimi financiar;
5. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Niveli drejtues i Bashkisë Libohovë (Kryetari i Bashkisë, në rolin e Nëpunësit Autorizues të institucionit) dhe niveli i mesëm drejtues (Përgjegjësi i Sektorit të Financës, në rolin e

Nëpunësit Zbatues), kanë përgjegjësinë për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me bazën ligjore në fuqi për raportimin financiar; Për krijimin e kontroleve të brendshme të nevojshme, për të mundësuar përgatitjen e drejtë të pasqyrave financiare, pa keq-raportime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit; dhe kryerjen e detyrave funksionale në përputhje me kuadrin ligjor, që përcakton dhe rregullon veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit.

Gjithashtu Kryetari i Bashkisë Libohovë, Përgjegjësit e sektorëve pranë Bashkisë Libohovë kanë përgjegjësinë për kryerjen e detyrave funksionale në përputhje me kuadrin ligjor, që përcakton dhe rregullon veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit.

Përgjegjësitë e audituesve.

Përgjegjësia e audituesve është të shprehin konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim, pra nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë pozicionin financiar dhe rezultatet financiare të njësisë ekonomike janë në përputhje me kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi (ISSAI 1200.3). Audituesit janë përgjegjës për përgatitjen e Raportit të Auditimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, duke respektuar kërkesat etike, duke planifikuar dhe kryer auditimin, sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së arsyeshme. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, qoftë nga mashtrimi ose gabimi.

Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozonë që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe raportimit të shifrave në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi profesional i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë gjithë procesit të auditimit, audituesi duhet të ushtrojë gjykim dhe skepticizëm profesional dhe ndër të tjera: Identifikon dhe vlerëson risqet e keq-pasqyrimit material, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, bazuar në të kuptuarit e entitetit dhe mjedisit të tij, përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë. Merr evidencat e duhura dhe të mjaftueshme për të vërtetuar ekzistencën e keqraportimeve materiale. Formon një opinion për pasqyrat financiare dhe objektivat shtesë mbi të cilat raportimi është i detyrueshëm bazuar në përfundimet e nxjerra nga evidencat e grumbulluara. (ISSAI 1200.7) Raporton rastet e mospërputhshmërisë me bazën ligjore, përfshirë buxhetin dhe përgjegjshmërinë, dhe/ose Raporton mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

Kriteret e vlerësimit. Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Në fushën e Menaxhimit financiar dhe kontrollit: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm publik”; Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësisë të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Nëpunësi Zbatues”; Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 “Për miratimin e manualit të MFK”; Urdhri i ministrit Financave nr. 100, dt. 16.10.2017 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”.

- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar: Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”; Ligji nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” dhe Ligji nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, si dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje;

Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” i ndryshuar; VKM 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”; Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” etj.; Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”; Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit e vitit 2021”, pikat 88-125; Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit e vitit 2023”, pikat 95-122; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”.

- Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare: Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”; VKM nr. 248, date 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; Udhëzimi përbashkët i Ministrisë së Çështjeve Vendore dhe Ministrisë Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”, udhëzimi i MFE nr. 26, datë 27.9.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore” .

- Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar”; Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave lokale”, i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar; VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime; VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave: Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 152-2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, i ndryshuar; VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë”, i ndryshuar; VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për pagat e vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar.

- **Standardet e auditimit.** ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”; ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit,

ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

Metodat e auditimit. Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Në gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

*Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin*¹. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

- *Kontrolli aritmetik.* Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve).

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.* Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.* Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

- *Kontrolli i vlerësimit.* Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- *Konfirmim nga të tretët.* Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

- *Kontrolli sipas një treguesi.* Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashhtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsisë kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.

- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

¹ *ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.*

- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.
- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

Dokumentimi i auditimit.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Me shkresën nr. 435/3, datë 27.05.2024, nga grupi i auditimit të KLSH është nisur Projektraporti i Auditimit në të cilën u evidentuan mangësitë e konstatuara gjatë procesit të auditimit, mangësi të cilat nuk kishin argumentin e duhur ligjorë gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, i cili i përcillet subjektit për përmisimin e gjendjes në të ardhmen.

III.PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

Bashkia është person juridik. Ky autoritet ushtrohet nëpërmjet akteve të këshillit dhe kryetarit të bashkisë si organe të zgjedhura, në përputhje me kompetencat dhe në ushtrimin e funksioneve qeverisëse që ato kanë në bazë të ligjit.

Auditimi në subjektin “Bashkia Libohovë”, u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për t’u audituar. Në këtë subjekt, *u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi që në gjykimin profesional të pavarur janë materiale por jo të përhapura, etj.*

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi i auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, auditimeve të realizuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, fondet e shpenzuara dhe të ardhurat e arkëtuara, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

2. Përshkrimi i Auditimit, Sipas drejtimeve të auditimit.

2.1. Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe Auditimi i Brendshëm.

Në zbatim të nënpikeës 1.1 të programit të auditimit: “Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi dhe Komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës

vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike”, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

1. Rregullorja e brendshme e miratuar;
2. Kod i brendshëm etik ose një kod sjellje, apo udhëzim për zbatimin e etikës;
3. Strukturën organike të institucionit me ndryshimet për vitet objekt auditimi dhe nëse ka pasur ndryshime në strukturë, a është reflektuar edhe në rregullore;
4. Shkresat e përcaktimit të NA në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;
5. Shkresat për krijimin e grupeve të Menaxhimit Strategjik;
6. Trajnimet e stafit si dhe planifikimet për trajnime të tyre;
7. Strategjinë dhe Regjistrin e Riskut;
8. Lista ose harta e proceseve të punës;
9. Raportet e Monitorimit;
10. Pyetësi i Vetëvlerësimit.

Drejtimit kryesore të auditimit të MFK-së janë:

- Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.
- Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi/Komunikimi, si dhe Monitorimi.
- Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.

Krijimi dhe zbatimi i sistemit të kontrollit të brendshëm financiar në njësitë e sektorit publik është thelbësor për sigurimin e mirëmenaxhimit financiar, që mundëson realizimin e qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara në mënyrë etike, duke shfrytëzuar burimet në mënyrë të ligjshme, ekonomike, efektive dhe eficiente. Për shkak të kompleksitetit të tij, sistemi i kontrollit të brendshëm financiar publik kërkon monitorim dhe vlerësim të vazhdueshëm të përshtatshmërisë dhe funksionalitetit të tij, proces i cili realizohet nëpërmjet vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, performuar dhe raportuar nga nëpunësit autorizues të njësisë të qeverisjes së përgjithshme si dhe nëpërmjet shërbimit të auditimit të brendshëm e të jashtëm.

Në drejtim të vlerësimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Libohovë, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimin e objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “*Mjedisi i Kontrollit*”, “*Menaxhimi i Riskut*”, “*Aktivitetet e Kontrollit*”, “*Informimi dhe Komunikimi*” si dhe “*Monitorimi*”, sipas përcaktimit të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” i ndryshuar, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijon dhe vlerëson sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit, si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

Bazuar në vlerësimin e kryer për zhvillimin dhe funksionalitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme për vitin 2023, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor e rregullator në fuqi për fushën e kontrollit të brendshëm të cilat në gjykimin profesional të grupit të auditimit ndikojnë në progresin e funksionimit të këtij sistemi dhe justifikojnë paraqitjen e një konkluzioni për vlerësimin e kryer, duke e vlerësuar sistemin e kontrollit të brendshëm pjesërisht efektiv.

Akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa procedura në lidhje me 5 komponentët si:

“Mjedisi i Kontrollit”

- Nuk dokumentohet komunikimi dhe trajnimi i burimeve njerëzore të rekrutuar gjatë vitit 2023 mbi rregulloren e brendshme.
- Nuk dokumentohet procedura e ndjekur për komunikimin dhe njohjen e stafit të Bashkisë Libohovë për ndryshimet ligjore të ndodhura në fusha të ndryshme.
- Për vitin 2023 nuk është hartuar dhe miratuar plani i veprimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.
- Në Strukturën organizative nuk janë përcaktuar qartë ndarja e detyrave konkrete ligjore që do kryhet dhe përcaktuar punën e secilës strukturë në veçanti si dhe të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.
- Sektori i Tatim Taksave nuk është në përputhje me funksionet që kryen ky sektor, konkretisht, magazinieri, shoferi i administratës dhe mirëmbajtësi i godinave nuk kryejnë funksionet e përcaktuara në nenin 44 të rregullores së Bashkisë Libohovë, për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore.
- Në rregulloren e brendshme, jo për çdo strukturë të Bashkisë Libohovë, përcaktohet afati për raportimin ndaj eprorit, mbi realizimin e planit të punës/objektivave.
- Në Bashkinë Libohovë nuk janë hartuar “Hartat e proçeseve të punës”.
- Përsa i përket rritjes së kapaciteteve në fushën e MFK-së, nuk është parashikuar dhe hartuar një program trajnimi, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet dhe zbatimin e kërkesave kryesore në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit përveç trajnimeve që janë organizuar nga ASPA.
- Bashkia Libohovë nuk ka miratuar plan pune vjetore lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik”.
- Nuk administrohen proçesverbalet e takimit të GMS, për të dokumentuar funksionimin e këtij grupi.
- Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.
- Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

“Menaxhimi i Riskut”

- Nuk është hartuar ende plani i përgjithshëm strategjik të zhvillimit (afat 5 vjeçar).
- Nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut.
- Nuk ka raportim të riskut operacional, për shkak të strukturave të pa plotësuar.
- Nuk dokumentohet monitorimi i risqeve nga çdo drejtues pranë Bashkisë Libohovë.

“Aktivitetet e Kontrollit”

- Bashkia Libohovë nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm.
- Në Bashkinë Libohovë nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.
- Në Bashkinë Libohovë, Sektori i Financës për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin EXCEL dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë. Sektori i të Ardhurave nuk ka një sistem informatik për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, por veprimet kryen në programin EXCEL, pra edhe këtu niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë.
- Nuk ka procedurë të shkruar specifike për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve.

“Informimi dhe Komunikimi”

- Sistemi i raportimit nuk ofron informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësisive të varësisë të saj.
- Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut.

“Monitorimi dhe Raportimi”

- Proçedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, por nuk administrohen raportimet e drejtuesve të drejtorive përkatëse për përmbushjen e objektivave.

-Bashkia Libohovë lidhur me pyetësin e vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe deklaratën e cilësisë për vitin 2023 nuk e ka raportuar në MFE.

Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, duke ngarguar me përgjegjësi: *Znj. E. P, me detyrë ish përgjegjëse e sektorit të Financës, Z. Xh. T, me detyrë Z/Kryetar i Bashkisë dhe Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Burimeve Njerëzore.*

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;

Udhëzimi nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”;

Manuali i MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016, i ndryshuar.

Nga ana e subjektit nuk janë paraqitur observime. Sa më sipër në mos përgjigje në afatet e caktuara, Projekt Raporti i Auditimit, konsiderohet i mirëqenë dhe u vijua me hartimin Raportin Përfundimtar të Auditimit.

2.1.1. Auditim mbi organizimin e njësisë së auditit të brendshëm dhe vlerësimin e veprimtarisë së njësisë së auditit të brendshëm.

Në zbatim të pikave 1.2 dhe 1.3 të programit të auditimit, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

1. Karta e Auditimit të Njësisë Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Libohovë;
2. Plani Strategjik dhe vjetor, si dhe pasqyrat shoqëruese;
3. Programimi i auditimeve të brendshme për vitin 2023;
4. Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm;
5. Dosjet e përhershme të subjekteve të audituara;
6. Rekrutimi i punonjësve në Njësinë e Auditimit të Brendshëm, dhe ngritja e nivelit profesional të tyre.

Përshkrimi i situatës mbi krijimin dhe përbërjen e strukturës së njësisë së auditit të brendshëm.

Auditimi i Brendshëm në Bashkinë Libohovë, është siguruar *si shërbim auditimi* me akt marrëveshjen të lidhur midis titullarëve të njësisë Bashkia Dropull dhe Bashkia Libohovë, me nr. 328/1 prot., të ofertuesit dhe nr. 319 prot., të përfituesit, datë 15.03.2016, miratuar nga Ministri i Financave me shkresën nr. 4152/1 prot., datë 01.04.2016, **rikonfirmuar** me shkresën e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8447 prot., datë 12.05.2021, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10, shkronja “c”, si dhe neni 64, shkronja “a” të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, pikat 3 dhe 6, te VKM nr. 83, datë 3.2.2016, pika 6 shkronja “a”, “Për miratimin e Kriterëve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”.

Struktura e Auditimit të Brendshëm, në Bashkinë Dropull, *e cila jep shërbim dhe në Bashkinë Libohovë* në mbështetje të Akt marrëveshjes, ka filluar funksionimin e saj nga muaji Prill 2016, me emërtesën “Njësia e Auditimit të Brendshëm”, e cila, për vitin 2023 funksionon në nivel drejtorie (*sipas vendimit të Këshillit të Bashkisë nr. 64, datë 24.11.2022, vendim i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr.1164/1 datë 09.12.2022*).

-Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe që ndodhet pranë zyrës së burimeve njerëzore në Bashkinë Dropull, konstatohet se stafi i NJAB për vitin 2023, është

organizuar me 5 punonjës, në nivel drejtorie me strukturë 1 drejtues njësie, 1 përgjegjës sektori dhe 3 auditues.

Njësia e Auditit të Brendshëm përgjatë vitit 2023, ka në përbërjen e saj 3 punonjës, përkatësisht 1 drejtues, 1 përgjegjës sektori dhe 1 specialist auditimi, ku i gjithë stafi është i çertifikuar. Në tabelën e mëposhtme është paraqitur Struktura e sektorit të Auditit të Brendshëm.

Tabela nr.1, Struktura e Njesisë AB për vitin 2023

Nr	Periudha	Funksioni	Emëruar	Arsimimi	Vjetërsi në punë	Vjetërsi në auditim/vite	Çertifikimi	Trajnime të vijueshme
	Për vitin 2023							
1.	S. K	Drejtori i Njesisë	04.04.2016	Ekonomist	39	31	Ne vitin 2005	Po
2.	M. M	Përgjegjës Sektori	01.04.2016	Ekonomiste	35	28	Ne vitin 2005	Po
3.	A. P	Auditues	20.04.2018	Financier	15	5	Ne vitin 2019	Po

Burimi: NJAB Libohovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Përshkrimi i situatës mbi aktivitetin e NJAB për vitin 2023.

Plani strategjik për periudhën 2023 – 2025, si dhe plani vjetor për vitin 2023, janë hartuar sipas kërkesave të nenit 18/2, të ligjit organik mbi auditimin dhe të seksionit 3, kreu II të “Manualit për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, si dhe të nenit 14, të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të cilat janë miratuar nga Titullari i Bashkisë Libohovë, me shkresën nr. 1411 prot., datë 19.10.2022, si dhe i janë dërguar strukturës përgjegjëse Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, me shkresën nr. 1773 prot., datë 19.10.2022. Në zbatim të planit vjetor, janë miratuar programet për auditimin e 4 subjekteve, si më poshtë:

Tabela nr.2

Nr	Periudha	Të dhëna sipas raportimit									
		Auditime të planifikuara	Auditime të realizuara	Nga të realizuarat, sipas llojit						IT	Zb.Rek
				Përputh	Financ	Kombin	Perform	Tematik			
1	Viti 2023	5	5	4						1	

- Raporti Vjetor i Veprimtarisë Audituese i miratuar nga titullari i institucionit për vitin 2023, është dërguar me shkresën nr. 231 prot., datë 13.02.2024, në Drejtorinë e Hamornizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE, bashkëlidhur ndodhen edhe pasqyrat shoqëruese. Dokumentacioni është dërguar në afat shoqëruar edhe me pjesën përshkruese të raportit i përgatitur sipas standardeve që përcakton Manuali i Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, Pika 3.6.

Nga auditimi i raportimit për vitin 2023, rezulton se janë dhënë 31 rekomandime gjithsej. Rekomandimet janë pranuar të gjitha, prej të cilave janë zbatuar 4 dhe 24 janë në proces zbatimi. Në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelë si vijon:

Tabela nr. 3, Në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelë si vijon:

Nr	Viti	Të dhëna sipas Raportimit				Sipas Raportimit			
		Rekomandime të shprehura në numër				Rekomandime të shprehura në vlerë (shpërblim demi) në 000/lekë			
		Gjithsej në numër	Zbatuar	Në proces	Pa Zbatuar	Gjithsej në vlerë	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar
1	2023	31	4	8	19	1683,3		345	1338,3
Totali		31	4	8	19	1683,3		345	1338,3

Burimi: NJAB Libohovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Dosjet koherente të NJAB për auditimet e realizuara për periudhën objekt auditimi në përgjithësi janë mbajtur të plotësuara në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli VI, në të është i përfshirë i gjithë informacioni dhe dokumentet e nevojshme. Analiza e detajuar mbi dokumentacionin që përmbajnë dosjet e angazhimeve të realizuara për vitin 2023 nga NJAB.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua se:

-Nuk është gëritur Komiteti i Auditimit.

-Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla objektive për titullarin e njësisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar.

-Nuk janë kryer auditime të teknologjisë së informacionit.

-Nuk është kryer vlerësimi i riskut për çdo subjekt/fushë që përbën objekt të auditimit nga NJAB. Konkretisht nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konstatohet se vlerësimi i riskut është bërë për 5 subjekte/fusha auditimi, ndërkohë janë 21 subjekte/fusha objekt i punës audituese të NJAB Bashkia Libohovë.

-Për periudhën 2023, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim aktivitete që kryen Bashkia Libohovë, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë, si Sektori i Financës dhe Buxhetit, Sektori i Prokurimeve, Sektorin e Tatim Taksave, Sektori i Bujqësisë, pasi për fusha të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit.

-Raportimi mbi aktivitetin vjetor 2023 të sektorit të auditimit të brendshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, nuk është sipas strukturës së miratuar, pasi nuk jepet informacion për veprimet e ndërmarra nga titullari i njësisë publike për zbatimin e rekomandimeve, si dhe për çdo rekomandim të pazbatuar.

-Nuk ka gjetur zbatim Urdhri i MFE nr.4, datë 10.01.2020 “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhërin nr.100, datë 25.10.2016”, lidhur me strukturën e Projekt Raportit dhe Raportit Përfundimtar të Auditimeve të kryera në vitin 2023, si dhe dhënien e opinionit në përfundim të auditimit.

Për sa më sipër mbanë përgjegjësi S. K, Drejtor i Njësisë së Auditit të Brendshëm.

Këto veprime janë në kundërshtim me shkronjën “b” në nenin 6, pika 1 në nenin 9, shkronja “b” në nenin 12, shkronja “ç” në nenin 14, shkronja “d” në nenin 16 të Ligjit nr.114/2015 “Për Auditin e Brendshëm Publik”, i ndryshuar.

Urdhrin nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhërin nr.100, datë 25.10.2016”.

Udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar, planifikimi i veprimtarisë audituese, plani strategjik, afati i përgatitjes dhe miratimit të planit strategjik dhe planit vjetor.

Nga ana e subjektit nuk janë paraqitur observime. Sa më sipër në mos përgjigje në afatet ligjore, Projekt Raporti i Auditimit, konsiderohet i mirëqenë dhe u vijua me hartimin Raportin Përfundimtar të Auditimit.

III.2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit

2.2.1. Programimi i PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2023:

Nga auditimi i dokumentacionit të sipërcituar, u konstatua se për vitin 2023 për përgatitjen e PBA 2023-2025 dhe buxhetet vjetore, që i korrespondojnë kësaj periudhe, janë miratuar me VKB nr.71, datë 28.12.2022, si dhe VKB përkatëse për miratimin e fondeve të trashëguara për çdo fillim viti buxhetor. Gjithashtu janë konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr. 1253/1 prot., datë 06.01.2023. Në vija të përgjithshme gjatë hartimit dhe miratimit të kërkesave buxhetore, janë përcaktuar tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, si përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës rrugore urbane dhe asaj rurale, përmirësimin e shërbimit të pastrimit në të gjithë territorin, rritjen e sipërfaqeve të gjelbërta, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e tregjeve të reja, përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe aksesit, mbështetjen e iniciativave për zhvillimin e zonave të përmirësimit të biznesit, mbrojtjen e tokave bujqësore, rehabilitimin dhe investimin e infrastrukturës bujqësore, promovimin dhe marketingun e produkteve bujqësore, mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe

përmirësimin e tij, përmirësimin e sistemit të edukimit dhe trajnimit profesional, mbulimin e territorit me shërbime sociale sipas nevojave të komunitetit, zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive, sigurimin e mbrojtjes civile dhe menaxhimin e katastrofave në të gjithë territorin e Bashkisë Libohovë.

PBA janë hartuar pjesërisht bazuar në Udhëzimin e MFE nr.23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor Afatmesëm të njëjësive të Qeverisjes Vendore”. Është marrë në konsideratë instrumenti i planifikimit financiar, i cili përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzimet e viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion (*kontratat në vazhdim*), angazhimet (*detyrimet e prapambetura sipas llojit*), tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme (*kostot direkt dhe të ardhurat e pritshme*).

Programi i të ardhurave për vitin 2023 është bërë mbi bazën e paketës fiskale të miratuar me VKB nr.57, datë 24.10.2022.

Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre, janë miratuar nga Këshilli Bashkiak me vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo muaj. Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt-rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit. Buxheti total i Bashkisë Libohovë për vitin 2023 është në vlerën **159,161 mijë** lekë.

Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë për vitin 2023, realizohen nga dy burime:

Nga burimet e veta vendore, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, të ardhurat nga tarifatat vendore, të ardhura të tjera, donacione dhe të ardhura që trashëgohen;

Nga burimet qendrore, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar, transfertat specifike për funksionet e reja, që i janë transferuar Bashkisë dhe transfertat e kushtëzuar.

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për vitin 2023, paraqitet sipas situacionit të rakorduar me thesarin. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet planifikimi sipas PBA-ve dhe buxheti vjetor.

Tabela nr.4, PBA për periudhën 2023-2025 sipas programeve ekonomike që menaxhon Bashkia Libohovë

000/lekë

Nr.	Titulli	Emërtimi	PBA	Buxheti	Realizimi i	Diferenca
			Plan viti 2023	vjetor 2023 (Plani i rishikuar)	periudhës progresiv	
			(1)	(2)	(3)	(3-2)
1	01110	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	61,499	56,934	42,679	14,255
2	04980	Emergjence	4,393	7,135	828	6,307
3	04350	Rruget e brendshme	34,044	17,082	14,433	2,649
4	9120	Arsimi Baze	24,864	16,446	10,027	6,419
5	9230	Arsimi i Mesem	3,830	3,697	1,799	1,898
6	8220	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	1,605	1,605	453	1,152
7	1170	Gjendja Civile		1,396	1,279	117
8	6330	Furnizimi me ujë	-	-	-	
9	6260	Sherbime publike vendore	-	-	-	
10	3280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	26,561	26,492	17,533	8,959
11	4520	Rrjeti rrugor rural	11,882	11,271	7,842	3,429
12	4260	Administrimi I pyjeve dhe kullotave	9,354	7,226	3,384	3,842
13	6370	Furnizimi me uje dhe kanslizime	-	24,890	24,889	1
14	4240	Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	8,832	8,527	2,344	6,183
15	1620	1620	-	844	844	
16	05100	Menaxhimi I mbetjeve	5,299	6,344	930	5,414
17	10430	Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	400	30,074	29,898	176
		Totali i Shpenzimeve të Njësisë	192,563	219,964	159,161	60,803

Burimi: Bashkia Libohovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelës së mësipërme, mbi planifikimin buxhetor afatmesëm 2023-2025, pjesë e të cilit është edhe planifikimi për vitin buxhetor, si dhe krahasimi i tij me planin progresiv të vitit buxhetor, rezulton se diferenca ndërmjet planit fillestar dhe atij final është 60,803 mijë lekë. Diferencë e konsiderueshme rezulton në programin ekonomik për “Planifikimi, Menaxhimi

dhe Administrimi”, “Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile”, “Arsimi bazë”, “Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit”, “Menaxhimi i mbetjeve”, etj.,

Pjesë e PBA dhe planifikimit të buxhetit vjetor, është edhe planifikimi i të ardhurave, si burim i integruar në programet buxhetore, të pasqyruara në tabelën e mësipërme. Kështu për periudhën 2023-2025 Bashkia Libohovë ka planifikuar të arkëtojë të ardhura tatimore dhe jo tatimore, pasqyruar në tabelën si më poshtë vijon:

Tabela nr.5, Planifikimi i të ardhurave

Përshkrimi	Plan 2023
Te ardhura tatimore	9,848
Te ardhura jotatimore	2,996
TOTAL	12,844

000/lekë

Burimi: Bashkia Libohovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për PBA 2023-2025 nga Kryetari i Bashkisë nuk është nxjerrë udhëzimi vjetor për përgatitjen e buxhetit;

-Për PBA 2023-2025 dhe Buxhetin vjetor 2023 nuk ka gjetur zbatim përcaktimi i bërë në pikën 1 të nenit 33 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, si vijon: *“Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe dërgon për miratim në këshillin e njësisë kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, bazuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave për procedurat standarde për përgatitjen e kërkesave buxhetore të programit buxhetor afatmesëm qendror e vendor”*.

-Për PBA 2023-2025 nga Kryetari i Bashkisë nuk është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik, strukturë e cila është përgjegjëse për menaxhimin, garantimin e cilësisë dhe monitorimin e zbatimit të sistemit të integruar të planifikimit brenda njësisë së vetëqeverisjes vendore, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 29 në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”.

-Për PBA 2023-2025 nuk kanë gjetur zbatim kërkesat e përcaktuara në shkronjat “a-h” të pikës 38 në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”, për drejtuesit e ekipit të menaxhimit të programeve buxhetore të Bashkisë Libohovë, lidhur me hartimin e kërkesave buxhetore për programin përkatës, për realizimin e qëllimeve, objektivave dhe produkteve të programit gjatë procesit të zbatimit të buxhetit. Konkretisht në dosjet përkatëse të PBA dhe buxheteve vjetore, (nuk) administrohet dokumentacion mbi kërkesat për fondet të bëra nga Përgjegjësit e Sektorëve të Bashkisë Libohovë, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse, (nuk është bërë analize e detajuar);

-Nuk janë zbatuar të gjitha fazat e hartimit të PBA, nuk është i dokumentuar i plotë i gjithë procesi i hapave të punës që duhet të ndiqen nga EMP dhe GMS-ja;

-Në buxhetin vjetor të vitit 2023, nuk janë planifikuar fonde për investime në shtimin/përmirësimin e fondit pyjor, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 5 të nenit 23 në Ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, në fuqi për periudhën deri më datë 12.06.2020, si dhe në pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”, hyrë në fuqi më datë 13.06.2020.

-Për PBA 2023-2025 nuk ka gjetur zbatim përcaktimi i bërë në pikën 1 të nenit 37 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, si vijon:

“Bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të përditësuara të të ardhurave dhe transfertave nga Buxheti i Shtetit, të përcaktuara në udhëzimin plotësues të përgatitjes së buxhetit vendor të Ministrisë së Financave, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe paraqet për miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik”.

Këto veprime janë në kundërshtim me shkronjën “ç” në nenin 5, pika 3 në nenin 13, pika 1 në nenin 33, pika 1 në nenin 35, pika 1 në nenin 37 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Pika 3 në nenin 13 në Ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”, hyrë në fuqi më datë 13.06.2020; Pika 6, pika 10, pika 33, pika 34, pika 29, shkronjat “a-h” të pikës 40 në Udhëzimin nr.23, datë 22.11.2016 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisive të vetëqeverisjes vendore”.

2.2.2.Celja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vëna në dispozicion nga Pushteti Qendror nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, si ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit duke u bazuar në faktin e vitit parardhës.

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shitesa/pakësime). Këto lëvizje, në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet ndërmjet programeve buxhetore janë kryer me Vendim të Kryetarit të Bashkisë.

Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Gjirokastër dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MF. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve, sipas periudhave të planifikuara.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit, duke argumentuar edhe shitesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Gjatë vitit buxhetor, buxheti i Bashkisë Libohovë ka pësuar ndryshime nëpërmjet vendimeve të Këshillit Bashkiak, ndryshime të cilat për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve. Për të gjitha rastet e ndryshimit të buxhetit, VKB-të janë të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër.

Nga Këshilli i Bashkisë është bërë miratimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas burimeve të financimit, strukturës buxhetore dhe institucioneve.

Tabela nr. 6, Planifikimi i buxhetit për vitin 2023, Bashkia Libohovë

000lekë

Planifikimi i të ardhurave 2023		Planifikimi i shpenzimeve 2023	
Burimi i të ardhurave	000/ lekë	Emërtimi i zërave	000/ lekë
Të ardhura të trashëguara nga viti paraardhës	16,556		
Transferta e pakushtëzuar trashëguar viti paraardhës	30,704		
Trashëguar nga transferata specifike	36,746		
Të trashëguara nga FZHR			
Plani i të ardhurave viti ushtrimor	12,844		
Granti	49,114		

Transferta specifike	46,599		
		Paga (600) + sigurime shoqërore (601)	113,395
		Shpenzime operative (602)	67,583
		Investime (230+231) nga të ardhurat dhe tr.e pakushtëzuar	6,662
		Fondet emergjencë dhe fondet rezervë	4,393
		Investime (230+231) nga buxheti i shtetit	
		Shpenzime (603+604+606)	530
Totali të Ardhurave	192,563	Totali Shpenzimeve	192,563

Burimi: Bashkia Libohovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Rezulton se buxheti i konsoliduar (Bashki + Njësia e Varësisë) vitit 2023 është miratuar i balancuar dhe pa defiqite. Të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën **192,563 mijë lekë**.

Përgjatë vitit 2023, kanë ndodhur 4 ndryshime buxhetore me efekt në shtesa/pakësim të fondeve për artikull ekonomik, veprime që tregojnë për planifikime jo optimiste të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetit, si edhe atë të përlllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet joreal, të qëndrueshëm dhe efektiv.

Tabela nr.7, Ndryshimet buxhetore për vitin 2023

000/lekë

Periudha Buxhetore	Buxheti fillestar		Ndryshime gjatë viteve		Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve					
	Nr. datë	Vlera	Nr. Datë	Vlera	Pakësuar artikulli / shtuar artikulli					
					Shtesa. Art.	Shuma	Pakësim. Art.	Shuma		
Viti 2023	71/28.12.2023	192,563	06 28/02/2023	10,114	602	9,948	600	20,763		
					231	166	601	2,636		
									602	25,988
			07 24/02/2023	877	602	260	600	728		
					231	617	601	149		
			39 07.08.2023	40	606	40	600	40		
					600	1,526				
			41 07.08.2023	1,792	601	266				
					604	196	602	196		
			51 25.10.2023	196						
			Totali Viti 2023	192,563				13,019		50,500

Burimi: Bashkia Libohovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Mbështetur në përcaktimin e bërë në pikën 149 të Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, në gjykimin e grupit të auditimit ndryshimet buxhetore përgjatë vitit buxhetor, tregojnë për një performancë jo të mirë në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit.

Tabela nr.8, Realizimi i buxhetit vjetor në nivel programi ekonomik viti 2023

000/lekë

Nr.	Titulli	Emërtimi	Buxheti Vjetor 2023 (Plani i rishikuar)	Realizimi	Në %
1	01110	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	56,934	42,679	75 %
2	04980	Emergjence	7,135	828	12 %
3	04350	Rrugët e brendshme	17,082	14,433	84 %
4	9120	Arsimi Baze	16,446	10,027	61 %
5	9230	Arsimi i Mesem	3,697	1,799	49 %
6	8220	Trashegimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	1,605	453	28 %
7	1170	Gjendja Civile	1,396	1,279	92 %
8	6330	Furnizimi me ujë	-	-	
9	6260	Sherbime publike vendore	-	-	
10	3280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	26,492	17,533	66 %
11	4520	Rrjeti rrugor rural	11,271	7,842	70 %
12	4260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	7,226	3,384	47 %
13	6370	Furnizimi me uje dhe kanalizime	24,890	24,889	100 %
14	4240	Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	8,527	2,344	27 %
15	1620	Zgjedhjet vendore	844	844	100 %
16	05100	Menaxhimi I mbetjeve	6,344	930	15 %
17	10430	Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	30,074	29,898	99 %

	Totali i Shpenzimeve të Njesisë	219,964	159,161	72%
--	--	----------------	----------------	------------

Burimi: Bashkia Libohovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelës së mësipërme, rezulton se:

Për vitin 2023 realizimi i buxhetit është në nivelin 72%, si dhe programi ekonomik që paraqitet me realizimi më të lartë është “Furnizimi me ujë dhe kanalizime”, “Kujdesi social për familje dhe dhe fëmijë”, “Gjëndja Civile” “Rrugët e brendshme”, “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi”, “Rrjeti rrugor rural”, “Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile” dhe “Arsimi bazë”.

Programi me realizimin më të ulët është “Menaxhimi i mbetjeve”.

2.2.3. Auditimi mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Gjirokastër, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar në përgjithësi janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Gjirokastër, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv, të realizuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë ose të diktuar nga Transferta e deleguar nga pushteti qendror. Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për periudhën 2023-2025, referuar akt-rekomandimeve me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme;

Tabela nr.9, Realizimi i buxhetit në nivel artikulli ekonomik – viti 2023

000/lekë

Art.	Emertimi	Plani progresiv	Fakti	%
600	Paga	81,440	58,670	72
601	Sigurime Shoqërore	12,494	9,528	76
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	57,639	32,512	56
604	Transferta Korente të Brendshme	6,771	500	7
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	29,899	29,755	100
230-231	Investime	31,718	28,181	89
TOTAL		219,963	159,161	72%

Burimi: Bashkia Libohovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar të dhënave të pasqyrës së mësipërme rezulton se për vitin 2023 realizimi i shpenzimeve sipas artikujve ekonomik është 72%, ku realizimin më të lartë e ka artikulli 606 “Transferta për buxhet familjar dhe individ”, duke vijuar me shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore, mallra dhe shërbime të tjera, si dhe realizimin më të ulët e kanë Transferta korente të brendshme. Vihet re se për vitin 2023 art. (604) transferta korente të brendshme paraqiten 7 %, pra në krahasim me artikujt e tjerë ekonomik, ka realizimin më të ulët.

Realizimi i buxhetit sipas burimeve të financimit.

Tabela nr.10, Buxheti sipas burimeve të financimit 2023

000/lekë

Emërtimi	Fakt 2023				% nga përdorimi i të ardhurave të veta
	Gjithësej	Tr.Pakushtëzuar	Të ardhurat e veta	Transf.e kushtëzuar dhe specifike	
231-Investime	28,181		166	28,015	1
600-Paga	58,670	25,443	2,626	30,601	4
601-Sigurime shoqërore	9,528	3,738	1,079	4,741	11
602-Shpenzime operative	32,512	16,202	7,698	8,615	24
604- Transfertë institucione	196			196	
606-Transf. Buxh.Fam.Ind	29,974		600	29,374	2
Kuotë qarku	100		100		100
Totali	159,161	45,383	12,269	101,542	8%

Burimi: Bashkia Libohovë, përpunuar nga grupi i auditimit KLSH-së

-Referuar tabelës së mësipërme, rezulton se fondet e shpenzuara nga transfertat e kushtëzuar dhe specifike, në vlerën 101,542 mijë lekë, kanë peshën më të lartë në krahasim me burimet e tjera të të ardhurave të Bashkisë Libohovë, ndjekur nga transfertat e pakushtëzuar në vlerën 45,383 mijë lekë dhe të ardhurat veta në vlerën 12,269 mijë lekë.

Transferta e pakushtëzuar.

-Buxheti nga transfertat e pakushtëzuar për vitin 2023 është realizuar në vlerën 45,383 mijë lekë, ose 28.5% e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2023, ku peshën kryesore brenda transfertës së pa kushtëzuar, e zënë fondet e shpenzuara për paga dhe shpenzime operative.

Transferta e kushtëzuar dhe specifike.

-Buxheti nga transfertat e pakushtëzuar për vitin 2023 është realizuar në vlerën 101,542 mijë lekë, ose 64% e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2023, ku peshën kryesore brenda transfertës kushtëzuar për transfertën e kushtëzuar dhe specifike, e zënë për paga, transfertat për familje dhe individ, investime dhe shpenzime operative.

Të ardhurat e veta.

-Buxheti nga të ardhurat e veta për vitin 2023 është realizuar në vlerën 12,269 mijë lekë, ose 8% e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2023, ku peshën kryesore brenda të ardhurave të veta, e zënë fondet e shpenzuara për paga dhe shpenzime operative.

➤ Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës.

Me miratimin e buxhetit për vitin 2023, Bashkia Libohovë ka parashikuar dhe miratuar fondin rezervë/dhe të kontigjencës në vlerën 4,323 mijë lekë, dhe gjatë vitit është përdorur në vlerën 100 mijë lekë si më poshtë vijon:

Me VKB nr. 22 datë 03.04.2023 është përdorur në vlerën 100 mijë lekë për “Ndihmë financiare për familje në nevojë”.

Në fund të vitit 2023 mbetet pa u përdorur fondi në vlerën 4,223 mijë lekë.

➤ Subvencionet nga/dhe për Bashkinë Libohovë.

Nga dokumentacioni i paraqitur, rezulton se Bashkia Libohovë përgjatë periudhës 2023 nuk ka marrë nuk ka dhënë asnjë subvencion.

➤ Realizimi i Investimeve.

Nga auditimi i planifikimit të procedurave për investime publike, konstatohet se niveli i realizimit të investimeve kapitale të planifikuara në vitin 2023 paraqitet masën 89%. Kjo situatë është krijuar si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Libohovë në fillim të vitit buxhetor planifikohen procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “a” në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe pikën 24 dhe 25 në nenin 3, nenin 47 në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.

Këto veprime janë në kundërshtim me shkronjën “a” në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;

Pika 24 dhe 25 në nenin 3, neni 47 në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.

Monitorimi i buxhetit dhe raportimi 4 mujor në Këshillin Bashkiak.

Nga auditimi konstatohet se, për vitin 2023 Bashkia Libohovë nuk ka përcjellë në Ministrinë e Financave raportin e monitorimit të buxhetit për 4 mujorin e parë të vitit 2023, me shkresën nr. 1911 prot., datë 21.12.2023 ka përcjellë në MF raportin e monitorimit të buxhetit për 4

mujorin e dytë të vitit si dhe me shkresën nr. 573 prot., datë 18.03.2024 ka përcjellë në Ministrinë e Financave raportin vjetor të monitorimit të buxhetit. Pra për 4 mujorin e dytë dhe 4 mujorin e tretë konstatohet se Bashkia Libohovë ka përcjellë në MF raportet e monitorimit të buxhetit jashtë afateve të përcaktuara në pikën 45 dhe pikën 270 në Udhëzimin nr. 9 datë 20.03.20218 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore”, pika 19 dhe pikat 22-23.

2.3.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Lidhur me detyrimet e konstatuara nga Bashkia Libohovë, rezulton se është bërë planifikimi i likuidimit të tyre për çdo vit buxhetor, si dhe në fund të vitit 2023 janë raportuar në Këshillin Bashkiak dhe MFE, pra jo raportim periodik të tyre.

Me fondet buxhetore të vitit 2023, përgjithësisht janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikuiduara nga vitet e mëparshme, duke bërë pjesë-pjesë pagesat e detyrimeve kontraktuale. Sipas raportimit të kryer në strukturat/institucionet e mësipërme, shumat e detyrimit përgjatë periudhës 01.01.2023-31.12.2023 ka ardhur duke u rritur. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet zhvillimi i shumës së detyrimit përgjatë vitit 2023.

Tabela nr.11, Detyrimet e prapambetura në fund të periudhës 31.12.2023

Detyrime	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur në 31.12.2022	Detyrimi i krijuar për vitin 2023	Total Detyrime	Shlyerja e detyrimeve gjatë vitit 2023	Mbetja e Detyrimeve 31.12.2023
Investime	2,653		2,653	2,393	2,604
Investime nga FZSH					
Mallra dhe shërbime	812	910	1,723	1,294	428
Vendime gjyqësore	14,585	0	14,585	10,261	4,324
Të tjera Elektrike	10,841	0	10,841	2,100	8,741
Totali	28,894	910	29,804	16,049	13,755

000/lekë

Burimi: Bashkia Libohovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Vlera e detyrimeve të mësipërme është kryqëzuar me vlerën e detyrimeve që Bashkia Libohovë ka ndaj palëve të treta, të pasqyruar në Pasqyrat Financiare të vitit 2023, si dhe dokumentacionin justifikues dhe detyruet (faturë tatimore/vendim gjykatë) që krijon detyrimin përkatës.

-Nga shqyrtimi i raportit të vetëvlerësimit financiar për vitin 2023, përcjellë në MFE me shkresën nr.479 prot., datë 07.02.2024, rezulton se vlera e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Libohovë ndaj palëve të treta raportuar në MFE është në vlerën **13,755 mijë lekë**, e cila përbëhet nga detyrime për shpenzime kapitale, pasqyruar në tabelën më poshtë:

Tabela nr.12, Situata Financiare për vitin 2023

Nr.	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJVQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua sftatgjatë	0		
a,1	Principali			
a,2	Interesi			
b	Hua afatshkurtër	0		
b,1	Hua			
b,2	Overdrafte			
b,3	Kredi të furnitorëve			
II	Detyrime (a+b+c)	13,755		7.14%
a	Shpenzime korrente	9,431		
a,1	Mallra dhe shërbime	9,431		
a,2	Paga dhe sigurime			
a,3	Të tjera			
b	Shenzime kapitale	0		
b,1	Institucione buxhetore	0		

000/lekë

b,2	Subjekte private			
c	Vendime gjyqësore	4,324		
c,1	Marrëdhënie pune	0		
c,2	Mallra dhe shërbime	0		
c,3	Investime			
c,4	Të tjera	4,3240		
III	Totali (I+II)	13,755	192,563	7.14%

Burimi: Bashkia Libohovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Në vijim parashtrojmë përcaktimet e bëra për detyrimet e prapambetura, çfarë përfaqësojnë dhe cilat detyrime përfshihen:

“Detyrime të prapambetura ndaj palëve të treta”, nënkupton të gjitha llojet e detyrimeve financiare të NJVQV-ve, të pa paguara brenda 60 ditëve kalendarike (30 ditë për procedurat 3 e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit e procesimit të pagesës në degën e thesarit) nga data e pagesës së specifikuar në kontrat, faturë ose sipas ligjit”. “Detyrimet e prapambetura rregjistrohen në llogarinë ekonomike nr.4864 “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura”².

“Njësitë e qeverisjes së përgjithshme përpara mbylljes së llogarive vjetore 2022, kryejnë veprimin e mbylljes së llogarisë nr.486 në debi të llogarisë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm për totalin e detyrimeve të prapambetura që figurojnë në llogari në datën 31.12.2022³”.

-Pra sa më sipër vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura është në masën 0.23% ndaj totalit të shpenzimeve të miratuara për vitin 2023.

Stoku i detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta paraqitet më pak se 15% të shpenzimeve vjetore të miratuara, **ç’ka do të thotë se Bashkia Libohovë në fund të vitit 2023 rezulton në një situatë normale.**

Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2023 janë në vlerën 4,324 mijë lekë ose rreth 31.4 % mbi totalin e detyrimeve të raportuara. Përgjatë vitit 2023 ka kryer likujdime në vlerën 10,261 mijë lekë, të detyrimeve të mbartura nga vitet e mëparshme. Në fund të vitit 2023 Bashkia Libohovë ka pasur fonde në dispozicion në vlerën 78,079 mijë lekë, të cilat mund t’i përdorte për likujdimin e plotë të vendimeve gjyqësore si dhe nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative ndaj personit që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij ka krijuar detyrime ndaj Bashkisë Libohovë.

Nga kryqëzimi i të dhënave mbi detyrimet e Bashkisë Libohovë ndaj palëve të treta, kryesisht të detyrimeve të krijuara si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblime për dëmtim prone apo humbje jete.

-Gjithashtu konstatohet se për likujdimin e subjekteve paraqitur në kapitullin Anekse, tabela nr. 35, është nxjerrë urdhëri përkatës nga titullari i institucionit, por në urdhrin e likujdimit nuk është nxjerrë edhe përgjegjësia administrative ndaj personit që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij ka krijuar detyrime Bashkisë Libohovë.

Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 60 e Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr.1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njërive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”.

Faturat e palikuiduara brenda afatit 30 ditor.

Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit **30 ditor** të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqërues në Degën e Thesarit Gjirokastër, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për periudhën

² Udhëzimin e MFE nr.37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”.

³ Udhëzimi nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar”.

2023, ky afat nuk është respektuar në 10 raste për vlerën 13,754,911 lekë, pasqyruar në tabelën përmbledhëse më poshtë dhe tabelën analitike nr.11, në Kapitullin “Anekse”.

Tabela nr.13, Përmbledhëse e faturave për vitin 2023

Artikulli	Sasia	Viti 2023/lekë
230-231	9	5,013,375
602	1	8,741,536
Totali	10	13,754,911

Burimi: Bashkia Libohovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për periudhën deri në fund të vitit 2023 janë 10 fatura të palikujduara për investime dhe shpenzime për mallra dhe shërbime, në vlerën 13,754,912⁴ lekë.

-Likuidim me vonesë i faturave në tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh dhe mos likuidimi i vlerës së plotë të faturës, në pjesën më të madhe të rasteve ka rezultuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh, mosrealizim të ardhurash, si dhe mosrespektim i radhës në likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

Këto veprime janë në kundërshtim me pikat 8, 106 dhe 107 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi: znj. E. P, ish Përgjegjëse e Sektorit të Financës.

Nga ana e subjektit nuk janë paraqitur observime. Sa më sipër në mos përgjigje në afatet e caktuara, Projekt Raporti i Auditimit, konsiderohet i mirëqenë dhe u vijua me hartimin Raportin Përfundimtar të Auditimit.

2.2.5. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënien me qira të aseteve dhe arkëtimi i detyrimeve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Në zbatim të pikës së mësipërme të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Vendim i Këshillit Bashkiak për miratimin e paketës fiskale për vitin 2023
- Vendim i Këshillit Bashkiak për miratimin e buxhetit për vitin 2023.
- Rregjistri i taksapaguesve privat dhe familjar.
- Rakordimet me agjentët tatimor.
- Evidenca e planifikimit të të ardhurave.
- Aktet e rakordimit me degën e thesarit për të ardhurat.
- Regjistrat e subjekteve debitorë në 31.12.2023.
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore, në lidhje me çështjen e të ardhurave.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezultoi se:

I.Struktura e Sektorit të Tatim Taksave, Bashkia Libohovë.

Për vitin 2023 me Vendim të Këshillit Bashkiak VKB nr.72, datë 19.12.2022, është miratuar numri i punonjësve, konfirmuar nga Prefekti Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr.1253/1, datë 06.01.2023. Me urdhrin nr.5, datë 25.01.2023 të Kryetarit të Bashkisë është miratuar struktura organizative sipas sektorëve, ku janë të detajuar dhe punonjësit për secilën nga sektorët, ku bën pjesë dhe sektori i tatimeve. Kjo strukturë ka funksionuar për vitin 2023 me 6 punonjës, specialistë tatimesh dhe që kanë varësi funksionale nga Shefi i Sektorit të Tatimeve. Këta specialistë mbulojnë qytetin e Libohovë dhe 2 NJA si: Qëndër Libohovë dhe Zagorie.

⁴ Analitikisht pasqyruar në Anekse.

Struktura e Taksave dhe Tarifave, Bashkia Libohovë, si dhe lëvizjet e punonjësve përgjatë vitit 2023 pasqyrohet si më poshtë:

Tabela nr.14

Nr.	Emër Mbiemer	Pozicioni	Date fillimi	Ndryshimi gjatë 2023 nëse ka pasur
1	Xh. S	Shef Sektori i Tatim Taksave	01.04.2019	
2	A. I	Specialist i Tatim-Taksave	14.08.2015	
3	E. D	Specialist i Tatim-Taksave	19.01.2021	
4	S. Z	Magaziniere në Sektorin e Tatim-Taksave	13.04.2017	Larguar më datë 02.06.2023
5	D. B	Magaziniere në Sektorin e Tatim-Taksave	23.02.2024	
5	A. L	Shoferi Administrate në Sektorin e Tatim-Taksave	11.09.2020	
6	D. T	Mirëmbajtës godine në sektorin e Tatim Taksave	01.12.2015	

Burimi: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Libohovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Sektori i Tatim Taksave Bashkia Libohovë, për vitin 2023 është struktura kryesore për vlerësimin dhe arkëtimin e të ardhurave të Bashkisë Libohovë nga taksat dhe tarifave.

-Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se struktura e miratuar e sektorit të Tatim Taksave nuk është në përputhje me funksionet që kryen ky sektor, konkretisht, magazinieri, shoferi i administratës dhe mirëmbajtësi i godinave nuk kryejnë funksionet e përcaktuara në nenin 44 të rregullores së Bashkisë Libohovë, për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore.

II. Taksat dhe Tarifave e aplikuar dhe arkëtuara nga Bashkia Libohovë.

Për vitin 2023 paketa fiskale për taksat dhe tarifave vendore në Bashkisë Libohovë është miratuar me VKB nr.57, datë 20.10.2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Libohovë”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me vendim me nr.1033/1 prot., datë 03.11.2022.

Mbështetur në paketën fiskale të mësipërme në Bashkinë Libohovë, sipas sektorëve përkatës, në mënyrë të përmbledhur janë aplikuar/mbledhur rreth 17 lloje taksash dhe tarifash.

Për vitin 2023 subjektet mbi të cilat janë aplikuar taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Libohovë dhe NJA, ndahen në 2 kategori:

1.Biznes;

2.Familjar;

Kategoritë e mësipërme (përfshirë institucionet) ndahen në disa nënkategori për efekt të nivelit të taksës/tarifës që aplikohet, konkretisht:

-Kategoria e parë ndahet në Biznes i Madh dhe Biznes i Vogël.

-Kategoria e tretë për efekt të taksave/tarifave ndahet në familje që kanë në pronësi/përdorim toka bujqësore, familje që jetojnë në apartamente, pensionist, familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, veteranët e luftës, invalid etj.

Tabela nr. 15, Llojet e subjekteve mbi të cilat janë aplikuar taksat dhe tarifave vendore, si dhe numri i tyre.

Nr	Lloji	2023
1	Biznesi i Madh	5
2	Biznesi i Vogël	53
3	Familje	797

Burimi: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Libohovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Të gjitha sa më sipër, mbi planifikimin dhe realizimin e tyre në lekë, për vitin 2023, pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.16

Nr.	Lloji i Taksës	Viti 2023		
		Plan	Fakt	%
a	b	1	2	3
1	Taksë mbi ndërtesë	2,128	1,576	74
2	Taksa mbi token Bujqësore	2,019	1,813	90
3	Takse mbi regji e Automjete	2,200	2,617	119
4	Taksa mbi ndërtimet	500	130	26

000/lekë

Nr.	Lloji i Taksës	Viti 2023		
		Plan	Fakt	%
a	b	1	2	3
5	Takse trualli	334	280	84
6	Takse për hapësira publike	31	22	71
7	Tarife Pastrimi	1,653	1,260	76
8	Tarifë shërbim te tjera publike	16	18	113
9	Tarife ndriçimi rrugor	276	227	82
10	Te ardhura te tjera personale	850	1,604	189
11	Qira nga toka bujqesore	312	425	136
12	Licencim për karburant	200	200	100
13	Qira kullote bimë medicinale	600	421	70
14	Tarifë për ujitje	900	523	58
15	Te ardhura nga qira nga trojet	670	450	67
16	Qira ndërtesë	5	10	200
17	Te ardhura te tjera jotatimore	150	151	101
	GJITHSEJ (I+II+III+ IV)	12,844	11,727	91%

Burimi: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Libohovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për vitin 2023 të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën **12,844 mijë** lekë dhe janë realizuar në vlerën **11,727 mijë** lekë, ose 92% / rreth 1,117 mijë lekë më pak nga plani. Në këto mos realizime të vitit 2023 të analizuara në nivel taksash dhe tarifash kanë ndikuar mos realizimi i:

- 1- Taksë mbi ndërtimet realizimi i secilës është në vlera të ulta, ku për vitin 2023 është në masën 26%
- 2- Tarifë për ujitje realizimi i secilës është në vlera të ulta, ku për vitin 2023 është në masën 58%
- 3- Të ardhura nga tenderi (Qira nga trojet) realizimi i secilës është në vlera të ulta, ku për vitin 2022 është në masën 67%
- 4- Qira kullotë për bimë medicinale realizimi i secilës është në vlera të ulta, ku për vitin 2023 është në masën 70%
- 5- Taksë për hapsirën publike realizimi i secilës është në vlera të ulta, ku për vitin 2023 është në masën 71%

Referuar krijimit dhe realizimit të të ardhurave konkludohet se programimi i të ardhurave nuk pasqyron saktë burimin e të ardhurave, pra planifikimi i të ardhurave nuk është bërë mbi baza reale dhe i studiuar apo i argumentuar në lidhje me shfrytëzimin e të gjitha burimeve të të ardhurave si dhe të mundësive të arkëtimit të këtyre detyrimeve. Gjithashtu në realizimin në nivele të ulta të të ardhurave ka ndikuar dhe puna e pamjaftueshme e Bashkisë Libohovë për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore dhe detyrimeve debitorë.

Me tejkallim paraqiten zërat, si:

- 1- Qira nga toka bujqësore në masën 136%, kjo pasi nga Sektori i Taksave Bashkia Libohovë është planifikuar 312 mijë lekë, ndërsa arkëtimet janë në shumën 425 mijë lekë, pra Sektori i Taksave Bashkia Libohovë nuk ka bërë planifikim të saktë;
- 2- Taksë mbi regjistrimin e automjeteve, paraqitet me realizim në masën 119%, ku nga vlera e planifikuar prej 2,200 mijë lekë është arkëtuar vlera 2,617 mijë lekë. Nga Sektori i taksave Bashkia Libohovë nuk është bërë planifikimi i saktë;
- 3- Të ardhura të tjera personale nga 850 mijë lekë është arkëtuar vlera 1,604 mijë lekë ose 189%.

III. Detyrimet e palëve të treta ndaj Bashkisë Libohovë sipas kategorive të tyre.

Bazuar në të dhënat e vendosura në dispozicion nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, ecuria e debitorëve për periudhën 01.01.2023 (të trashëguar nga vitet e mëparshme) – 31.12.2023 (krijuar brenda vitit, si dhe në mënyrë progresive në fund të vitit 2023), në mënyrë të përmbledhur pasqyrohet si më poshtë:

Tabela nr.17

Në fund të vitit 2022 (progresive)	Nr	Vlerë	Principal	Kamat-Vonesë
		26,359,483	23,288,294	3,071,189
Biznesi i Madh	1	299,593	299,593	

Biznesi i Vogël	57	5,471,312	4,721,803	749,509
Familjar (për taksa dhe tarifa vendore)	840	10,383,365	9,190,751	1,192,614
Taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale		99,424	99,424	
Taksa e tokës bujqësore	814	8,618,629	7,546,933	1,071,696
Qira fond pyjor dhe kullosor	6	261,960	204,590	57,370
Taksa e vaditjes		1,225,200	1,225,200	
Krijuar brenda vitit 2023		1,578,424	1,578,424	
Biznesi i Madh				
Biznesi i Vogël		-122,016	-122,016	
Familjar (për taksa dhe tarifa vendore)	895	1,141,061	1,141,061	
Taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale	2	39,463	39,463	
Taksa e tokës bujqësore	881	202,073	202,073	
Qira fond pyjor dhe kullosor	3	112,043	112,043	
Taksa e vaditjes		205,800	205,800	
Në fund të vitit 2023 (progresive)		27,982,677	25,118,454	2,864,223
Biznesi i Madh	1	299,593	299,593	
Biznesi i Vogël	55	5,394,066	4,669,653	724,413
Familjar (për taksa dhe tarifa vendore)		11,524,426	10,423,616	1,100,810
Taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale	5	138,887	138,887	
Taksa e tokës bujqësore	814	8,820,702	7,781,702	1,039,000
Qira fond pyjor dhe kullosor	3	374,003	374,003	
Taksa e vaditjes		1,431,000	1,431,000	

Burimi: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Libohovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga tabela e mësipërme rezulton se:

-Vlera e detyrimeve në fund të vitit 2023 është në vlerën **27,982,677 lekë** për taksat dhe tarifat vendore, qiratë, etj. Në krahasim me fundin e vitit 2022, në fund të vitit 2023 kemi rritje të vlerës debitore me 1,578,424 lekë.

- Në mënyrë të përmbledhur vlera e detyrimit tatimor të vlerësuar, për taksa dhe tarifa vendore (gjelbërim, pastrim, ndriçim, ndërtesë, truall, toka bujqësore, ndikim në infrastrukturë, tabelë, taksë e vaditjes etj.), progresivisht deri më datë 31.12.2023 është në vlerën 27,982,677 lekë, ndërsa detyrimi tatimor i krijuar brenda vitit 2023 është në vlerën 1,578,424 lekë. Përgjatë vitit 2023 janë kryer likuidime pjesore nga detyrimet e prapambetura për kategorinë biznes dhe detyrime të krijuara për vitin 2023.

Situata e mësipërme tregon për një punë të pamjaftueshme të Bashkisë Libohovë në arkëtimin e të drejtave të saj ndaj palëve të treta.

III.1. Kategoria “Biznes”.

Bazuar në të dhënat e vendosura në dispozicion nga Sektori i Tatim Taksave, rezulton se në fillim të vitit 2023 kanë qenë debitor 58 subjekte të kategorisë “Biznes” në vlerën 5,770,905 lekë.

-Në fund të vitit 2023 në mënyrë progresive rezultojnë debitor 55 subjekte të kategorisë “Biznes” dhe në vlerën **5,693,659 lekë**, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Libohovë.

-Për debitorët e mësipërm, nga Sektori i Financës dhe Tatim Taksave Bashkia Libohovë, sipas dokumentacionit të administruar dhe vendosur në dispozicion, nuk janë bërë përpjekje duke mos aplikuar masa shtrënguese (deri në vendosjen e barrës siguroese për pasuritë e luajtshme, si mjete transporti), për të debitorëve nuk janë marrë masa shtrënguese në mënyrë shteruese, si bllokimi i aktivitetit të biznesit, bllokim i shitjes së aktiveve në QKB, konfiskimi i jo më pak se 50% të qarkullimit deri në kallëzim penal.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 76, neni 114 dhe neni 117 i Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar;

-Pikat 1, 2 dhe 7 në nenin 4, neni 22/5, nenin 26, neni 34 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar;

-Neni 64 në Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;

-Pikën 1 të nenit 12, pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;

-VKB nr.71, datë 19.12.2022 Për miratimin e buxhetit të vitit 2023;

III.2 Familjet.

Nga të dhënat e vendosura në dispozicion në Bashkinë Libohovë dhe NJA, për vitin 2023 janë taksuar 797 familje, numër i cili shërben për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “familjar”. Të dhënat për numrin e familjeve që taksohen për çdo NJA, pasqyrohen si më poshtë:

Tabela nr.18

NJA	Familje të taksuara	Familje sipas Gj.Civile
Qyteti Libohovë	440	
Qëndër Libohovë	357	
Zagorie		
Total	797	2349

Burimi: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Libohovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Me qëllim vlerësimin nëse nga Sektori i Tatim Taksave Bashkia Libohovë është bërë planifikimi saktë i taksave dhe tarifave për kategorinë “familjar”, u kryqëzua informacioni i administruar nga Sektori i Tatim Taksave Bashkia Libohovë me informacionin e administruar nga Gjendja Civile.

-Sipas gjëndjes civile në Bashkinë Libohovë dhe NJA janë 2349 familje, pra ndërkohë në vitin 2023 janë taksuar/tarifuar 797 familje.

-Kjo situatë ndikon negativisht në të ardhurat që mund të arkëtojnë Bashkia Libohovë nga kategoria “Familjar”. Konkretisht, nëse do të bënim përlogaritjet vetëm për tarifën e ndriçimit dhe pastrimit për qytetin Libohovë dhe Njësitë Administrative, për numrin e familjeve të pataksuara, do të kishim 1,440 lekë * 1552 familje taksuar më pak = **1,769,280 lekë** planifikuar më pak.

-Gjithashtu situata e mësipërme tregon se Sektori i Tatim Taksave Bashkia Libohovë nuk ka një regjistër të përditësuar të kategorisë “Familjar”, duke patur në konsideratë edhe gjeneralitetet (Adresën, sipërfaqen, qëllimin e përdorimit, të dhënat për taksapaguesin) që përcaktohen në VKM Nr. 132, datë 07.03.2018⁵, e ndryshuar, detyrim për t’u pasqyruar në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar”. Në këtë drejtim kërkohet më tepër përkushtim nga Bashkia Libohovë duke ngritur grup pune, për evidentimin e saktë dhe të plotë të familjeve që jetojnë në Bashkinë Libohovë dhe NJA.

-Në lidhje me administrimin e taksave/tarifave nga familjarët, rezultojnë se për arkëtimin e taksave të familjeve të qytetit Libohovë dhe Njësitë Administrative, taksimi dhe tarifimi i familjeve bëhet fizikisht, pra lëshohet faturë kur familjari paraqitet pranë zyrave të bashkisë për të përfituar shërbim, duke mos marrë masat e duhura për të njoftuar tatimpaguesit familjarë nëpërmjet dërgimit të “Njoftim Vlerësimit”, apo shkresës zyrtare nëpërmjet Zyrës Postare, për detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 7 në nenin 4, nenin 20, nenet 20-24 në Kreun IV të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Pikën 1 të nenit 12 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Pika 9 dhe 12 në Paketën Fiskale të Bashkisë Libohovë.

Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, në Bashkinë Libohovë dhe NJA, rezultojnë se në fund të vitit 2023 në mënyrë progresive janë 814 familje debitorë për vlerën 11,524,426 lekë, nga të cilat, në vitin 2023 janë krijuar 895 familje debitorë për vlerën 1,141,061 lekë, pasqyrohen si më poshtë:

-Në tabelat e mëposhtme pasqyrohet ecuria e debitorëve familjar për tarifën e ndriçimit, pastrimit dhe taksën e ndërtesës.

Tabela nr.18, Numër familje debitorë sipas NJA, të cilat rezultojnë debitor në një ose disa taksa/tarifa

	Në fund të vitit 2022 (progresive)	Krijuar brenda vitit 2023	Në fund të vitit 2023 (progresive)
--	------------------------------------	---------------------------	------------------------------------

⁵ Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës.

Familjar (për taksë dhe tarifa vendore)	Nr	Vlerë	Nr	Vlerë	Nr	Vlerë
	840	10,383,365	895	1,141,061	895	11,524,426

Burimi: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Libohovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelës së mësipërme rezulton se vlera debitore e kategorisë “Familjar” për taksat dhe tarifave vendore, në krahasim me fundin e vitit 2022 është rritur me 1,141,061 lekë, ç’ka tregon për punë të pamjaftueshme të Bashkisë Libohovë në arkëtimin e taksave dhe tarifave të mësipërme.

-Sa i përket familjeve debitore, rezulton se nga Sektori i Tatimeve dhe NJA nuk janë marrë masa ligjore shteruese për arkëtimin e vlerës debitore.

Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 3 në nenin 3, pikat 1 dhe 2 në nenin 4 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar; Pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Pikën 3 në nenin 6, nenin 76, pikën 2 në nenin 89, neni 117 në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Kreu III në Udhëzimin nr.17, datë 20.06.2022 “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore”.

Nga të dhënat e sektorit të Tatim Taksave dhe sektori i Bujqësisë rezulton se numri i familjeve të trajtuara me tokë është 1586 fermerë me një sipërfaqe të përgjithshme prej 2470 ha, të cilat të ndara sipas kategorisë së tokës dhe Njësive Administrative paraqiten në tabelat e mëposhtme:

Tabela nr.19

Nr	Emërtimi	Nr. fshatrave për çdo njësi	Sipërfaqja e tokës së ndarë (ha)	Nr. i familjeve të trajtuara me tokë sipas ligjit 7501
1	Qyteti Libohovë	1	864	694
2	Nj. Qendër Libohovë	7	1122	549
3	Zagorie	10	484	343
	Shuma		2470	1586

Burimi: Sektori i Bujqësisë Bashkia Libohovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Planifikimi i taksës së tokës është bërë në bazë të dhënash për bazën e taksueshme të sipërfaqes së tokave bujqësore në disponim të familjeve fermere, informacion i cili i dërgohet nga NJA Sektorit të Tatimeve në fazën e përgatitjes së buxhetit. Këto të dhëna nuk janë të sakta, edhe për faktin se ka mosrakordim të dhënash në mes të dhënave të NJA dhe të dhënave që disponon Sektori i Tatim Taksave. Planifikimi i të ardhurave sipas Bashkisë Libohovë për vitin 2023 i taksës së tokës bujqësore paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.20, Planifikimi i taksës së tokës bujqësore në Bashkinë Libohovë

Nr	Kategorit e tokës	Sip/Ha Bashkia Libohovë	Sip/Ha NJA. Qendër	Sip/Ha NJA. Zagori	Vlera/Ha	Plani/Leke
1	Kategoria II				0	0
2	Kategoria III				1,470	
3	Kategoria IV	864	1122	484	980	2,420,600
4	Kategoria V				945	
5	Kategoria VI				875	
6	Kategoria VII				840	
7	Kategoria VIII				770	
	Totali	864	1122	484		2,420,600

Burimi: Sektori i Bujqësisë Bashkia Libohovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për marrjen e të dhënave të sakta mbi sipërfaqen e tokës së shpërndarë në disponim të fermerëve dhe të asaj në pronësi të Bashkisë u kërkua korrespondenca zyrtare e Bashkisë Libohovë me Këshillin e Qarkut Gjirokastrë, cila nuk ekzistonte. Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur në lidhje me planifikimin dhe realizimin e taksës së tokës rezulton se: Nga NJA disponohen regjistrat e tokës me të dhënat e sipërfaqeve dhe cilësisë së tokave (kategorizimi), si dhe marrëdhëniet juridike më të, pra statusi i pronësisë për të gjitha familjet fermere. Mbi bazën e këtyre regjistrave të hartuar në vitet e mëparshme nga të dhënat e marra nga sektori i Bujqësisë nga specialistët e tatimeve ngarkoheshin familjet fermere me taksën e

tokës sipas kategorisë dhe nivelin e taksës përkatëse të përcaktuar në paketën fiskale. Mbi bazën e këtij regjistri specialistët e Sektorit të tatim taksave ndiqnin në terren arkëtimin e taksës së tokës. Duhet theksuar se nuk kishte një përditësim të këtyre regjistrave në 10 vitet e fundit, gjë që është e domosdoshme për të patur të dhëna të sakta për bazën e taksueshme.

- Situata e mësipërme tregon gjithashtu se regjistri i taksës për tokën bujqësore ka mangësi në numrin e subjekteve objekt taksimi.

Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 7 në nenin 4, nenin 23 dhe 24 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar;

Pikën 1 të nenit 12 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;

Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, në Bashkinë Libohovë dhe NJA, për vitin 2023 janë taksuar 881 familje, për taksën e tokës bujqësore numër i cili shërben për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “familjar”. Të dhënat për numrin e familjeve që taksohen për çdo NJA, pasqyrohen si më poshtë:

Tabela nr.21, Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet ecuria e debitorëve familjar për taksën e tokës bujqësore.

Taksa e tokës bujqësore	Në fund të vitit 2022 (progresive)		Krijuar brenda vitit 2023		Në fund të vitit 2023 (progresive)	
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
	814	8,618,629	881	202,073	814	8,820,702

Burimi: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Libohovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Sa më sipër rezulton se në fund të vitit 2022 në mënyrë progresive vlera debitore është 8,618,629 lekë dhe në fund të vitit **2023 në mënyrë progresive janë 814 familje debitorë për vlerën 8,820,702 lekë**, nga të cilat, në vitin 2023 është krijuar 202,073 lekë debi. Pra në krahasim me vitin 2022, në fund të vitit 2023 kemi rritje të vlerës debitore për taksën e tokës bujqësore, ç’ka tregon për punë të pamjaftueshme të Bashkisë Libohovë në arkëtimin e kësaj takse.

-Sa i përket familjeve debitore, rezulton se nuk janë marrë masa ligjore në mënyrë shteruese për arkëtimin e vlerës debitore.

Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 3 në nenin 3, pikat 1 dhe 2 në nenin 4, nenet 20-24 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;

Pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

Pikën 3 në nenin 6, nenin 76, pikën 2 në nenin 89, neni 117 në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Kreu III në Udhëzimin nr.17, datë 20.06.2022 “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore”.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtesat informale, objekt legalizimi.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet administrohet nga sektori i shërbimit urban dhe sektori i të ardhurave.

Në lidhje me realizimin e të ardhurave të Bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, bazuar në shkresat që ASHK dërgon në Bashkinë Libohovë, për vitin 2023 janë legalizuar gjithsej 6 objekte për të cilat Sektori i Shërbimit Urban ka llogaritur detyrimin për taksën e ndikimit në infrastrukturë në shumën 169,496 lekë, nga të cilat nuk kanë shlyer detyrimin 2 prej tyre në vlerën 39,463 lekë, si vijon:

Tabela nr.22

Emërtimi	Emër Mbiemër	Vendndodhja	Vlera
Banimi	P. B	Drino	25,113
Banimi	J. K	Lagj. Çuprel	14,350
Total			39,463

Bazuar në të dhënat e marra nga Bashkia Libohovë konstatohet se:

-Vlera debitore progresive është 138,887 lekë për 5 subjekte (nga të cilat 2 subjekte për vlerën 39,463 lekë krijuar në vitin 2023).

Tabela nr.23, TNI për legalizimin e objekteve informale - Viti 2023

Debitor TNI	Subjekte	Vlera
Gjithësej progressive	5	138,887
Nga të cilat në 2023	2	39,463
Nga të cilat progresive deri në 2022	3	99,424

Burimi: Sektori i shërbimit urban Bashkia Libohovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për qytetarët që paguajnë këtë taksë, si dhe për ata që nuk paguajnë, sektori i shërbimit urban ka njoftuar sektorin e taksave dhe tarifave vendore i cili ka regjistruar detyrimin.

Për vitin 2023 Bashkia Libohovë nuk ka korespondencë me ASHK për numrin e objekteve të legalizuara, me qëllim evidentimin e vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Paketa Fiskale 2023, Pika 4.

Administrimi i aseteve pronë e bashkisë dhe realizimi i të ardhurave nga dhënia me qira e tyre.

Për sa i përket aseteve të cilat janë dhënë me qira referuar kontratave të sipërpërmendura, Bashkia Libohovë nuk posedon titull pronësie (kjo problematikë është trajtuar më gjerësisht në nënpikën nr. 3.4, të programit të auditimit me objekt “Auditim mbi administrimin e aseteve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës”).

Për vendosjen e tarifave për dhënie me qira të aseteve nga Bashkia Libohovë janë aplikuar çmimet e parashikuara në VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar, dhe UKM nr. 1, datë 18.07.2012, “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, si më poshtë:

Tabela nr. 24

000/Lekë

Viti 2023			
Nr.	Emërtimi	Bashkia	Njësia Administrative
		Niveli i tarifës	
1	Tarifë për dhënie me qira objekt		50 lekë për m ² në muaj
2	Tarifë për dhënie me qira truall	100 lekë për m ² në muaj	50 lekë për m ² në muaj
3	Tarifa e dhënies me qira tokë bujqësore	6000 lekë për ha në vit	6000 lekë për ha në vit
4	Tarifa e dhënies me qira pyjeve dhe kullotave	27,000 lekë për ha në vit	27,000 lekë për ha në vit

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

a. Kontrata për dhënie me qira të pyjeve dhe kullotave.

Për periudhën nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023, Bashkia Libohovë nuk ka lidhur asnjë kontratë të re për dhënie me qira të pyjeve dhe kullotave, por janë aktive 23 kontrata të cilat janë lidhur përpara periudhës objekt auditimi (kontratat të cilat kanë qenë aktive, janë rilidhur përsëri duke ushtuar afatin për përdorimin e tyre). Për vitin 2023 kanë qenë aktive 23 kontrata me sipërfaqe totale 1128.88 ha me vlerë kontrate 398,200 lekë.

Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion të kontratave për dhënie me qira të tokës bujqësore, konstatohet se deri më datë 31.12.2023, për 4 kontrata nuk janë shlyer **detyrimet në vlerën totale 88,417 lekë e cila konsiderohet detyrim i pa arkëtuar nga debitorët e Bashkisë Libohovë.** Analiza e detajuar paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 25

Nr	Emer/Mbiemer	Data e lidhjes së. Kon.	Afati Kontratës	Vendi	Zona kadastrale	Nr. Parc.	Sip.	Çmimi	Likujduar	Diferenca 31.12.2023
1	M. N	25.05	30.11.2025	Zagori	3923	JFK	115	53,050		53,050
2	A. R	24.05.	30.11.2023	Libohove	2359	6	184.04	66,500	66,500	
3	V. K	25.05	30.11.2023	Zagori	3613	JFK	20	4,000	4,000	
4	V M	02.06	30.11.2023	Libohove	2358	3	73.85	24,100	24,100	
5	L. H	18.10	01.06.2024	Libohove	2444	JFK	7	4,100	4,100	
6	K. Q	24.11	01.06.2024	Libohove	2358	1/1	33.4	16,800	16,800	
7	V. M	24.11	01.06.2024	Libohove	2358	1/2	17	8,400	8,400	

8	K. Z	24.11	01.06.2024	Libohove	2359	1/3e5	12	4,300	4,300		
9	M. M	24.11	01.06.2024	Libohove	2359	1/3 e 5	12	4,300	4,300		
10	P. Z	24.11	01.06.2024	Libohove	2359	1/3 e 5	11	2,200	2,200		
11	R. B	24.11	01.06.2024	Libohove	2359	13	145.46	14,600	14,600		
12	J. P	12.12	01.06.2024	Libohove	2358	9	15	7,000	7,000		
13	K. L	28.12	01.06.2024	Lunxheri	3513	57	70.21	22,200	22,200		
14	P. K	28.12	01.06.2024	Lunxheri	3513	51.55.58	114.87	29,100	29,100		
15	V. R	28.12	01.06.2024	Libohove	2444	11	63	29,000	29,100		
16	S. B	25.03.2014	24.03.2024	Libohove	2444	JFK	5.7704	25,967		25,967	
17	E. N	22.09.2021	31.05.2024	Lunxheri	3513	52	15	4,000		4,000	
18	E. L	22.08.2022	21.08.2032	Libohove	2358	8	30.98	23,000	23,000		
19	A. R	14.10.2022	31.05.2025	Libohove	2444	JFK	39.7	11,200	11,200		
20	A. T	14.10.2022	31.05.2025	Libohove	2444	11	36	10,800	10,800		
21	A. T	14.10.2022	31.05.2025	Libohove	2444	11	18	5,400		5,400	
22	Th. D	02.11.2022	31.05.2025	Lunxheri	3513	50+JFK	83.6	27,000	27,000		
23	S. I	28.12.2022	31.05.2023	Libohovë	2444	JFK	6	1,500	1,500		
Total								1128.88	398,517	310,200	88,417

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

b. Kontrata për dhënien me qira të tokave bujqësore.

Bashkia Libohovë administron 13 kontrata qiraje për tokën bujqësore, nga të cilat 2 kontrata janë lidhur në vitin 2023 dhe 11 kontrata janë lidhur përgjatë viteve 2017-2020 dhe me afat kryesisht 99 vite. Tarifa e dhënies së tokës bujqësore është sipas përcaktimit në VKM-në 373 datë 20.06.2018 "Për tokën bujqësore", konkretisht 6,000 lekë/Ha/vit. Në një vit buxhetor, të ardhurat që pret të arkëtojë Bashkia Libohovë nga qiraja e tokës bujqësore janë gjithësej 379,506 lekë.

Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion të kontratave për dhënien me qira të tokës bujqësore, konstatohet se deri më datë 31.12.2023, për 7 kontrata nuk janë shlyer **detyrimet në vlerën totale 285,586 lekë e cila konsiderohet detyrim i pa arkëtuar nga debitorët e Bashkisë Libohovë**. Analiza e detajuar paraqitet si më poshtë:

Tabela nr.26

Viti 2023										
Nr.	Emër Mbiemër	NJA	Data e lidhjes së kontratës	Sipërfaqe m ²	Çmimi	Shuma në vite	Viti 2023	Debitor 31.12.2022	Likuiduar 2023	Debitor në total
1	E. D	Zagori	23.10.2017	13.29	6,000	79,740	79,740	0	79,740	0
2	V. S	Zagori	21.11.2018	0.92	6,000	5,520	5,520	0	5,520	0
3	K. K	Zagori	21.01.2019	3.64	6,000	21,840	21,840	53,246	43,680	31,406
4	J. Z	Zagori	07.05.2019	3.7	6,000	22,200	22,200	0	22,200	0
5	A. K	Zagori	02.01.2020	17.5	6,000	105,000	105,000	127,995	210,000	22,995
6	A. K	Zagori	27.01.2020	0.97	6,000	5,820	5,820	14,190	5,820	14,190
7	S. P	Zagori	13.02.2020	7.58	6,000	45,480	45,480	110,880	0	156,360
8	V. V	Qendër	31.07.2020	1.78	6,000	10,680	10,680	13,019	21,360	2,339
9	M. T	Libohovë	10.11.2020	0.44	6,000	2,640	2,640	0	2,640	0
10	P. M	Qendër	07.12.2020	2	6,000	12,000	12,000	0	12,000	0
11	S. I	Qendër	29.12.2020	0.155	6,000	930	930	0	930	0
12	S. N	Zagori	20.03.2023	8.495	6,000		50,970		6,000	44,970
13	D. R	Qënder	01.06.2023	2.781	6,000		16,686		3,360	13,326
Totali 31.12.2023						311,850	379,506	319,330	413,250	285,586

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Për arkëtimin e vlerës debitore të krijuar nga mospagesa e qirasë, nuk administrohet dokumentacion mbi masat e marra, pra zgjidhjen e kontratës në zbatim të kapitullit "zgjidhja e kontratës" në kontratën e lidhur ndërmjet palëve, si dhe padi gjyqësore me qëllim ngarkimin e shërbimit përmbartimor, për ekzekutimin me forcë të detyrimit.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 4 të kontratës.

c. Kontrata për dhënien me qira të hapësirave/sipërfaqeve për vendosjen e antenave telefonike.

Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, Bashkia Libohovë nuk ka lidhur asnjë kontratë të re për dhënien me qira të hapësirave/sipërfaqeve për vendosjen e antenave telefonike, por janë aktive 3 kontrata të cilat janë lidhur përpara periudhës objekt auditimi (kontratat të cilat kanë qenë aktive, janë rilidhur përsëri duke u shtuar afatin për përdorimin e tyre). Për vitin 2023 kanë qenë aktive 3 kontrata me sipërfaqe totale 440 m² me vlerë kontrate

670,000 lekë. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, për këto kontrata për vitin 2022 janë shlyer të gjitha detyrimet. Analiza e detajuar paraqitet si më poshtë:
Tabela nr.27

Nr.	Kompani telefonike	NJA	Data e lidhjes së kontratës	Sipërfaqe m ²	Çmimi	Viti 2022	Likuiduar	Debitor	Kamatëvonesa	Debitor në total
1	T. A	Zagori	29.01.2016	200m ²	300,000	300,000	300,000	0	0	0
2	A. T	Zagori	01.04.2017	200m ²	220,000	220,000	220,000	0	0	0
3	V SHA	Zagori	09.12.2021	20m ²	150,000	150,000	150,000	0	0	0
Totali 2023				440m²	670,000	670,000	670,000	0	0	0

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë

➤ Të dhënat mbi regjistrimin e subjekteve tatimpaguese dhe situatën e statusit të subjekteve aktiv dhe të mbyllur.

Sipas të dhënave të Sektorit të Tatim Taksave gjendja e subjekteve të biznesit privat që ushtrojnë aktivitet në territorin në juridiksionin e Bashkisë Libohovë paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.28

Nr.	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja Në fillim	Regjistrime të Reja	Mbyllur Aktivitetin	Gjendja në fund të vitit 2023
1	Biznesi Vogël	2023	52	1	3	50
2	Biznesi Madh	2023	5	0	0	5
	Gjithsej	2022	57	1	3	55

Nga të dhënat e pasqyrës, konstatohet se për periudhën objekt auditimi evidentohen 1 regjistrim i ri në biznesin e vogël dhe janë mbyllur 3 subjekte të biznesit të vogël, dhe për biznesin e madh nuk ka pasur regjistrime të reja dhe nuk është mbyllur asnjë biznes përgjatë vitit 2023, duke arritur në 55 biznese për Bashkinë Libohovë.

➤ Menaxhimi borxhit nga taksat e tarifave vendore. Auditimi i rasteve në lidhje me zbatimin e masave shtrënguese për arkëtimin e borxhit ndaj subjekteve debitorë.

Duke vlerësuar riskun e praktikave të menaxhimit të borxhit u përzgjedhën disa raste për auditimin e procedurave që janë kryer, për ndjekjen dhe procedurat e arkëtimin të borxhit në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, me ndryshime, nga ku rezultoi se:

Për vitin 2023 nuk janë ndjekur procedura të masave shtrënguese për uljen e borxhit tatimor përveç njoftimeve për likuidimin e detyrimeve tatimore. Të gjitha praktikat e paraqitura mungojnë procedurat e ndjekura për mbledhjen e detyrimeve të papaguara, por janë mjaftuar vetëm me njoftimet e subjekteve apo individëve, ku edhe ato janë të pjesshme.

- Për 55 subjekte, të identifikuar si debitorë në vlerën 5,693,600 lekë nuk është ndjekur procedura e nxjerrjes së Njoftimit për Pagesë të detyrimeve Tatimore dhe nuk është vazhduar me asnjë procedurë tjetër të parashikuar për arkëtimin e detyrimit.

Tabela nr. 29

Nr	Emri Mbiemri	Aktiviteti	Vlera debitorë deri 31.12.2023
1	V. (K) R	Ushqimore	375,158
2	H. T	Fure buke	153,600
3	K. H	Ushqimore	50,650
4	B. R	Berberan	167,000
5	Dh. L	Klub	224,569
6	E. T	Klub	182,483
7	F. H	Floktore	186,136
8	T. I	Ushqimore	160,672
9	B. T	Lojra fati	105,100
10	O. M	Floktore	175,250
11	Sh. B	Punume duralumini	252,202
12	A. F	Auto-servis	261,900
13	K. B	Bar-kafe	180,350
14	S. B	Ushqimore	177,625
15	A. R	Ushqimore	178,938
16	F. B	Kovacan	185,375
17	D. K	Kingalerike	141,725
18	Sh. B	Ushqimore	214,725
19	L. K	Fure buke	31,514
20	E. M	Bar-kafe	50,000

21	F. R	Bar-kafe	50,000
22	S. P	Bar-kafe	41,600
23	H. Z	Fure buke	50,000
24	S. C	Ushqimore	34,621
25	I. B	Marangozi	236,600
26	N. H	Bar-kafe	115,575
27	V. (L) R	Robaqepsi	147,409
28	S. H	Robaqepsi	64,300
29	D. B	Floktore	46,000
30	L. B	Artikuj te ndryshem	155,392
31	L. B	Bilardo	138,597
32	E. M	Marangozi	50,244
33	T. P	Ushqimore	50,000
34	A. I	Bar-kafe	25,000
35	A. P	Bar-kafe	50,000
36	A. R	Bar-kafe	50,000
37	G. C	Bar-kafe	29,167
38	A. Sh	Materiale-ndertimi	25,000
39	L. I	Bar-kafe	25,000
40	P. S	Farmaci	12,500
41	A. F	Auto-servis	25,000
42	E. I	Bar-kafe	25,000
43	A. M	Lojra fati	20,382
44	S.Sh.P.K.	Baxho	299,593
45	D. B	Bar-kafe	12,120
46	S. S	Dentist	7,745
47	D. Sh	Bar-kafe	17,518
48	A. B	Te ndryshme	32,587
49	G. P	Kultivim peshku	32,587
50	G. Zh	Kultivim peshku	32,587
51	R. D	Klub	5,400
52	K. M	Klub	6,000
53	A. D	Baxho	115,000
54	V. D	Baxho	142,900
55	E. K	Baxho	67,204
Total			5,693,600

Burimi: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Libohovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nuk ka asnjë urdhër ekzekutiv të mbledhjes me forcë të detyrimeve në bashkëpunim me institucionet e tjera për të minimizuar subjektet dhe familjet që nuk likuidojnë detyrimet.

-Nga dosjet e zgjedhura për auditim, nuk gjen zbatim ndryshimi ligjor i nenit 89 i ligjit të procedurave tatimore, ku thuhet se; **“Në funksion të mbledhjes së detyrimit tatimor të papaguar të tatimpaguesit, administrata tatimore mund të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 për qind të qarkullimit të realizuar, por jo më shumë se detyrimi tatimor, për të cilin ka filluar procedura e mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore, për llogari të detyrimeve tatimore të pashlyera të tatimpaguesit”**.

Për ndjekjen dhe arkëtimin e debisë së subjekteve debitore strukturat e Sektorit të Tatim Taksave Bashkia Libohovë, nuk ka ndërmarrë të gjitha masat që parashikojnë dispozitat e ligjit për procedurat tatimore, pasi në asnjë rast nuk kemi Urdhër sekuestrimi si dhe sekuestro e konfiskim të pasurisë, duke vepruar në mospërputhje ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, nenet 86-92 Kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” neni 93 dhe 94.

Gjithashtu nga Sektori i Tatim Taksave për asnjë nga subjektet, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, pasi janë njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë zbatuar një pjesë e procedurave për to, nuk është kërkuar kallëzim penal bazuar në nenin 181-Mos pagimi i taksave dhe tatimeve, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”,

Nga përpunimi i të dhënave të regjistrit të taksave dhe tarifave si dhe informacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Libohovë, konstatohet se nuk ka regjistrë të plotë për bizneset dhe familjarët me të gjitha të dhënat dhe detyrimet e për rrjedhojë nuk disponohen të dhëna të plota dhe të sakta për debitorët që në krijimin e tyre sipas llojit të taksave, si dhe nuk ka të dhëna për debitorët e krijuar para vitit 2018. Gjithashtu debitorët janë mbajtur jo në mënyrë progresive, por të shkëputur nga viti në vit, duke sjellë një mosevidentim të saktë të debitorëve nga viti 2018 deri në fund të vitit 2023, ku sipas të dhënave vlera e akumuluar e debitorëve për periudhën 2018-2023 është 27,982,677 lekë. Për ndjekjen dhe arkëtimin e debisë së subjekteve debitore strukturat e Sektorit të Tatim Taksave Bashkia Libohovë, nuk ka ndërmarrë të gjitha masat që parashikojnë dispozitat e ligjit për procedurat tatimore.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, me ndryshime, Kreut XI - “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” neni 93 dhe 94, me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime neni 181.

Agjentët tatimorë

Nga auditimi i dokumentacionit, rezulton se në përgjithësi, akt-rakordimet janë mbajtur çdo muaj, janë regjistruar në evidencat përkatëse, pavarësisht se nuk janë protokolluar në përputhje me kërkesat e Nenit 13 të Normave Arkivore në R.Sh.

Të ardhurat nga ASHK-ja derdhen automatikisht në fillim të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Libohovë brenda datës 5 të çdo muaji. Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë në Bashkinë Libohovë janë paraqitur si më poshtë:

Tabela nr. 30, Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë në Bashkinë Libohovë

		<i>000/lekë</i>
Agjenti Tatimor	Lloji i Taksës	2023
Drejtoria rajonale e tatimeve	Tatim i thjeshtuar mbi fitimin	10
D.R.SH.T rrugor	Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	2,617
Z.V.R.P.P (ASHK)	Taksa e kalimit të pronësisë	
DPT & DPD	Renta Minerare	
Ujësjiellës-Kanalizime	Taksë ndërtese	
	Tarifë shërbimi	
TOTALI		2,627

Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave të cilat vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, u konstatua se nuk ka një nivel të lartë realizimi.

Bashkia Libohovë nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet. N.q.s. krijohen baza të plota dhe gjithëpërfshirëse për të dhënat, do të jetë e mundur të bëhet një planifikim i saktë, real dhe i realizueshëm.

Mbi tarifën e lëshimit të licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, të Bashkisë Libohovë.

Për vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Libohovë mbi arkëtimin e taksës së licencimit për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të karburanteve për konsumatorët fundor, u shqyrtua dokumentacioni si vijon:

-Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar;

-Ligj Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

-Ligji nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar

-VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, me VKM nr.344, datë 19.04.2017;

-VKM nr.212, datë 16.03.2016 “Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngshëm të naftës (GLN)”.

-VKB për miratimin e paketës fiskale;

-Dosjet e licencimit të subjekteve, me përmbajtje: Licenca e dhënë për ushtrim aktiviteti, Ekstrakti i regjistrimit në QKB (në të cilin pasqyrohet lloji aktivitetit dhe vendet e ushtrimit të aktivitetit nga subjekti në Bashkinë Libohovë dhe NJA, që korrespondon me periudhën 01.01.2023-31.12.2023), Akti teknik i lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial; Leje mjedisore për ushtrim aktiviteti, Raporti teknik i lëshuar nga shërbimi i zjarrëfikses, Projekti teknik i vendit ku do të ushtrohet aktiviteti, vendosja e depozitave, Autorizimet për pagesë, Faturat e arkëtimit dhe pagesa e kryer nga subjekti;

-Paketa Fiskale e vitit 2023 dhe Rregullore e brendshme e Bashkisë Libohovë.

-Gjithashtu u kryqëzua informacioni me databasat e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial, institucioni që inspekton subjektet e tregtimit të karburanteve.

Tabela nr.31, Subjektet për të cilat administrohet dosje fizike dhe që kanë ushtruar aktivitet në vitin 2023 në Bashkinë Libohovë.

Nr.	Subjekti	Adresa	Nipti	Pajisur me Licenc		Licenc		Tarifa e aplikuar nga Bashkia	Pagesa e kryer	Rinovuar Licenca (nëse në vitin 2023 i ka mbaruar afati)	Pagesa e kryer
				Po	Jo	Fillon	Mbaron				
1	"L" shpk	Libohovë	J.....Q	Po	x	10.01.2019	09.01.2024	1,000,000	1,000,000	po	Po

Burimi: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Libohovë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Sipas të dhënave të paraqitura në Bashkinë Libohovë, për vitin 2023 e ushtron këtë aktivitet 1 subjekt. Nga auditimi i dosjes përkatëse të subjektit të mësipërm, konstatohet se në fund të vitit 2023 subjekti ka paguar detyrimet për vitin fiskal në vlerën 1,000,000 lekë.

Konkretisht subjektet janë:

1. "L" shpk me adresë Libohovë, subjekt i cili është i pajisur me autorizim 5 vjeçar me nr.2158 datë 31.12.2019 për tregtim me pakicë të karburanteve dhe gazit të lëngshëm të cilit i ka mbaruar afati në datë 09.01.2024 dhe sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ky subjekt ka rinovuar autorizimin pranë Bashkisë Libohovë me shkresën nr. 33 prot., datë 08.01.2024.

Përdorimi i të ardhurave.

-Buxheti nga të ardhurat e veta për vitin 2023 është realizuar përkatësisht në vlerën 12,269 mijë lekë, ku peshën kryesore brenda të ardhurave të veta, e zënë fondet e shpenzuara për shpenzime operative.

Tabela nr. 32, Përdorimi i të ardhurave – viti 2023

(000/lekë)

Nr.	Përshkrimi Shpenzimeve	Nga të ardhurat e veta
1	Paga 600	2,626
2	Sigurime shoqërore 601	1,079
3	Shpenzime Operative 602	7,698
4	Transferta Korrente te brendshme 604	
5	Transferta per familje dhe individe 606	600
6	Investime 230-231	166
7	Kuotë Qarku	100
	Totali	12,269

Burimi: Sektori i Financës, përpunuar nga grupi i auditimit KLSH-së

Për mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi znj. L. M, me detyrë ish Kryetare e Bashkisë Libohovë, z. Xh. S, me detyrë përgjegjës i sektorit të taksave dhe tarifave vendore. Nga ana e subjektit nuk janë paraqitur observime. Sa më sipër në mos përgjigje në afatet ligjore, Projekt Raporti i Auditimit, konsiderohet i mirëqenë dhe u vijua me hartimin Raportin Përfundimtar të Auditimit.

2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

3.3. Opinioni mbi pasqyrat financiare.

3.4. Verifikimi i inventarëve të Aktiveve Afatgjata Materiale sa prej tyre janë me certifikatë pronësie.

➤ Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare:

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese.

➤ Hartimi i pasqyrave financiare:

Për vitin 2023 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të MF nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

- Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.
- Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
- Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Flow).
- Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
- Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
- Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
- Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
- Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

Qasja dhe metodologjia e auditimit.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të disponueshme dhe të siguruara nga vetë subjekti. Në gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës për vitin 2023 ka marrë në konsideratë vlerën e precizionit **8,939 mijë lekë** për shpenzimet, sipas **Pasqyrës** më poshtë:

Pasqyra PF: Materialiteti për Bashkinë Libohovë 2023

000/Lekë

Emërtimi i Shpenzimeve 2023	Vlera e Popullatës	Faktori i Riskut (0.7-2-3)	Çështje për tu shqyrtuar
Paga (600)	58,669	0.70	6
Sigurime Shoqërore (601)	8,577	0.70	1

Mallra e Shërbime (602)	32,512	0.70	3
Investime të brend. (230-231)	317,234	2.00	88
Te tjera transfer. korrente (606)	29,973	0.70	3
Total	446,967		
Materialiteti në %	2%		
Materialiteti në vlerë	8,939		
Kalkulimi i precizionit			
Materialiteti	8,939		
Gabimi i lejuar (10% - 20%)	893		
Nëntotali	8,045		
Precizioni i planifikuar (80-90%)	90%		
Vlera e precizionit	7,240		

Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare:

Pasqyrat financiare të Bashkisë Libohovë për vitin 2023 janë të nënshkruara nga z. L. H me detyrë Kryetar i Bashkisë Libohovë në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe znj. F. B me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës (hartuesi i llogarive vjetore) në cilësinë e nëpunësit zbatues të cilat janë depozituar pranë Degës së Thesarit Gjirokastër me shkresën nr. 668 prot., datë 28.03.2024, brenda afatit ligjor të cilat janë konfirmuar më datë 29.03.2024.

Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:

Për vitin 2023 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokument i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor konstatohet se nuk ka diferenca. Për këtë është përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit:

Për t'u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor;

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditareve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

-Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Nga auditimi rezultoi që mbajtja e kontabilitetit dhe funksionimi i llogarive sintetike me llogaritë analitike, në Bashkinë Libohovë, mbahet në mënyrë manuale, që e bën më risk të lart për sa i përket sigurisë në saktësinë e informacionit që marrim nga ky sistem kontabiliteti pasi përdoret programi eksel për ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave kontabël të Njësisë dhe njësisive të vartësisë. Sektori i Financës në Bashkia Libohovë, regjistrimet e veprimeve kontabël, kryhen me program excel dhe jo me "Bartës informatik", të cilët janë programe informatike të

pamanipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë. Veprimet e kryera në këtë mënyrë ndikojnë në mosbesueshmërinë dhe riskun që bartin në vetvete këto programe duke qenë të ndryshueshme në çdo kohë, të cilat gjithashtu ndikojnë në pasaktësi të veprimeve kontabël e rrjedhimisht në rezultate jo korrekt. Kjo gjë çon dhe në mos kuadrim të drejtë dhe të saktë si dhe vonesa në kohë për gjetjen, korrektimin dhe sistemimin e gabimeve matematikore. Mungesa e programimit kompjuterik në hedhjen e të dhënave në shërbimin kontabël, ndikon në ngadalësimin e marrjes dhe përpunimit të informacioneve financiare, si dhe në cilësinë dhe saktësinë e evidencave kontabël dhe të pasqyrave financiare.

-Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues nuk është bërë në mënyrë të plotë, pasi nuk përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësive, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj,. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listë pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

-Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Sektori i Financës. Gjatë fazës së auditimit në terren u kryhen teste të detajeve dhe testeve thelbësore ku është konstatuar se, janë mbajtur tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2023 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2022. Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2023 konstatohet se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekset pjesë e pasqyrave financiare si dhe llogaritë sintetike kundrojnë me ato analitike. Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të Degës së Thesarit Gjirokastër për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël në llogarinë e 520 “Disponibilitete në Thesar” dhe në ditarin e bankës rezultojnë të jenë rakorduara, veprime të paraqitura në formatin e pasqyrës së lëvizjes në Cash viti 2023. Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore të vitit 2023, të pozicionit financiar të Bashkisë Libohovë (pasqyrat financiare të konsoliduara), Formati nr. 1, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme.

Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivit dhe pasivit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2023, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si më poshtë:

Aktivët Neto janë të barabarta me Aktivët - Pasivë = Aktivët Neto	1,272,355,513
Aktivët	1,352,708,419
Pasivët	80,352,906
Aktivët Neto	1,272,355,513

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2023 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike.

Aktivët Afatshkurtra më datë 31.12.2023 paraqiten në vlerën	161,299,118
Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre”	78,079,062
Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”	13,037,740
Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra”	70,182,316

A. AKTIVET

I. Aktivet Afat Shkurtra

1. Llogaritë e Klasës 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhen nga:

PF.1

000/Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2023	31.12.2022	Diferenca/Ndryshimi 2023-2022
531	Mjete monetare ne arkë	0	0	0
512,56	Mjete monetare në bankë	0	0	0
520	Disponibilitete në thesar	78,079,062	67,060,331	11,018,731
50	Letra me vlerë	0	0	0
532	Vlera të tjera	0	0	0
54	Akreditiva dhe paradhënie	0	0	0
59	Provizjone zhvlerësimi letra me vlerë (-)	0	0	0
Totali		78,079,062	67,060,331	11,018,731

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 78,079,062 lekë përbëhet nga gjendja e llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor” në vlerën 54,153,560 lekë dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 23,925,502 lekë. Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

2. Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

000/Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2023	31.12.2022	Diferenca/Ndryshimi 2023-2022
31	Materiale	3,597,872	95,720	3,502,152
32	Inventar i imët	9,439,868	13,662,321	4,222,453
33	Prodhime, punime e shërbime në proces	0	0	0
34	Produkte	0	0	0
35	Mallra	0	0	0
36	Kafshë në rritje e majmëri	0	0	0
37	Gjendje të pambrojtura ose pranë të tretëve	0	0	0
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	0	0	0
39	Provizjone për zhvlerësimin e inventarit (-)	0	0	0
Totali		13,037,740	13,757,951	720,301

Llogaritë e Klasës 3, sipas pasqyrës së pozicionit financiar në datën 31.12.2023, paraqitet në vlerën 13,037,740 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 3,597,872 lekë dhe llogaria 32 “Inventar i imët” 9,439,868 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 720,301 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” e cila paraqitet në vlerën -720,301 lekë.

-Llogaria 312 “Materiale”, ka vlerën 3,597,7812 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

000/Lekë

Lëvizjet e llogarisë	Vlera
Çelje e vitit 2023	95,720
Hyrje ma pagesë gjatë vitit 2023	3,517,409
Dalje gjatë vitit 2023	15,257
Gjendja në 31.12.2022	3,597,872

-Llogaria 327 “Inventarë i imët”, ka vlerën 9,439,868 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

000/Lekë

Lëvizjet e llogarisë	Vlera
Çelje e vitit 2023	13,662,231
Hyrje ma pagesë gjatë vitit 2023	423,100
Jashtë përdorimit VKB nr. 18 datë 03.04.2023	1,428,437
Transferuar Qarkut (Nga Shtepia e te Moshuarve)	2,918,136
Gjendja në 31.12.2023	9,439,868

Procesi i inventarizimit:

Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë së cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me eficiencë të tyre. Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës.

Për vitin 2023, Kryetari i Bashkisë Libohovë ka nxjerr Urdhrin nr. 120 datë 08.11.2023, me objekt “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të pasurisë së bashkisë për vitin 2023” i përbërë nga znj. A. Dh kryetar dhe anëtarët znj. S. T, z. G. Ç, z. A. Ç dhe znj. K. G. Me shkresën nr. 1640/1 prot., datë 29.12.2023, (Proces-Verbal) nga ana e anëtarëve të komisionit të inventarizimit fizik të aktiveve dhe nga verifikimi fizik i materialeve të zyrave të bashkisë, institucioneve arsimore dhe kryesive të fshatrave, kanë evidentuar pajisje dhe materiale të cilat kanë rezultuar jashtë funksionit me afat të plotësuar të përdorimit dhe të dëmtuara në vlerë 2,914,879 lekë.

Komisioni nuk ka hartuar raportin përmbledhës për inventarin fizik, së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit të nënshkruar nga secili punonjës që disponon aktive në ngarkim sipas kartelave përkatëse në kundërshtim me nenin 85, të Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” ku është përcaktuar se: *Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për:*

a) *Verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të njësisë publike dhe pasqyrimin e të dhënave të inventarizimit në procesverbalin përkatës, i cili ruhet gjatë periudhës së inventarizimit.*

c) *Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, vlerësim paraprak lidhur me cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzojë për veprime të mëtejshme nëpunësit autorizues”.*

86. *Personat e ngarkuar për kryerjen e inventarizimeve mbajnë sipas rastit përgjegjësi disiplinore, materiale a penale për moskryerjen me saktësi të inventarit.*

87. *Nëpunësi autorizues me të marrë dokumentacionin e inventarizimit, nxjerr urdhrin për ndjekje nga nëpunësi zbatues në lidhje me masat për kompensimin dhe sistemimin e diferencave të rezultuara.*

-Nga auditimi konstatohet se nuk është kryer i plotë procesi i inventarizimit për vlerën totale 19,372,484 lekë konkretisht për llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” në vlerën 5,645,745 lekë, llogarinë 212 “Ndërtime konstruksione” në vlerën 4,686,737 lekë, llogarinë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” në vlerën 8,296,835 lekë dhe llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” në vlerën 742,167 lekë të cila në kartelat analitike të secilës llogari janë të emërtuara “Vlerë tjetër” që i përkasin aktiveve të transferuara nga bilanci i ish-komunat (kjo problematikë është trajtuar në mënyrë të hollësishme në vijim të materialit sipas llogarive përkatëse).

Sa më sipër konstatohet se procesi i inventarizimit nuk është kryer sipas udhëzimit nr.30 dhe ka ndikim në informacionin kontabël të vitit 2023.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi punonjësit si vijon: znj. A. Dh kryetare dhe znj. S. T, z. G. Ç, z. A. Ç dhe znj. K. G, anëtarë.

3. Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2023	31.12.2022	Diferenca/Ndryshimi 2023-2022
	Llogari të arkëtueshme			
411	Klientë e llogari te ngjashme	0	0	0
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	0	0	0

000/Lekë

431	Tatime e taksa	0	0	0
432	Tatime mbledhur nga shteti për llogari Pushtetit Lokal	0	0	0
433	Fatkeqësi natyrore që mbulon shteti	0	0	0
435	Sigurime Shoqërore	0	0	0
436	Sigurime Shëndetësore	0	0	0
437,438	Organizma të tjerë shoqërore	0	0	0
44	Institucione të tjera publike	0	0	0
465	Efekte për t'u arkëtuar nga shitja letra me vlerë vendosjes	0	0	0
468	Debitorë të ndryshëm	37,709,035	36,929,950	779,085
4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	18,718,369	34,850,680	16,132,311
45	Marrëdhënie me institucione brenda dhe jashtë sistemit	0	0	0
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)	0	0	0
Totali		56,427,404	71,780,630	24,527,799
Të tjera aktive afatshkurtra				
409	Parapagime	0	0	0
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	0	0	0
477	Diferenca konvertimi aktive	0	0	0
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	0	0	0
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	13,754,912	28,894,056	15,139,144
Totali		13,754,912	28,894,056	15,139,144

Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” paraqitet më datën 01.01.2023, në vlerën 36,929,950 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 37,079,035 lekë me një rritje në vlerën 779,085 lekë. Në mënyrë të përmblodhur të dhënat paraqiten si më poshtë:

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”		000/Lekë
Çelje e vitit 2023		36,929,950
Shtesa (K)		779,085
Gjendja debitore në 31.12.2022		37,709,035

Në mënyrë të detajuar lista e debitorëve paraqitet në *aneksin nr.3.2* bashkëlidhur.

-Llogaria 4342 “ Të tjera Operacione me shtetin (të drejta)”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 18,718,369 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 0 lekë. Vlera prej 18,718,369 lekë përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, si dhe përbëhet nga:

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

Emërtimi i llogarive	Vlera	000/Lekë
Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”		0
Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”		13,754,912
Paqa personeli llogaria 42		3,426,735
Tatimi mbi të ardhurat llogaria 431		163,086
Sigurime shoqërore llogaria 435		1,211,750
Sigurime shëndetësore 436		161,886
Totali		18,718,369

Llogaritë e klasës 4, nuk kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5. Në kundërshtim me pikën 32, kreu III “Procedurat për Përgatitjen, Paraqitjen dhe Konsolidimin e Pasqyrave Financiare në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” të Udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 ku përcaktohet se: Kërkesat për arkëtim mbi debitorët si dhe detyrimet të paraqiten në pasqyrat financiare me vlerën e evidentuar në kohën e lindjes të së drejtës dhe detyrimit. Në zbatim të nenit 61 të Ligjit të Buxhetit, lidhur më njohjen e të ardhurave dhe shpenzimeve në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të drejtat dhe detyrimet, në fund të periudhës raportuese duhet të paraqiten në kontabilitet, si më poshtë:

- Të drejtat duhet të evidentohen në kohën e lindjes së tyre, ndërsa si të ardhura të njihen dhe evidentohen në pasqyrat financiare në çastin e arkëtimit të tyre në llogaritë financiare, duke mbajtur nën kontroll evidentimin e të ardhurave me baza rritëse (llogaria 7206 “Financim I pritshëm nga buxheti”), të cilat evidentojnë të drejta të njëjste të qeverisjes së përgjithshme në marrëdhënie me shtetin (llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”).

II. AKTIVET AFAT GJATA

1. Aktivet Afatgjata Jomateriale.

-Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 7,017,614 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime por është përlllogaritur amortizim i akumuluar në vlerën 47,500 lekë, ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 7,017,614 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

000/Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”	Vlera
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	7,065,114
	2	Amortizim i akumuluar	47,500
	3	Gjendja në 01.01.2023	7,017,614
	2	Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	0
	3	Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	0
	4	Kosto historike	7,065,614
	5	Amortizim i akumuluar	47,500
	6	Gjendja më datë 31.12.2022	7,017,614

000/Lekë

Studime-Projektme(kosto historike)	Gjendja 01.01.2023	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2023
Projekte. Objekte inventari				
Studim Projektimi “Rikonstruksioni i murit të jashtëm Zyrrave Njëisa Zagorie”	16,000			16,000
VNM “Rikonstruksion rruga Autostrada-Fshati Bulo”	35,600			35,600
Projekti “Rikonstruksioni i Shkollës Nepravishtë”	100,000			100,000
Projekti “Rikonstruksioni i rrugës Nepravishtë”	100,000			100,000
Projekti “Rikonstruksioni i qendrës së fshatit Nepravisht”	398,000			398,000
Projekti “Gjelbërim i Shkollës Nepravishtë”	22,200			22,200
Projekti “Gjelbërim Lab Poshtme”	22,200			22,200
Oponencë teknike për objektin “Rikonstruksioni i rrjetit të Ujësjellësit Libohovë”	262,325			262,325
Vlerë tjetër	5,645,745			5,645,745
Hartim projekti “Rikonstruksioni i Ujesjellësit Suhe”	52,800			52,800
Oponencë teknike për objektin “Rikonstruksioni i rrjetit të Ujësjellësit të pompimit dhe depove të ujit fshati Nepravishtë”	410,244			410,244
Projekti “Rehabilitimi i skemës ujitëse të Bulos si dhe Kanali Kullues K-I-76”	0			0
Projekti “Rikonstruksioni i rrjetit të Ujësjellësit të Qytetit Libohovë”	0			0
TOTALI	7,065,114	0	0	7,065,114

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

-Nga auditimi konstatohet se në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” është përfshirë vlera prej 5,645,745 lekë me emërtimin “Vlerë tjetër” e cila është e paanalizuar sipas studimeve dhe projekteve, për pasojë nuk është kryer inventarë fizik. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunave si pasojë e reformës territoriale në momentin e konsolidimit të bilanceve të ish-Komunave me bilancin e Bashkisë Libohovë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 5.

-Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata (Vlera Neto)” konstatohet se, për llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” për vitin ushtrimor 2023 nuk është përlllogaritur normë amortizimi. Në mbyllje të gjendjes së kësaj llogarie më datës 31.12.2023, është pasqyruar vlera e amortizimit të akumuluar në vlerën 47,500 lekë por kjo vlerë i përket amortizimit të akumuluar të çeljes së llogarisë më datë 31.12.2022. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kapitulli III “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 3.1, “Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, nënpika 36.

2. Aktivet Afatgjata Materiale

- Nga verifikimi dhe analiza e llogarisë 210 “Toka, troje, terrene” me vlerë 0 lekë, konstatohet se kjo llogari nuk paraqet gjendjen reale, pasi nuk janë pasqyruar në kartelat e kontabilitetit asnjë prej vlerave të trojeve nën objekt, të objekteve si godina e Bashkisë dhe trualli përreth saj, trojet e ndërtesave të shkollave, kopshteve e çerdheve, Shtëpisë së Kulturës, zyrave në Njësitë Administrative etj., sipas regjistrit të aktiveve të pasqyruar në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione”. Gjithashtu nuk mund të përcaktohet se vlera e pasqyruar në kontabilitet për llogarinë 212 “Ndërtime konstruksione” e cila paraqitet në vlerën 270,454,477 lekë më datë 31.12.2022, dhe në vlerën 272,570,167 lekë më datë 31.12.2023, përfaqëson apo jo vlerën e objekteve apo dhe vlerën e truallit nën këto objekte. Kjo përbën një klasifikim dhe paraqitje jo të saktë të vlerës pasi, ndërtesat amortizohen sipas normave të përcaktuara në SKK nr. 5, afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale” i përmirësuar, ndërkohë që trojet nën objekte janë të pa amortizueshme.

Nr.	Emërtimi i pronës	Nr. pas	Nr. dok. hipotekor	Data e regjistrimit	ZK	Adresa	Sip truall m ²	Sip nd. m ²	Pasqyruar ose jo ne bilancin e Bashkisë.
1	Truall & godine (ish shkolla 8 vjecare)	2/26&2/27	1327519	05.02.2017	2444	Libohove, Lagjia Caushli	487	192	
2	Truall&godine(Bashkia)	8/436	1377788	25.01.2017	2444	Libohove Lagjia Linua	1403.6	490	JO
3	Truall&godine(Muzeu Avni Rustemi)	14/150	1863962	14.02.2020	2444	Libohove	398	200.2	JO
5	Truall(Fshati Nivan), Zagorie	14/8	646802	13.02.2013	2805	Fshati Nivan	1776	-	JO
6	Ndertese&truall (Fshati Nivan) Zagorie.Godina e Spitalit	20/2	-	23.01.2013	2805	Fsahti Nivan	494	494	JO
7	Fshati Hoshteve, Zagorie. Truall&Ndertese. Ish shkolla	213/2	1601485	04.06.2018	1963	Fshati Hoshteve	92	92	JO

-Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione” më datën 31.12.2023, paraqitet në vlerën 0 lekë. Për sa i përket kalimit të sipërfaqeve të pyjeve dhe kullotave në zbatim të VKM nr. 433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive”, pika 29, shtojca nr. 27, e cila përmban listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Libohovë, me numër rendor 1 deri në 215, konstatohet se ky proces nuk është i evidentuar në pasqyrat financiare në llogarinë përkatëse. Lista përkatëse është në total 12,140 ha nga të cilat 7,918 ha kullotë verore 3,006 ha pyll, 1,027 ha kullotë dimërore, 146 ha tokë improduktive, 42 ha djerrë dhe 1 ha tokë buke. Në këtë llogari nuk ka të reflektuar sipërfaqet të cilat i kanë kaluar Bashkisë me VKM nr. 666, datë 21.05.2008, dhe VKM nr. 750, datë 28.05.2008, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të Qeverisjes Vendore, Komuna Qendër Libohovë, të Qarkut të Gjirokastrës”, ku përcaktohen në total 1,678 ha nga këto 413 ha + 401 ha kullotë dimërore (për secilën VKM) dhe 182 ha + 682 ha kullotë (për secilën VKM). Në llogarinë 211 “Pyje, kullota, plantacione” nuk janë pasqyruar sipërfaqet e trajtuara më sipër, në kushte të tilla kjo llogari nuk paraqet një pamje reale në pasqyrat financiare të vitit 2022.

-Procesi i përcaktimit të tokës dhe pronave shtetërore dhe ndarja e tyre në mes të agjencive shtetërore dhe njërive të qeverisjes vendore është një proces i cili ka nisur që nga viti 2001. Ky proces duhej zbatuar në bazë të Ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit” i ndryshuar, dhe Ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar.

Dispozita ligjore e fundit që trajton problematikën e procesit të pronësisë për njësitë e vetëqeverisjes vendore është Ligji nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, përcaktohet që: “Institucionet shtetërore dhe

njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit”, proces i cili duhet të përfundonte në muajin nëntor të vitit 2021.

Për asetet të cilat janë transefruar sipas VKM-ve të sipërpërmendura konstatohet se, në Bashkisë Libohovë nuk është realizuar inventarizimi i pasurive (pyje/kullota).

Pra nuk ka nisur procesi i transferimit të pronës që kalon në tre faza:

1. Identifikimi i statusit të inventarizimit, transferimit dhe regjistrimit të pronave shtetërore drejt njësisë së qeverisjes vendore, Bashkisë Libohovë;
2. Problematikat e procesit të transferimit dhe regjistrimit të pronave shtetërore;
3. Identifikimi dhe analizimi i opsioneve të përdorimit dhe menaxhimit të pronës shtetërore.

-Llogaria 212 “Ndërtim konstruksione” më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 270,454,477 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 2,115,690, dhe amortizim të akumuluar në vlerën 33,103,074 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 272,570,167 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në aneks nr 3.4 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit:

			000/Lekë
Referenca	Nr.	Llogaria 212 “Ndërtim Konstruksione”	Vlera
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	303,557,551
	2	Amortizim i akumuluar	33,103,074
	3	Gjendja në 01.01.2023	270,454,477
	2	Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	2,227,042
	3	Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	0
	4	Kosto historike	305,784,593
	5	Amortizim i akumuluar	33,214,426
	6	Gjendja më datë 31.12.2023	272,570,167

-Nga auditimi konstatohet se, në gjendjen e llogarisë **212** “Ndërtim konstruksione” për vlerën historike 305,784,593 lekë, është përfshirë vlera prej 4,687,737 lekë me emërtimin “Vlerë tjetër”, e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunave të Bashkisë Libohovë e paanalizuar e cila ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 5.

-Llogaria 212 “Ndërtim konstruksione” ka të evidentuara në kontabilitet një numër të konsiderueshëm objektesh nga ish-Komunat të cilat janë në verifikim për regjistrimin e tyre. Kjo vjen për arsye se një pjesë e objekteve janë të trashëguara dhe të mbartura nga njësitë që u shkrinë (ish/Komunat) në periudhat raportuese para vitit 2015 të pa shoqëruar me kartela objekti. Në këto kushte duke qënë se ka mospërputhje në administrimin për çdo objekt të “Ndërtesave e Konstruksioneve” nga Bashkia Libohovë, Sektori i Financës, Sektori Juridik, Sektori i Shërbimit Urban, në bashkëpunim ndërmjet tyre, duhet që të bëhet hedhja në kontabilitet e objekteve dhe sipërfaqeve të regjistruara saktësimi objekteve, dokumentimi me kartelë objekti, inventarizim fizik i objektit, si dhe rivlerësim me normat për secilin objekt. **Për sa më sipër llogaria 212 “Ndërtim konstruksione” nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2023.**

-Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 633,837,427 lekë kosto historike. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime dhe nuk është përllogaritur amortizim i akumuluar, ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 482,824,048 lekë neto, e pandryshuar. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në aneks nr 3.5 bashkëlidhur (RPA) Raportit Përfundimtar të Auditimit:

000/Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 213 "Rrugë rrjete vepra ujore"	Vlera
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	633,837,427
	2	Amortizim i akumuluar	151,013,379
	3	Gjendja në 01.01.2023	482,824,048
	2	Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	0
	3	Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	0
	4	Kosto historike	633,837,427
	5	Amortizim i akumuluar	151,013,379
	6	Gjendja më datë 31.12.2023	482,824,048

-Nga auditimi konstatohet se, në gjendjen e llogarisë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" për vlerën historike 633,837,427 lekë, është përfshirë vlera prej 8,296,835 lekë me emërtimin "Vlerë tjetër", e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunave të Bashkisë Libohovë e paanalizuar e cila ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Kreu II "Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" pika 5.

-Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b "Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata (Vlera Neto)" konstatohet se, për llogarinë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" për vitin ushtrimor 2023 nuk është përlllogaritur normë amortizimi. Në mbyllje të gjendjes së kësaj llogarie më datës 31.12.2023, është pasqyruar vlera e amortizimit të akumuluar në vlerën 151,013,379 lekë por kjo vlerë i përket amortizimit të akumuluar të çeljes së llogarisë më datë 31.12.2021. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kapitulli III "Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", pika 3.1, "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", nënpika 36.

-Nga auditimi i llogarisë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" konstatohet se, nuk është vlerësuar dhe evidentuar në këtë llogari vlera e rrugës prej 29 km e përbërë nga 15 km "Kthesë Libohovë-Selcke" dhe 14 km rruga "Poliçan-Nivan", të kaluara në pronësi të Bashkisë Libohovë me VKM nr. 915, datë 11.11.2015, "Për transferimin në pronësi, nga Këshillat e Qarqeve të Bashkisë, të rrjetit të rrugëve rurale dhe aseteve të luajtshme e të paluajtshme të ndërmarrjeve të mirëmbajtjes së këtyre rrugëve", pika 9, tabela 1, faqe 3.

-Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune" më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 13,233,045 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerë 4,623,788 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 4,278,772 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 11,102,532 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në aneks 3.6 bashkëlidhur RPA.

000/Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune"	Vlera
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	13,233,045
	2	Amortizim i akumuluar	4,278,772
	3	Gjendja në 01.01.2023	8,954,273
	2	Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	4,623,788
	3	Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	2,257,200
	4	Kosto historike	15,599,633
	5	Amortizim i akumuluar	4,397,101
	6	Gjendja më datë 31.12.2022	11,202,533

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

-Nga auditimi konstatohet se, në gjendjen e llogarisë 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune" për vlerën historike 15,330,645 lekë, është përfshirë vlera prej 742,167 lekë me

emërtimin “Vlerë tjetër”, e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunave të Bashkisë Libohovë e paanalizuar e cila ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Poashtu u konstatua se: **Kjo llogari ka pasaktësi në vlerat e paraqitura për mos kontabilizimin e vlerës 14,265,168 lekë**, për mallra të ndryshme të bëra hyrje në magazinë si më poshtë:

-Me flete hyrje nr. 15 datë 23.03.2023 janë bërë hyrje në magazinë mallra si: Tuba plastike, shtylla metalike ndricimi, krahë shtyllash, kabëll elektrik, puseta plastike dhe artikuj të ngjashëm në vlerë prej **5,358,874 lekë**, ardhur nga Fusha shpk.

-Me fletë hyrje nr.27 datë 03.05.2023 janë bërë hyrje në magazinë mallrat, cemento dhe hekur betoni në vlerën **6,795,276 lekë**, ardhur nga furnitori V shpk.

-Me fletë hyrje nr.29/1 janë bërë hyrje në magazinë mallrat, cemento në vlerën **2,111,018 lekë**, ardhur nga furnitori V shpk. Mos kontabilizimi i vlerës **14,265,168 lekë**, në Bilancin Kontabël të vitit 2023 ka sjellë një paraqitje jo të saktë për këtë llogari ekonomike dhe me deformim të informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2023 të **llogarisë 214** “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune”. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 5.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme për periudhën 01.01.2023 deri më datë 21.06.2023 ngarkohen me përgjegjësi: znj. E. P me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, për periudhën nga 01.01.2023 deri më datë 11.09.2023, Znj. F. B në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, për periudhën nga data 12.09.2023 deri më datë 31.12.2023, dhe S. Z ish/magaziner nga data 01.01.2023 deri më datë 31.12.2023 pasi nuk kanë kryer rakordime mujore me magazinën sipas pikës 46 të rregullores së brendshme.

-Llogaria 215 “Mjete transporti” më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 22,013,440 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa. Amortizim të akumuluar në vlerën 8,185,907 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja neto e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 13,827,533 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

000/Lekë

Referenca	Llogaria 215 “Mjete transporti”	Vlera
Ditari i veprimeve	Kosto historike	22,013,440
	Amortizim i akumuluar	8,185,907
	Gjendja në 01.01.2023	13,827,533
	Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	0
	Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	0
	Kosto historike	22,013,440
	Amortizim i akumuluar	8,185,907
	Gjendja më datë 31.12.2022	13,827,533

-Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata (Vlera Neto)” konstatohet se, për llogarinë 215 “Mjete transporti” për vitin ushtrimor 2023 nuk është përlllogaritur normë amortizimi. Në mbyllje të gjendjes së kësaj llogarie më datës 31.12.2023, është pasqyruar vlera e amortimit të akumuluar në vlerën 8,185,907 lekë por kjo vlerë i përket amortizimit të akumuluar të çeljes së llogarisë më datë 31.12.2022. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kapitulli III “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 3.1, “Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, nënpika 36.

000/Lekë

Nr.	Emërtimi	Personi përgjegjës	Sipas të dhënave kontabël	
			Sasia	Vlera
1	Autoveturë Benz Mercedes	Policia Bashkiake	1	1,188,000
2	Autoveturë Hunday Terracan	Shoferi i Bashkisë	1	778,800
3	Autoveturë Audi A6	Njësia Administrative Qendër	1	997,300
4	Autoveturë Benz	Njësia Administrative Qendër	1	720,000
5	Traktor T-28	Libohovë	1	167,100
6	Rimorkio Metalike	Libohovë	1	111,000
7	Motokultivator komplet	Libohovë	1	86,100
8	Rimorkio motokultivatori	Libohovë	1	37,140
9	Kamion TIP 814	Albert Feri	1	1,728,000
10	Kamion Mitsubishi FUSO	-	1	10,992,000
11	Ëolkëagen (Azile)	Libohovë	1	1,440,000
12	Iveko Magerus	MZSH	1	3,768,000
Totali			12	22,013,440

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

-Llogaria 218 “Inventar ekonomik” më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 26,287,295 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur pakësim në vlerë 6,333,588 lekë dhe amortizim i akumuluar në vlerën 9,620,132 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 10,333,575 lekë.

000/Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 218 “Inventar ekonomik”	Vlera
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	26,287,295
	2	Amortizim i akumuluar	9,620,132
	3	Gjendja në 01.01.2022	15,400,445
	2	Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	0
	3	Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	6,333,588
	4	Kosto historike	19,953,707
	5	Amortizim i akumuluar	9,620,132
	6	Gjendja më datë 31.12.2023	10,333,575

Shënim: (Analiza e llogarisë 218 “Inventar Ekonomik” nuk është pasqyruar në aktkonstatim për arsye madhësisë si evidencë por ky dokumentacion do të jetë pjesë e dosjes së auditimit në CD).

-Nga auditimi i llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, 214 “instalime teknike, makineri pajisje vegla pune”, janë të pa analizuar në kontabilitet, nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen analitikët e këtyre zërave si dhe nuk ka informacioni për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, në këto kushte nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik çdo vit për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet, pra na japin arsye të mos kemi siguri mbi vlerat në pasqyrat e pozicionit financiar për sa i përket këtyre llogarive për pasojë të mos japim dot një opinion mbi plotësinë, saktësinë dhe përkatësinë e këtyre vlerave në kontabilitet. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 6, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30, pika 74, dhe Udhëzimi nr. 05, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.

-Në llogaritë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, nuk janë reflektuar të gjitha ndërtesat, trojet, terrenet, rrugë, vepra ujore etj., të kaluara pas reformës territoriale, dhe Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 91, datë 14.10.2016, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohen për transferim në pronësi të njësive administrative qendër Libohovë të Bashkisë Libohovë”, në zbatim të Ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen

administrativo-territoriale të njëjësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të Ligjit nr. 8743 datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit, i ndryshuar, VKM nr. 840, datë 22.07.2009, “Për miratimin e inventarit të pronave të paluajtshme në Komunën Libohovë”, si dhe me Udhëzimin nr. 15, datë 30.06.2003, “Për mënyrën e paraqitjes nga Njësitë e Qeverisjes Vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të pronave të paluajtshme publike”.

-Për aktivet që i përkasin llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, për koston historike 937,394,978 lekë, Bashkia Libohovë posedon titull pronësie/pasuri të regjistruara në ASHK Gjirokastër sipas zonave kadastrale vetëm për tre objekte si më poshtë:

- Pasuria nr. 14/8 (Muzeu “Avni Rustemi”);
- Pasuria nr. 8/185 (Ndërtesa e Bashkisë);
- Pasuria nr. 2/27 (Kopështi Fëmijëve Hoxhallarë)

Ndërsa për pjesën tjetër të llogarive të sipërpërmendura nuk posedon titull pronësie. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, pika 1 dhe 2. Për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, Kapitulli III, pika 35.

-Vlen të theksohet se në Buxhetin Vjetor të vitit 2023 nuk janë parashikuar fonde për nisjen e procedurave për regjistrimin e aseteve të institucionit.

Për vitin 2023 nga auditimi i procedurës së mbajtjes dhe kontabilizimit të aktiveve rezultoi se jo çdo aktiv ishte i regjistruar dhe i kontabilizuar sipas dispozitave ligjore, por mungon kartela kontabël për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përkrahimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur, pra në formë analitike në mospërputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, pika 30.

3. Aktivet Afatgjata Financiare

Aktivët Afatgjata Financiare më datë 31.12.2023, paraqiten në vlerën 76,399,726 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

000/Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2023	31.12.2022	Diferenca/Ndryshimi 2022-2021
25	Huadhënie e nënhuadhënie	0	0	0
26	Pjesëmarrje në kapitalin e vet	76,399,726	76,399,726	0
	Totali	76,399,726	76,399,726	0

4. Investimet

Gjendja e llogarisë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet në vlerën 292,179,005 lekë, ku është kontabilizuar vlera për 6 kontrata punimesh të cilat janë në proces zbatimi punimesh. Nga testimi i kontratave konstatohet se nuk ka kontrata punimesh të cilat janë ende të pa likuiduara nga viti 2022. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

000/Lekë

Llogaria 231 “Për aktive afatgjata materiale”	
Çelje e vitit 2022	211,279,053
Shtesa (K)	81,968,335
Pakësime (D)	1,068,383
Gjendja debitore në 31.12.2023	292,179,005

000/Lekë

Nr	Llogaria 231 “Për aktive afatgjata materiale”	Celje	Kreditim	Debitim	Gjendje 2023
	01.01.2023	292,179,005			
1	Nertim palestere dhe rikonstr shkolla “A.Rustemi”		2,227,042	2,227,042	
2	Rikonstr ujesjellesi Libohove			24,888,900	
3	Furnizimi vendosje kamera (218)	-	719,000	719,000	719,000

4	Blerje tabelash sinjalistike (327)	-	179,988	179,988	179,988
5	Rikonstrukcion banese		166,200	166,200	
	TOTAL INVESTIME	292,179,005	3,126,030	28,181,132	317,234,107

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

B. PASIVET (DETYRIMET)

I. Pasivet Afatshkurtra

1. Llogari të pagueshme

Llogaritë e klasës 4 në Pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Libohovë më 31.12.2023, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2023, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

000/Lekë

Llogaria	Emërtimi i llogarisë	Viti 2023	Viti 2022
401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	0	0
42	Detyrime ndaj personelit	3,426,735	4,240,112
16,17,18	Hua Afat shkurtra		
460	Huadhenes		
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	163,086	165,775
432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
435	Sigurime Shoqerore	1,211,750	1,106,106
436	Sigurime Shendetesore	161,886	147,631
437,438,	Organizma te tjere shteterore		
44	Institucione te tjera publike		
45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere		
466	Kreditore per mjete ne ruajtje	23,925,502	22,747,375
467	Kreditore te ndryshem	13,754,912	29,191,056
4341	Operacione me shtetin(detyrime	37,709,035	36,929,950
49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
	Llogari të pagueshme	80,352,906	81,581,112

-Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në datën 31.12.2023, paraqitet në vlerën 0 lekë pra Bashkia Libohovë nuk ka fatura të pa likuiduara për këtë llogari.

-Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit” referuar pasqyrave financiare vlera 3,426,735 lekë përfaqëson vlerën e pagave për muajin dhjetor të vitit 2023 e cila mbetet për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

000/Lekë

Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”	
Çelje e vitit 2023	4,240,112
Shtesa (K)	
Pakësime (D)	813,377
Gjendja debitore në 31.12.2023	3,426,735

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2023, konstatohet se:

000/Lekë

Urdhër shpenzimi		Vlera
Nr.	Datë	
1	08.01.2024	794,639
3	08.01.2024	205,661
4	08.01.2024	294,250
5	08.01.2024	258,188
6	08.01.2024	1,666,820
7	08.01.2024	80,306
8	08.01.2024	705,141
Totali		4,005,005

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Vlera e kontabilizuar në llogarinë “Detyrime ndaj personelit” është 3,426,735 lekë ndërkohë që duke u bazuar në dokumentacionin justifikues (urdhër shpenzimet e realizuara nëpërmjet Degës së Thesarit Gjirokastrë) është në vlerën 4,005,005 lekë me një diferencë më pak në vlerën 578,270 lekë. Vlera e kontabilizuar në llogarinë “Detyrime ndaj personelit” paraqitet në

bilanc në vlerën 3,426,735 lekë. Kjo vlerë del nga sistemimi i vlerës 592,478 lekë e lenë si detyrë nga auditimi imëparshëm.

Në urdhër-shpenzime del vlera 4,005,005 lekë pagat për muajin dhjetor, por në fakt është 4,019,213 lekë.

Diferenca prej 14,208 lekë është një ndalesë page për vendime gjyqësore që kalon si kompesim ushqimor për femijën e një punonjësi (I mbahet nga paga prindit të punësuar sipas vendimit gjyqësor). Kjo vlerë është paguar me USH Nr.02 Datë 08.01.2024 Dhe duke përfshirë këtë vlera e pagës së dhjetorit është 4,019,213. Duke sistemuar vleren 592,478 lekë është kontabilizuar vlera 3,426,735 lekë.

-Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”, paraqitet në vlerën 163,086 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime nga Shtetit për muajin dhjetor.

000/Lekë

Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”	
Çelje e vitit 2023	165,775
Shtesa (K)	0
Pakësime (D)	2,689
Gjendja debitoare në 31.12.2023	163,086

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2024 konstatohet se:

000/Lekë

Urdhër shpenzimi		Vlera
Nr.	Datë	
11	08.01.2024	163,086
Totali		163,086

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

-Llogaria 435 “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2023 që paguhen në muajin janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerat 1,211,750 lekë dhe 161,886 lekë.

000/Lekë

Llogaria 435 “Sigurime shoqërore”	
Çelje e vitit 2023	1,106,106
Shtesa (K)	105,644
Pakësime (D)	0
Gjendja debitoare në 31.12.2022	1,211,750
Llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”	
Çelje e vitit 2022	147,631
Shtesa (K)	14,255
Pakësime (D)	0
Gjendja debitoare në 31.12.2023	161,886

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

-Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Libohovë në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 23,925,502 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Vlera e mësipërme është rakorduar me Degën e Thesarit Gjirokastrë.

000/Lekë

Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”	
Çelje e vitit 2023	22,747,375
Shtesa (K)	1,255,127
Pakësime (D)	60,000
Gjendja në 31.12.2022	23,925,502

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë

Në mënyrë analitike sipas objekteve dhe vitit që i përket paraqitet në pasqyrën, si më poshtë:

000/Lekë

Nr	Objekti	Subjekti	Vlera
1	Gjendje me 01.01.2023		22,730,375
2	Kreditime gjate 2023		1,255,127

3	"Rikonstruksion I rrejtë të ujesjellesit të qytetit Libohovë"	E KONSTRUKSION	35,819
4	"Rikonstruksion I rrejtë të ujesjellesit të qytetit Libohovë"	E KONSTRUKSION	8,782
5	"Rikonstruksion I rrejtë të ujesjellesit të qytetit Libohovë"	E KONSTRUKSION	1,115,526
6	Ndërtim palestere shkolla Avni Rustemi	E c	50,000
7	Pullat e gjendjes civile		45,000
3	Debitime gjate 2023		60,000
	Pullat e gjendjes civile		60,000
4	Gjendje me 31.12.2022		23,925,502

Për 2 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Libohovë janë ngurtësuar fonde në vlerën 99,458 lekë për të cilat nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Gjyrokastër, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Sektori i Shërbimit Urban dhe Sektori i Financës janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, dhe janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 99,458 lekë, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse. Veprime këto në përputhje me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

-Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm" paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat për vitin 2023 janë në vlerën 28,894,055 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur ritje në vlerën 1,294,745 dhe pakësime në vlerën 16,049,669 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 13,754,911 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm"		000/Lekë
Celje e vitit 2023		28,894,055
Shtesa (K)		1,294,745
Pakësime (D)		16,049,669
Gjendja kreditore në 31.12.2023		13,754,911

Në mënyrë analitike sipas objekteve dhe vitit që i përket paraqitet në pasqyrën, si më poshtë:

Nr	Emerimi	Celja	Shtesa	Pakësim	Mbetja
1	Rikonstruksion I rrugëve të brendshme të fshatit Suhe	138,000	0	0	138,000
2	Rikonstruksion I ujesjellesave Zagorie	74,400	0	0	74,400
3	Rikonstruksion dhe ndërtim palestere në shkollën 9-vjecare Avni Rustemi, Libohovë	2,227,042	0	2,227,042	0
4	Rikonstruksion Banese	166,200	0	166,200	0
5	Rikonstruksion I murit mbajtës të shkolles 9-vjecare Labovë e Poshtme	48,000	0	0	48,000
6	Mbikëqyrje punimesh për objektin "Mirembajtje kanale kulluese"	38,128			38,128
7	Mbikëqyrje punimesh për objektin "Rikonstruksion I murit mbajtës të shkolles 9-vjecare Labovë e Poshtme"	16,787			16,787
8	Mbikëqyrje punimesh për objektin "Rikonstruksion I murit të varrezave Libohovë"	22,166			22,166
9	Mirembajtje ura e Bulos	276,000			276,000
10	Mirembajtje e kanaleve kulluese	75,600			75,600
11	Karburant për nevojë të bashkisë	384,220	910,525	1,294,745	0
12	Akt marreveshje FSHU	10,841,536	0	2,100,000	8,741,536
13	Demshperblim për demin e shkaktuar në kullote	7,940,037		3,615,743	4,324,294
14	Demshperblim si pasojë aksident në punë me pasojë vdekje	5,437,212		5,437,212	-
15	Detyrim i mbetur për fature	1,208,727		1,208,727	-
	Total	28,894,055	910,525	16,049,669	13,754,911

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

-Llogaria 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)" sipas pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Libohovë në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerë 36,929,950 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)"		000/Lekë
Celje e vitit 2023		36,929,950
Shtesa (K)		779,085
Pakësime (D)		0

Shënim: (Shtesa në shumën prej 743,085 lekë i përket shtesës së debitorëve nga Tatim Taksat dhe vlera prej 36,000 lekë i përket një debitori ndaj Bashkisë, përfitimi i padrejtë page për një ish punonjës.)

TË ARDHURAT

1. Të ardhurat nga taksat dhe tatimet:

-Llogaria 70 “Të ardhurat nga taksat e tatimet”, në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 5,444,928 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 4,871,972 lekë me një pakësim në vlerën 572,956 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat nga taksat e tatimet paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

		000/Lekë	
Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
70	I. TË ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIME	4,871,972	5,444,928
700	1. Tatimi mbi të ardhurat	54,829	194,205
7000	Tatimi mbi të ardhurat personale	0	0
7001	Tatimi mbi fitimin	10,000	0
7002	Tatim mbi biznesin e vogël	54,289	194,205
7009	Të tjera tatime mbi të ardhurat	0	0
702	2. Tatimi mbi pasurinë	3,389,369	3,346,249
7020	Tatim mbi pasurinë e paluajtshme	3,389,369	3,346,249
7021	Tatim mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme	0	0
7029	Të tjera tatime mbi pasurinë	0	0
703	3. Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit	1,427,774	1,904,474
7030	Tatim mbi vlerën e shtuar (TVSH)	0	0
7031	Akciza	0	0
7032	Taksë mbi shërbimet specifike	0	0
7033	Taksë mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie	702	959
7035	Taksë vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	1,427,072	1,903,515
704	4. Taksë mbi tregtinë dhe transaksionet ndërkombëtare	0	0
7040	Taksë doganore për mallrat e importit	0	0
7041	Taksë doganore për mallrat e eksportit	0	0
7042	Tarifë shërbimi doganor e kalipostë	0	0
7049	Të tjera taksë mbi tregtinë e transaksionet ndërkombëtare	0	0
705	5. Taksë e rrugës	0	0
708	6. Të tjera tatime e taksë kombëtare	0	0
709	7. Gjoha e kamatë vonesa	0	0

2. Të ardhurat jo tatimore:

-Llogaria 71 “Të ardhura jo tatimore”, në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 2,911,294 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 2,688,526 lekë me një pakësim në vlerën 222,768 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat jo tatimore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

		000/Lekë	
Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
71	III. TË ARDHURA JO TATIMORE	2,911,294	3,031,198
710	1. Nga ndërmarrjet dhe pronësia	884,700	801,773
7100	Nga ndërmarrjet publike jo financiare	0	0
7101	Nga ndërmarrjet publike financiare	0	0
7109	Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia	884,700	801,773
711	2. Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare	11,781,426	1,989,931
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	1,302,350	1,289,370
7111	Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	0	0
7112	Taksë për veprime gjyqësore e noteriale	0	0
7113	Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve	456,700	685,800
7114	Të ardhura nga biletat	0	0
7115	Gjoha, kamatëvonesa, sekuestime e zhdëmtime	22,376	14,761
7116	Të ardhura nga transferimi i pronës, legalizimi i ndërtimeve pa leje	0	0
719	3. Të tjera të ardhura jo tatimore	22,400	119,950

3. Të ardhura të tjera:

-Llogaria 72 “Grante korente”, në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 173,714,754 lekë ndërsa në datën 31.12.2023 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 205,754,339 lekë me një rritje në vlerën 32,039,585 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë grante korente paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
72	V. GRANTE KORENTE	205,754,339	173,714,754
720	1. Grant korenti i brendshëm	205,754,339	163,970,274
7200	Nga Buxheti për NJQP (Qendrore)	100,179,203	80,422,929
7201	Nga Buxheti për NJQP (Vendore)	27,400,594	
7202	Nga Buxheti për pagesa të posaçme të ISSH	29,219,941	39,884,000
7203	Nga Buxheti për mbulim deficiti (ISSH e ISKSH)		
7204	Pjesëmarrje e institucioneve në tatime nacionale	4,221,645	3,641,355
7205	Financim shtesë për të ardhurat e krijuara brenda sistemit		
7206	Financim i pritshëm nga buxheti		
7207	Sponsorizime të brendshme (nga të tretët)		210,060
7209	Të tjera grante korente të brendshme	44,732,956	39,811,931
721	2. Grant korenti i huaj	0	9,744,480
	Nga Qeveri të huaja	0	9,744,480
	Nga Organizata Ndërkombëtare	0	0

SHPENZIMET

1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:

-Llogaria 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjësve” në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 51,612,376 lekë, ndërsa në datën 31.12.2023 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 58,669,817 lekë me një rritje në vlerën 7,057,441 lekë, si pasojë e rritjes së pagave bazuar në VKM nr.328 datë 31.05.2023.

-Llogaria 601 “Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 8,610,893 lekë, ndërsa në datën 31.12.2023 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 9,528,291 lekë me rritje në vlerën 917,398 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Gjirokastër me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar për llogaritë e pagave dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
6001	Paga, personel i përhershëm	58,669,817	51,612,376
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	8,557,662	7,732,705
6011	Kontribut i Sigurimeve Shëndetësore	970,629	878,188
	Totali	68,198,108	60,223,269

000/Lekë

2. Blerje mallra dhe shërbime:

Llogari e cila përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

-Llogaria 602 “Blerje mallra dhe shërbime”, në datë 31.12.2022, ka qenë në vlerën 21,439,916 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë në vlerën 32,512,017 lekë me rritje në vlerën 11,018,101 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Gjirokastër me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar e llogarisë blerje mallra dhe shërbime paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
602	III. BLERJE MALLRA E SHËRBIME	32,512,017	21,493,916
602	Mallra dhe shërbime të tjera		
6020	Materiale zyre e të përgjithshme	800,520	816,924
6021	Materiale dhe shërbime speciale	2,459,351	1,471,220
6022	Shërbime nga të tretët	6,956,429	4,277,582
6023	Shpenzime transporti	8,452,129	6,002,254
6024	Shpenzime udhëtimi	63,260	103,020
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	0	0
6026	Shpenzime për qiramarrje	0	0
6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale	10,515,347	6,046,400
6028	Shpenzime të lidhura me huamarrjen	56,000	0
6029	Shpenzime të tjera operative	3,208,981	2,776,516

000/Lekë

3. Subvencionet:

Përfshin ato shpenzime korrente të cilat konsiderohen si një mbështetje e qeverisë për subjekte prodhuese apo të shërbimeve, pavarësisht nga pronësia dhe përfituesi. Bashkia Libohovë nuk ka pasur subvencione.

4. Transferime korente:

Gjendja e llogarisë së fondeve **604 “Transferime korente të brendshme”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 269,580 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

Gjendja e llogarisë së fondeve **606 “Transferime për Buxhetet familjare e Individë”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 30,270,021 lekë, e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

<i>000/Lekë</i>			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
	V. TRANSFERIME KORENTE	30,270,021	41,931,825
604	1. Transferita korente të brendshme	269,580	201,475
6040	Transferime korente tek nivele tjera të Qeverisë	196,480	201,475
6041	Transferime korente tek institucione qeveritare të ndryshme	100,100	0
6042	Transferime korente tek sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	0	0
6044	Transferime korente tek organizata jo fitimprurëse	0	0
605	2. Transferime korente me jashtë	0	0
6051	Transferime për organizata ndërkombëtare	0	0
6052	Transferime për qeveritë e huaja	0	0
6053	Transferime për institucionet jo fitimprurëse të huaja	0	0
6059	Transferime të tjera korente me jashtë shtetit	0	0
606	3. Transferime për buxhetet familjare e individë	29,973,441	41,730,350
6060	Transferita të paguara nga ISSH e ISKSH	0	0
6061	Transferita të paguara nga institucione të tjera të organeve të pushtetit vendorë	29,973,441	41,730,350

Për vitin 2023 totali i te ardhurave në vlerë është 214,035,139 lekë dhe totali shpenzimeve është 159,881,579 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 54,153,560 lekë kuadron me gjendjen e llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor” në vlerën 54,153,560 lekë.

Auditim mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare dhe letrave me vlerë. Rregullaritetin i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës:

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët. Në përgjithësi përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listë pagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale.

Bazuar drejtimin e auditimit dhe MEMO e ardhur në rrugë elektronike më datë 24.04.2024, nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të Vetqeverisjes Vendore, u verifikua situata si më poshtë:

Departamenti i SHA në KLSH ka ushtruar në subjektin FSHZH, është konstatuar se ky subjekt ka realizuar procedurë prokurimi (marrëveshje kuadër), blerje përqendruar për disa nga bashkitë e vendit. Blerja është përqendruar në ato artikuj ku sipas vlerësimit që FSHZH ka bërë, ka menduar se janë më të përdorshme për veprimtarinë e bashkive.

Pas përfundimit të procedurës dhe lidhjes së kontratave me OE fitues, FSHZH ka paraqitur pranë bashkive nevojën që ato kanë për këto mallra. Bashkitë nga ana e tyre referuar mallrave të praruar nga FSHZH kanë bërë kërkesë për të cilën kanë lidhur marrëveshje për mallrat e nevojshëm, të cilat OE fitues ka vetë depozituar në çdo njësi vendore referuar marrëveshjes dhe dorëzuar me faturë dhe situacion. Nga ana e bashkisë Libohovë është dërguar shkresa me

nr.456 Prot., datë 05.04.2023, kërkesë drejtuar FSHZH për lëndë të para, ndërtimi, kanalizimi dhe mobilim urban.

Nga ana e grupit të auditimit u verifikuan hyrjet pa pagesë për mallrat si më poshtë:

Me flete hyrje nr. 15 datë 23.03.2023 janë bërë hyrje në magazinë mallra si: Tuba plastike, shtylla metalike ndricimi, krahe shtyllash, kabëll elektrik, puseta plastike dhe artikuj të ngjashëm në vlerë prej **5,358,874** lekë, ardhur nga Fusha shpk.

-Me fletë hyrje nr.27 datë 03.05.2023 janë bërë hyrje në magazinë mallrat, cemento dhe hekur betoni në vlerën **6,795,276 lekë**, ardhur nga furnitori V shpk.

-Me fletë hyrje nr.29/1 janë bërë hyrje në magazinë mallrat, çimento në vlerën **2,111,018 lekë**, ardhur nga furnitori V shpk.

-Me fletë hyrje nr.28 datë 10.05.2023 janë bërë hyrje në magazinë mallrat, Stola druri, kosha mbeturinash, dhe kosha të vegjël plastike në vlerën **3,724,800 lekë**, ardhur nga furnitori L Konstruksion shpk.

Në total vlera e mallrave bërë hyrje është **17,989,968 lekë**, e cila është bërë dhe dalje sipas nevojave. Nga verifikimi i urdhër shpenzimeve është identifikuar një procedurë blerje e vogël për materiale ndricimi për artikujt; drita braco led, drita te thjeshta, zvogëlues, portollamba, izolant dhe kabëll nga OE B-S me vlerë totale **287,520** lekë. Nga auditimi i bankës nuk ka rezultuar blerje me mbivendosje për mallra të njëjta apo të ngjashme.

-Për vitin 2023, numri i punonjësve është miratuar me Urdhrin nr.04, datë 19.01.2023, të Kryetarit të Bashkisë dhe VKB nr.72, datë 19.12.2022, me objekt “Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve, të zgjedhur dhe të emëruar të Bashkisë Libohovë dhe Njësi Administrative për vitin 2023”, ndërsa niveli i pagave është miratuar me VKB nr.74, datë 19.12.2022, me objekt “Për miratimin e nivelit të pagave dhe shpërblimeve të punonjësve të zgjedhur dhe të emëruar të Bashkisë Libohovë dhe Njësi Administrative”, për të cilat është shprehur ligjshmëria nga Prefekti Qarkut Gjirokastër me shkresën nr.1253/1 prot., datë 06.01.2023.

Nëpunësit e Bashkisë Libohovë i rregullojnë marrëdhëniet e punës në nivel, përgjegjës sektori apo specialist me Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të tij, për sa i përket punonjësve administrativ dhe terrenit i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Planifikimi dhe realizimi i strukturës organizative së bashku me ndryshimet përkatëse paraqiten si më poshtë:

000/Lekë

Nr.	Pozicionet e Punës	Nr.punonjësve të planifikuar	Fakti	Diferenca
1	Të zgjedhur	2	2	
2	Pozicione Politike	5	4	1
3	Pozicione të shërbimit civil	20	18	2
4	Punonjës në mirëmbajtje	28	28	
5	Pozicione të deleguara (Gjendja civile Civile)	1	1	
6	Policia Bashkiake	2	2	
7	Arsimi parashkollor	6	6	
8	Arsimi9-vjeçar/mesëm	5	5	
9	Inspektor i mbrojtjes së territorit	1	1	
10	Nëpunës zyrash me arsim të mesëm	5	5	
11	MZSH	14	14	
12	Shofer administrate/makinerish	3	3	
Totali		92	89	3

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Duke u bazuar në të dhënat e sipërpërmendura konstatohet se, për vitin 2023 për punonjësit që i rregullojnë marrëdhëniet me anë të Shërbimit Civil realizimi i strukturës është në masën 90% ndërsa për punonjësit që rregullojnë marrëdhëniet me Kod Pune realizimi i strukturës është në masën 99%. Në total realizimi i strukturës është në masën 98%.

Nga auditimi i zbatimit të strukturës organizative të Bashkisë Libohovë konstatohet se në total struktura është e përbërë nga 20 punonjës të cilët i rregullojnë marrëdhëniet e punës me

Shërbim Civil dhe 72 punonjës me Kod Pune. Në strukturën e punonjësve civil janë bashkuar edhe 3 punonjës që rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune. Kjo situatë ka ndodhur për shkak se, vendet vakante të cilat janë hapur për shërbimin civil nuk janë plotësuar si pasojë e mos aplikimit nga personat e interesuar.

Listë pagesat përfshijnë pagën e grupit (klasifikimin e diplomës së nivelit të dytë në master shkencor ose profesional sipas rastit), pagën për funksion (niveli i klasifikuar), raportet mjekësore të paguara nga punëmarrësi, shtesa vjetërsi (klasifikimi në vit, % dhe në vlerë), paga bruto, ndalesat (sipas rastit, pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore 9.5%, pagesat e kontributeve të sigurimeve shëndetësore 1.7% tatimi mbi pagën). Listë prezencat janë hartuar sipas ditëve gjithsej të punës për çdo punonjës. Paga e aplikuar minimale dhe paga maksimale në përputhje me VKM nr. 158, datë 12.03.2022, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” dhe VKM nr. 328, datë 31.5.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”. Për sa i përket shpërblimeve për orët jashtë orarit të punës janë aplikuar vetëm për punonjësit e MZSH-së (punonjës zjarrfikës), ndërsa për punonjësit e tjerë të institucionit nuk ka, për shkak se nuk janë shfrytëzuar orët jashtë orarit zyrtar, pasi punonjësit i përmbahen 40 orëve në javë, sipas orarit të shpallur në rregulloren e brendshme të institucionit.

Nga auditimi i listëpagesave konstatohet se, punonjësit janë trajtuar me pagë grupi në përputhje me VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, Lidhja nr. 9.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme për periudhën 01.01.2023 deri më datë 21.06.2023 ngarkohen me përgjegjësi: znj. L. M me detyrë ish/Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe znj. E. P me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, për periudhën nga 01.01.2023 deri më datë 11.09.2023, znj. F. B në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, për periudhën nga data 12.09.2023 deri më datë 31.12.2023. z. S. Z me detyrë magazinier, për periudhën 01.01.2023 deri më datë 02.06.2023.

Nga ana e subjektit nuk janë paraqitur observime. Sa më sipër në mos përgjigje në afatet ligjore, Projekt Raporti i Auditimit, konsiderohet i mirëqenë dhe u vijua me hartimin Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.4. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.

Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. 425/6 prot., datë 03.10.2023, dhe protokolluar në Bashkinë Libohovë me nr. 596/14 prot., datë 05.10.2023, rezulton se:

Nga Bashkia Libohovë me shkresën nr. 596/17 prot., datë 24.10.2023 është kthyer përgjigje në respektim të afatit 20 ditorë, referuar shkronjën (j), të nenit 15, të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Në lidhje me zbatimin e aftit 6 mujor, referuar pikës 2 të nenit 30, të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, afati nuk është zbatuar nga subjekti, pasi programi i auditimit në subjekt është brenda këtij afati.

Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve, nga verifikimi rezulton se:

a- Nga **24 masa organizative** të rekomanduara, janë pranuar 100 % nga subjekti. Nga të pranuarat janë zbatuar 9 masa, 1 masë është zbatuar pjesërisht dhe **14 masa nuk janë zbatuar.**

b- Nga 2 masa shpërblim dëmi me vlerë **313 mijë lekë**, janë pranuar 100 % nga subjekti. Nga të pranuarat rezulton se **2 masa nuk janë zbatuar.**

c- Nga 2 masa për uljen e borxhit tatimor me vlerë **25,363 mijë lekë**, janë pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat rezulton se **2 masa nuk janë zbatuar.**

d- Nga 1 masë për eliminimin e efekteve negative me vlerë **5,962 mijë lekë**, janë pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat rezultojnë se **1 masë nuk është zbatuar**.

e- Nga 2 masa disiplinore, janë pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat rezultojnë se **2 masa janë zbatuar**.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, shkronja “j”. Shkresa nr.683/26 prot, datë 23.05.2022 e dërgimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe rekomandimeve për përmirësimin e situatës.

Më hollësisht rekomandimet e pazbatuara, zbatuar pjesërisht/proces, për të cilat nga KLSH rikërkohet zbatimi i tyre, paraqiten si më poshtë vijon (numrat rendor janë sipas renditjes në shkresën përcjellëse dërguar subjektit):

A. MASA ORGANIZATIVE:

1.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Libohovë të marrë masa që nga secili sektor të hartohet regjistri i riskut, për evidentimin e rrisqeve që rrezikojnë objektivat e institucionit dhe minimizimin e efekteve negative të tyre dhe, mbi bazën e tyre të hartohet regjistri i riskut për institucionin. Të hartohet harta e proceseve të punës dhe gjurma e auditimit për këto procese. Këto dokumente të miratohen nga Kryetari i Bashkisë.

1.2.Rekomandim: Nga Bashkia Libohovë, Sektori i Burimeve Njerëzore të hartohen rregulla të shkruara lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja për punonjësit, marrëdhëniet e punës së të cilëve rregullohen me Kodin e Punës.

Deri më 30.11.2023

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme rezultojnë se: Nuk është hartuar regjistri i riskut për secilin sektor dhe nuk janë hartuar rregulla të shkruara lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja për punonjësit, marrëdhëniet e punës së të cilëve rregullohen me Kodin e Punës.

Statusi: Rekomandimi 1.1 i pazbatuar

Statusi: Rekomandimi 1.2 i pazbatuar

4.1.Rekomandim: Bashkia Libohovë, nëpërmjet Sektorit të Financës dhe Sektorit të Tatim Taksave, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime të studiuar dhe realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i shpenzimeve, me qëllim që shpenzimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për tu realizuar. Nëse gjatë vitit ka mosrealizim të të ardhurave të planifikuara, atëherë me vendim të këshillit bashkiak, duhet të korrigjohet edhe plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion me shkresë nr.1567 Prot., datë 17.11.2022 sektori i taksave i ka paraqitur sektorit të financës planifikimin e të ardhurave për vitin 2023. Nuk ka paraqitur ndryshime, vendime të këshillit bashkiak, ku paraqitet ndryshimi i plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Statusi: Rekomandimi 4.1 i pazbatuar

5.1.Rekomandim: Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të marrin masa që gjatë vitit buxhetor të hartohen raporte 4 mujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, me të cilat të njihet këshilli bashkiak dhe njëkohësisht të dërgohen edhe në Ministrinë e Financave.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se raporti 4 mujorit të parë nuk është hartuar, ndërsa raporti 8 mujor është dërguar jashtë afatit në MF.

Statusi: Rekomandimi 5.1 i pazbatuar

6.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Libohovë dhe Sektori i Financës të marrin masa që të eliminohet fenomeni i krijimit të detyrimeve të reja të prapambetura gjatë vitit buxhetor. Për këtë të bëhet likuidimi i vlerës së kontratës të lidhur midis Bashkisë Libohovë dhe kontraktorëve, sipas afateve të përcaktuar në kontratë, duke eliminuar në këtë mënyrë shkaku e krijimit të detyrimeve të prapambetura. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi që parashikon procedura e prokurimit do të jetë në dispozicion (në llogarinë e thesarit) të autoritetit kontraktor. Gjithashtu të marrë masa që gjatë planifikimit dhe zbatimit të buxhetit, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se: Llogaria 467 “kreditore të ndryshëm” janë ulur në vlerën 15,436,144 dhe ka mbetur vlera 13,754,912 për tu shlyer gjatë vitit 2024.

Statusi: Rekomandimi 6.1 zbatuar pjesërisht.

8.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Libohovë, të vijojë punën për arritjen e një aktmarrëveshje me shoqërinë “U. K Libohovë” ShA, me qëllim që kjo e fundit të kryej rolin e agjentit tatimor, për taksat dhe tarifat vendore për kategorinë e taksapaguesve familjare. Për këtë të meret miratimin e Këshillit Bashkiak.

Deri më datën 31.12.2023

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se: Bashkia Libohovë nuk ka lidhur akt-marrëveshje me shoqërinë “U. K. Libohovë” ShA për të kryer rolin e agjentit tatimor, për taksat dhe tarifat vendore për kategorinë e taksapaguesve familjare.

Statusi: Rekomandimi 8.1 i pazbatuar

9.1.Rekomandim: Bashkia Libohovë të marrë masa që gjatë procesit të dhënies së ndërtesave me qira, të bëjë skualifikimin e të gjithë subjekteve konkurruese të cilët nuk vërtetojnë se plotësojnë dokumentacionin e kërkuar nga Bashkia Libohovë.

9.2.Rekomandim: Bashkia Libohovë të marrë masa që në hartimin e kontratave për dhënie me qira të ndërtesave/objekteve, të përcaktojë se detyrimet për konsumin mujor të energjisë elektrike dhe të ujit, janë të qiramarrësit. Të përcaktohet person apo strukturë për monitorimin e kontratave të dhënies me qira të ndërtesave

Menjëherë dhe në vijimësi.

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se: Nuk ka dokumentim për ecurinë e këtyre rekomandimeve.

Statusi: Rekomandimi 9.1 i pazbatuar

Statusi: Rekomandimi 9.2 i pazbatuar

10.1.Rekomandim: Nga Nëpunësi Zbatues të hartohet rregjistri kontabël i aktiveve sipas llogarive kontabël, duke evidentuar të gjithë elementët e nevojshëm si vendndodhjen e pronës, sipërfaqen e saj etj., për të gjitha pronat që administron Bashkia Libohovë.

10.2.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Libohovë të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për inventarizimin në teren e të gjitha pronave që administron Bashkia Libohovë, për të përcaktuar dhe verifikuar situatën faktike, nëse ekzistojnë në teren të gjitha pronat ashtu si ato paraqiten në VKM përkatëse nëpërmjet të cilave janë transferuar në Bashkinë Libohovë. Në përfundim të procesit të inventarizimit të informohet Kryetari i Bashkisë për rezultatet e këtij procesi.

10.3.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Libohovë të marrë masa që nga strukturat përkatëse të përgatiten dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK të të gjitha pronave

që administron. Sektori i Financës të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Menjëherë

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se: Nuk ka hartuar rregjistrin kontabël i aktiveve sipas llogarive kontabël, duke evidentuar të gjithë elementët e nevojshëm si vendndodhjen e pronës, sipërfaqen e saj etj., për të gjitha pronat që administron Bashkia Libohovë.

Statusi: Rekomandimi 10.1 i pazbatuar

Statusi: Rekomandimi 10.2 i pazbatuar

Statusi: Rekomandimi 10.3 i pazbatuar

11.1.Rekomandim: Nëpunësi Zbatues të ngrejë grup pune me specialistë të fushës për saktësimin e:

-Vlerës 5,645,745 lekë, me emërtimin “Vlerë tjetër” në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime”;

-Vlerës 4,687,737 lekë, me emërtimin “Vlerë tjetër” në llogarinë 212 “Ndërtime konstruksione”;

-Vlerës 8,296,835 lekë, me emërtimin “Vlerë tjetër” në llogarinë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”;

-Vlerës 742,167 lekë, me emërtimin “Vlerë tjetër” në llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune”.

Deri më datën 31.12.2023

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se nga Bashkia Libohovë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: Rekomandimi 11.1 i pazbatuar

12.1.Rekomandim: Nga Sektori i Financës të merren masa që për llogaritë 202 “Studime dhe kërkime” dhe llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, të bëhet llogaritja e vlerës së amortizimit, sipas normave që përcakton kuadri ligjor në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se nga Bashkia Libohovë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: Rekomandimi 12.1 i pazbatuar

18.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Libohovë të marrë të gjitha masat për ngritjen e strukturës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Teritorit Vendor, duke respektuar kriteret e arsimit, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Deri më datën 31.10.2023

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se nga Bashkia Libohovë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi: Rekomandimi 18.1 i pazbatuar

A.1. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Bashkia Libohovë është audituar nga KLSH në vitin 2022 dhe në përfundim të procesit të auditimit, me shkresën Nr. 801/1 Prot., datë 19.12.2022 është dërguar raportit përfundimtar i auditimit, si dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes. Rekomandimet e dhëna nga KLSH, si dhe statusi i zbatimit të tyre nga Bashkia Libohovë është si vijon:

20.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë të analizojë situatën e moszbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën Nr. 801/1 Prot., datë 19.12.2022, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave të ngarkuar për zbatimin e tyre. Të marrë të gjitha masat e

duhura ligjore për të përshpejtuar punën për zbatimin e rekomandimeve në proces zbatimi, si dhe për zbatimin e plotë të rekomandimeve të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si vijon:

Masa Organizative

1.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Libohovë të marrë masat e duhura për njohjen nga stafi të kuadrit ligjor në fuqi për MFK, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, hartimin e regjistrit të riskut, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë efekt negativ në arritjen e objektivave të institucionit. Të hartohet gjurma e auditimit për të gjitha proceset kryesore të aktivitetit të institucionit.

6.1.Rekomandim: Nëpunësi zbatues të marrë masa për hartimin dhe plotësimin e regjistrit të aktiveve me të gjithë elementët e tij të domosdoshëm, me qëllim identifikimin në këtë dokument të të gjitha aktiveve të njësisë vendore, si dhe uljen e riskut nga humbjet dhe keq menaxhimin e tyre.

8.1.Rekomandim: Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të marrin masa për hartimin e raporteve periodike 4 mujor të monitorimit të zbatimit të buxhetit dhe këto raporte ti paraqiten për njohje këshillit bashkiak, Ministrisë së Financave.

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se nga Bashkia Libohovë nuk janë marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme.

Statusi: Rekomandimi 1.1 zbatuar pjesërisht.

Statusi: Rekomandimi 6.1 i pazbatuar

Statusi: Rekomandimi 8.1 i pazbatuar

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga Titullari i Njësisë Publike, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **313,418 lekë**, si më poshtë:

1.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Libohovë dhe Nëpunësi Zbatues, të ndjekin të gjitha procedurat e duhura ligjore, për arkëtimin e vlerës **76,000 lekë të përfituar padrejtësisht nga paga e grupit, përkatësisht vlerës 36,000 lekë nga Z. L. B dhe vlerës 40,000 lekë nga Znj. E. L.**

Deri më 31.12.2023

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se: Janë kyer ndalesat për punonjësen E. L në shumën, 40,000 lekë. Nuk janë mbajtur ndalesat për punonjësin L. B, pasi rezulton i larguar nga puna por është kontabilizuar si debitor në llogarinë ekonomike 468 “Debitorë të ndryshëm”

Statusi: Rekomandimi 1.1 zbatuar pjesërisht

2.1.Rekomandimi: Bashkia Libohovë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **237,418 lekë pa TVSH** nga shoqëria “C” SHPK, për volume punimesh të likuajuara, por të pakryera në fakt sipas kontratës Nr. 626 prot., datë 11.05.2020, me objekt “Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të qytetit Libohovë” Bashkia Libohovë. Vlera e mësipërme përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe njësisë vendore.

Deri më 30.11.2023

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se deri në këtë fazë nuk ka ecuri për ndjekjen e hapave të nevojshëm administrativ, apo arkëtuar.

Statusi: Rekomandimi 2.1 i pazbatuar

C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR, PËR TË RRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA.

1.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Libohovë, zyra e taksave vendore dhe zyra juridike, të marrin të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa paguara nga kategoria e taksapaguesve privat dhe familjar në vlerën 25,044,459 lekë.

Deri më datën 31.12.2023

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se nga Bashkia Libohovë nuk është marrë asnjë masë.

Statusi: Rekomandimi 1.1 i pazbatuar

2.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkia Libohovë, të ndjek të gjitha procedurat e duhura ligjore, për arkëtimin e vlerës **319,330 lekë**, të cilat janë detyrime kontraktuale të pa paguara nga 5 qiramarrësit e tokës bujqësore, si vijon:

- 1.K. K për vlerën 26,62 lekë;
- 2.A. K për vlerën 127,995 lekë;
- 3.A. K për vlerën 7,095 lekë;
- 4.S. P për vlerën 55,440 lekë;
- 5.V. V, për vlerën 13,019 lekë.

Deri më 30.11.2023

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se nga Bashkia nuk është marrë asnjë masë për arkëtimin e detyrimeve të papaguara nga qiramarrësit e tokës bujqësore.

Zbatimi: Rekomandimi 2.1 i pazbatuar

D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË TYRE.

1.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Libohovë të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e dëmshpërblimit, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se nga Bashkia Libohovë nuk është marrë asnjë masë.

Zbatimi: Rekomandimi 1.1. i pazbatuar

Sa më sipër për veprime dhe mosveprimet e konstatuara mbajnë përgjegjësi punonjësit e caktuar për realizimin dhe ndjekjen e zbatimeve të rekomandimeve si vijon: znj. A. Dh, z. K. C, z. Xh. T, znj. S. T dhe znj. F. B.

Subjekti Bashkia Libohovë ka dërguar shkresën me nr.678/14 prot., datë 28.06.2024, protokolluar në KLSH me shkresën nr.435/6 prot., datë 04.07.2024, ku citon se Bashkia Libohovë konfirmon njohjen me Projekt Raportin e Auditimit. Grupi i auditimit vijon me hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit

2.5. Të ndryshme të dala gjatë auditimit.

-Gjatë auditimit nuk ka pasur çështje të tjera, veç çështjeve të programit të trajtuara më sipër.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:

Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE.

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se ka mangësi në njohjen dhe zbatimin e pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si më poshtë vijon:

-Konstatohet se përbërja e GMS nuk është në përputhje me kuadrin rregullator të fushës, pasi nuk janë miratuar si anëtar të GMS të gjithë menaxherët e nivelit të lartë.

- Nuk ka programe të trajnimit për zhvillimin profesional të stafit.

- Për vitin 2023 nuk ka pasur plan-veprimi për MFK.

- Rregullorja e brendshme e bashkisë nuk reflekton plotësisht ndryshimet në strukturën e bashkisë. Në raste të caktuara detyrat nuk janë të qarta dhe të plota.

- Në strukturën organizative nuk janë përcaktuar qartë ndarja e detyrave konkrete ligjore që do kryhet dhe përcaktuar punën e secilës strukturë në veçanti si dhe të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

- Sektori i Tatim Taksave nuk është në përputhje me funksionet që kryen ky sektor, konkretisht, magazinieri, shoferi i administratës dhe mirëmbajtësi i godinave nuk kryejnë funksionet e përcaktuara në nenin 44 të rregullores së Bashkisë Libohovë, për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore.

- Në Bashkinë Libohovë nuk është hartuar “Harta e proceseve të punës”.

- Nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut.

- Nuk dokumentohet monitorimi i risqeve nga çdo drejtues pranë Bashkisë Libohovë.

- Në Bashkinë Libohovë, Sektori i Financës për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin EXCEL dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë. Sektori i të Ardhurave nuk ka një sistem informatik për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, por veprimet kryen në programin EXCEL, pra edhe këtu niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Udhëzimi nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Manuali i MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016, i ndryshuar; Rregullore e brendshme e Bashkisë Libohovë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 11-14, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Libohovë, me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së, të marrë masa për (i) hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të riskut ku të identifikohen, analizohen, vlerësohen risqet që mund të ndikojnë në aktivitetin dhe përbushjen e objektivave të institucionit, (ii) rishikimin periodik dy herë në vit të Regjistrisë të Riskut, (iii) të ngrihet struktura e kordinatorit dhe grupit të manexhimit të riskut, (iv) të garantohet se njoftimi/ shpallja e vendeve të lira të punës, të dërgohet zyrtarisht për tu publikuar në Portalin Kombëtar të Punësimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Njësia e Auditimit të Brendshëm në planet vjetore të auditimit nuk ka programuar auditimin e fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë duke mos dhënë mbështetjen e duhur Titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave.

- Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit;
- Nuk janë kryer auditime të teknologjisë së informacionit;
- Në disa dosje auditimi nuk dokumentohet dhe nuk administrohet shkresa përcjellëse e kthimit të Projekt Raportit nga pala e audituar. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin nr. 5 dhe nr. 6 të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, në përcaktimin e Urdhrit nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhërin nr.100, datë 25.10.2016”.
- Udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar, planifikimi i veprimtarisë audituese, plani strategjik, afati i përgatitjes dhe miratimit të planit strategjik dhe planit vjetor. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1.1, faqe 14-16, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1.Rekomandimi: Njësia e Auditit të Brendshëm Bashkia Libohovë, të marrë masa që në planet vjetore të auditimit, të programohet auditimi i fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart, si ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, lejet e ndërtimit, sistemi i pagesave, etj., në mënyrë që nëpërmjet rekomandimeve përkatëse ti jepet mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave.

Në vijimësi

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për përgatitjen e PBA 2023-2025, u konstatua se nuk:

- Janë marrë masat për të përgatitur dhe dërguar për miratim në Këshillin e Bashkisë, kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor;
- Për PBA 2023-2025 nga Kryetari i Bashkisë nuk është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik, strukturë e cila është përgjegjëse për menaxhimin, garantimin e cilësisë dhe monitorimin e zbatimit të sistemit të integruar të planifikimit brenda njësisë së vetëqeverisjes vendore.
- Nuk janë zbatuar të gjitha fazat e hartimit të PBA, nuk është i dokumentuar i plotë i gjithë procesi i hapave të punës që duhet të ndiqen nga EMP dhe GMS-ja;
- Nuk dokumentohet plotësisht, pasi në dosjen përkatëse të PBA, nuk administrohet dokumentacioni mbi kërkesat e bëra për fondet nga përgjegjësit e sektorëve të Bashkisë Libohovë, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse, (nuk është bërë analize e detajuar);
- Tavanet përgatitore të PBA-së 2023-2025, janë miratuar jashtë afateve.
- Nuk janë planifikuar fonde për investime në shtimin dhe përmirësimin e fondit pyjor. Gjithashtu konstatohet se nuk janë zbatuar detyrimet ligjore për hartimin e raporteve të monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2023, pasi nuk është hartuar raporti për 4 mujorin e parë të vitit dhe për 4 mujorin e dytë dhe 4 mujorin e tretë konstatohet se Bashkia Libohovë ka përcjellë në MF raportet e monitorimit të buxhetit jashtë afateve të përcaktuara në pikën 45 dhe pikën 270 në Udhëzimin nr. 9 datë 20.03.20218 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore”, pika 19 dhe pikat 22-23; Pikën 1 të nenit 33, pikën 1 të nenit 35, pikën 1 të nenit 37 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”, hyrë në fuqi më datë 13.06.2020; Pika 29, shkronjat “a-h” të pikës 38 në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisë të vetëqeverisjes vendore”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 16-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Libohovë dhe Sektori i Financës, të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të ngrejë grupin e menaxhimit strategjik, si dhe të dokumentohen kërkesat buxhetore nga çdo drejtues programi ekonomik i Bashkisë Libohovë.

-Dokumentimin e procesit të ndjekur për hartimin e PBA-së, nga Ekipet e Menaxhimit të Programeve dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik;

-Respektimin e afateve gjatë procesit të miratimit të Tavaneve Përgatitore të PBA-së;

-Pasqyrimin dhe trajtimin e risqeve financiare dhe fiskale të bashkisë të cilat cenojnë drejtpërdrejtë arritjen e objektivave të bashkisë;

-Planifikimin e fondeve për investime në ekonominë pyjore në pronësi të Bashkisë Libohovë.

Gjatë planifikimit të PBA buxhetit vjetor pasardhës

3.2.Rekomandimi: Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të marrin masa që gjatë vitit buxhetor të hartohen raportet 4 mujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, me të cilat të njihet këshilli bashkiak dhe njëkohësisht të dërgohen edhe në Ministrinë e Financave.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi të dhënat e buxhetit të vitit 2023, rezulton se është realizuar në masën 72%, ku nga vlera e parashikuar me gjithë shtesa prej 219,963 mijë lekë është realizuar vlera 159,161 mijë lekë. Ky mos realizim vjen për faktin se parashikimi i shpenzimeve nuk është bërë mbi bazën e të ardhurave faktike të një vitit më parë, por është planifikuar mbi planin e të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, i cili për asnjë vit nuk realizohet.

Zëri kryesorë i shpenzimeve, investimet është zëri që ka përqindje të ulët, ku nga vlera e parashikuar prej 31,718 mijë lekë është realizuar në masën 28,181 mijë lekë ose 89%, që do të thotë se nga Bashkia Libohovë në fillim të vitit buxhetor planifikohen procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk korrigohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara.

Në lidhje me faturat e palikujduara në fund të vitit 2023, konstatohet se janë janë 10 fatura të palikujuara për shpenzime për investime, shpenzime për vendime gjyqësore, shërbime dhe mirëmbajtje në vlerën për vlerën 13,755 mijë lekë.

Në raport me totalin e shpenzimeve të vitit 159,161 mijë lekë, kjo njësi vendore nuk është në vështirësi financiare, pasi zë 8.6% të totalit.

-Gjithashtu sa i përket pagesave të kryera nëpërmjet bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit 30 ditor të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacion shoqëruës në Degën e Thesarit Gjyrokastër, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për vitin 2023, ky afat nuk është respektuar në 10 raste për vlerën **13,755 mijë lekë**, nga të cilat është parashikuar të likuidohet nga të ardhurat e veta.

Likuidimi me vonesë i faturave në tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh dhe mos likuidimi i vlerës së plotë të faturës, në pjesën më të madhe të rasteve ka rezultuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh, mosrealizim të ardhurash, si dhe mosrespektim i radhës në likuidimin e detyrimeve të prapambetura. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me germën (a) të nenin 5, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe pikën 24 dhe 25 në nenin 3, nenin 47 në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, si dhe pikat 8 dhe 184 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 18-37, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Libohovë dhe Sektori i Financës të marrë masa për likuidimin në kohë të të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, si dhe të bëjë grafikun e likuidimit të detyrimeve të prapambetura, respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

4.2.Rekomandimi: Sektori i Financës në bashkëpunim me Sektorin e Tatim Taksave, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t'u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Përgjatë vitit buxhetor 2024 dhe në vijim

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i evidencave analitike të llogarive të aktiveve afatgjata, u konstatua se: Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” pasqyrohet në aktive afatgjata jomateriale në vlerën 5,645,745 lekë, e pa analizuar se çfarë përfaqëson.

-Llogaria 212 “Ndërtime konstruksione” e aktiveve afatgjata materiale, ka të pa analizuar vlerën 4,687,737 lekë dhe nuk dihet se kujt objekt i përket.

-Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” ka të pa analizuar vlerën 8,296,835 lekë, pa emërtim objekti dhe vendodhje.

Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” pasqyrohen aktive në vlerën 742,167 lekë, të pa analizuar. Për këto katër zëra sipas llogarive respektive në shumën totale 19,372,484 lekë nuk disponohet dokumentacion kontabël, mbi origjinën e tyre, duke mos evidentuar se çfarë përfaqësojnë këto vlera në kontabilitet dhe në inventarin fizik. Vlerat e mësipërme janë përfshirë në llogaritë përkatëse pa dhënë shpjegime se çfarë përfaqësojnë, si dhe nuk disponohet dokumentacion kontabël mbi origjinën e tyre. Referuar procesit të inventarizimit të kryer për vitin 2023, komisioni i verifikimit është shprehur se këto tre aktive nuk gjenden pasi nuk ka dokumentacion kontabël në pasqyrat financiare të Bashkisë Libohovë, të cilat paraqiten në shumën totale 19,372,484 lekë për të cilat mungojnë të dhënat e regjistrimit të ngjarjeve ekonomike.

Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 5. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 38-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1.Rekomandimi: Nëpunësi zbatues të marrë masa për identifikimin e vlerave të aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, në mënyrë që llogaritë përkatëse të pasqyrave financiare të jenë të mbështetura me dokumentacion të qartë vërtetues për llogaritë ekonomike si vijon:

-Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”

-Llogaria 212 “Ndërtime konstruksione”.

-Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”

-Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune”

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2024

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrve financiare viti 2023, rezulton se llogaritë 210 “Toka, troje, terrene” e cila paraqitet me vlerë zero lekë, llog. 211 “Pyje, kullota, plantacione” në vlerën zero lekë, 212 “Ndërtesa e konstruksione” në vlerën 272,570,167 lekë, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, nuk janë reflektuar të gjitha ndërhyrjet ndër vite, si: ndërtesat, trojet, terrenet, rrugë, vepra ujore etj., të kaluara pas reformës territoriale, investimeve të kryera ndërvite, dhe Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 91, datë 14.10.2016, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohen për transferim në pronësi të njësisë administrative Qendër Libohovë të Bashkisë Libohovë”, në zbatim të Ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të Ligjit nr. 8743 datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit, i ndryshuar, VKM nr. 840, datë 22.07.2009, “Për miratimin e inventarit të pronave të paluajtshme në Komunën Libohovë”, si

dhe me Udhëzimin nr. 15, datë 30.06.2003, “Për mënyrën e paraqitjes nga Njësitë e Qeverisjes Vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të pronave të paluajtshme publike”.

Për aktivet që i përkasin llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, për koston historike 935,221,653 lekë, Bashkia Libohovë posedon titull pronësie/pasuri të regjistruara në ASHK Gjirokastër sipas zonave kadastrale vetëm për tre objekte si më poshtë:

-Pasuria nr. 14/8 (Muzeu “A. R”);

-Pasuria nr. 8/185 (Ndërtesa e Bashkisë);

-Pasuria nr. 2/27 (Kopështi Fëmijëve Hoxhallarë)

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 38-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Libohovë të marrë masa për vlerësimin e trojeve nën godina, që ka në inventar, të transferuara me VKM në pronësi të Bashkisë Libohovë. Po kështu për pyjet, kullotat, rrugë, etj., në pronësi të Bashkisë Libohovë, të transferuara me VKM, të bëhen inventarët me përditësimet përkatëse, saktësimi i hartave dhe kufijve të tyre. Pas procesit të regjistrimit në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Gjirokastër të kryhen veprimet kontabël për përfshirjen e të gjitha këtyre Aktiveve Afatgjata Materiale në gjendjen e llogarive përkatëse në pasqyrat financiare.

Brenda vitit 2024

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, në gjendjen e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” për vlerën historike 15,330,645 lekë, është përfshirë vlera prej 742,167 lekë me emërtimin “Vlerë tjetër”, e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunave të Bashkisë Libohovë e paanalizuar e cila ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Po ashtu u konstatua se: Llogaria 214 paraqitet e nënvlerësuar në vlerë 14,265,168 lekë, për shkak të mos kontabilizimit të veprimeve hyrje/dalje në magazinë si më poshtë:

-Me flete hyrje nr. 15 datë 23.03.2023 janë bërë hyrje në magazinë mallra si: Tuba plastike, shtylla metalike ndricimi, krahë shtyllash, kabëll elektrik, puseta plastike dhe artikuj të ngjashëm në vlerë prej **5,358,874 lekë**, ardhur nga shoqëria “F” sh.p.k.

-Me fletë hyrje nr.27 datë 03.05.2023 janë bërë hyrje në magazinë mallrat, çimento dhe hekur betoni në vlerën **6,795,276 lekë**, ardhur nga furnitotri V shpk.

-Me fletë hyrje nr.29/1 janë bërë hyrje në magazinë mallrat, çimento në vlerën **2,111,018 lekë**, ardhur nga furnitori V shpk. Mos kontabilizimi i vlerës **14,265,168 lekë**, në Bilancin Kontabël të vitit 2023 ka sjellë një paraqitje jo të saktë për këtë llogari ekonomike dhe me deformim të informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2023 të **llogarisë 214** “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune”. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 38-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

7.1.Rekomandimi: Përgjegjësi i Sektorit të Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues, të marrë masa që me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2024 të sistemojë vlerën **14,256,168 lekë** me analizë në llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” me qëllim pasqyrimin e saktë të vlerave në kontabilitet.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2024

8.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. 425/6 prot., datë 03.10.2023, dhe protokolluar në Bashkinë Libohovë me nr. 596/14 prot., datë 05.10.2023, rezulton se:

Nga Bashkia Libohovë me shkresën nr. 596/17 prot., datë 24.10.2023 është kthyer përgjigje në respektim të afatit 20 ditorë, referuar shkronjën (j), të nenit 15, të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Në lidhje me zbatimin e afatit 6 mujor, referuar pikës 2 të nenit 30, të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, afati nuk është zbatuar nga subjekti, pasi programi i auditimit në subjekt është brenda këtij afati.

Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve, nga verifikimi rezulton se:

a- Nga **24 masa organizative** të rekomanduara, janë pranuar 100 % nga subjekti. Nga të pranuarat janë zbatuar 9 masa, 1 masë është zbatuar pjesërisht dhe **14 masa nuk janë zbatuar.**

b- Nga 2 masa shpërblim dëmi me vlerë **313 mijë lekë**, janë pranuar 100 % nga subjekti. Nga të pranuarat rezulton se **2 masa nuk janë zbatuar.**

c- Nga 2 masa për uljen e borxhit tatimor me vlerë **25,363 mijë lekë**, janë pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat rezulton se **2 masa nuk janë zbatuar.**

d- Nga 1 masë për eliminimin e efekteve negative me vlerë **5,962 mijë lekë**, janë pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat rezulton se **1 masë nuk është zbatuar.**

e- Nga 2 masa disiplinore, janë pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat rezulton se **2 masa janë zbatuar.**

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4, faqe 59-64, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju **rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përsheptimin e atyre në proces zbatimi, si më poshtë:

A.1. Masa organizative të lëna në auditimin e mëparshëm.

Rekomandimet nr. 1.1; 1.2; 4.1; 5.1.; 11.1; që i përkasin kategorisë masa organizative të cilat nuk janë zbatuar, por në thelb janë të njëjtat problematika në formë dhe në përmbajtje me rekomandimet e dhëna nga KLSH mbi auditimin e ushtruar për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023. Në kushte të tilla këto rekomandime e kanë humbur efektin e tyre dhe nuk do të rikërkohet përveç rekomandimit nr. 22.3.

6.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Libohovë dhe Sektori i Financës të marrin masa që të eliminohet fenomeni i krijimit të detyrimeve të reja të prapambetura gjatë vitit buxhetor. Për këtë të bëhet likuidimi i vlerës së kontratës të lidhur midis Bashkisë Libohovë dhe kontraktorëve, sipas afateve të përcaktuara në kontratë, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të prapambetura. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi që parashikon procedura e prokurimit do të jetë në dispozicion (në llogarinë e thesarit) të autoritetit kontraktor. Gjithashtu të marrë masa që gjatë planifikimit dhe zbatimit të buxhetit, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës.

8.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Libohovë, të vijojë punën për arritjen e një aktmarrëveshjeje me shoqërinë “U. K Libohovë” ShA, me qëllim që kjo e fundit të kryej rolin e agjentit tatimor, për taksat dhe tarifatat vendore për kategorinë e taksapaguesve familjare. Për këtë të merret miratimi i Këshillit Bashkiak.

9.1.Rekomandimi: Bashkia Libohovë të marrë masa që gjatë procesit të dhënies së ndërtesave me qira, të bëjë skualifikimin e të gjithë subjekteve konkurruese të cilët nuk vërtetojnë se plotësojnë dokumentacionin e kërkuar nga Bashkia Libohovë.

9.2.Rekomandimi: Bashkia Libohovë të marrë masa që në hartimin e kontratave për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve, të përcaktojë se detyrimet për konsumin mujor të energjisë elektrike dhe të ujit, janë të qiramarrësit. Të përcaktohet person apo strukturë për monitorimin e kontratave të dhënies me qira të ndërtesave

10.1.Rekomandimi: Nga Nëpunësi Zbatues të hartohet rregjistri kontabël i aktiveve sipas llogarive kontabël, duke evidentuar të gjithë elementët e nevojshëm si vendndodhjen e pronës, sipërfaqen e saj etj., për të gjitha pronat që administrojnë Bashkia Libohovë.

10.2.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Libohovë të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për inventarizimin në teren e të gjitha pronave që administrojnë Bashkia Libohovë, për të

përcaktuar dhe verifikuar situatën faktike, nëse ekzistojnë në teren të gjitha pronat ashtu si ato paraqiten në VKM përkatëse nëpërmjet të cilave janë transferuar në Bashkinë Libohovë. Në përfundim të procesit të inventarizimit të informohet Kryetari i Bashkisë për rezultatet e këtij procesi.

10.3.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Libohovë të marrë masa që nga strukturat përkatëse të përgatiten dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK të të gjitha pronave që administron. Sektori i Financës të përllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

18.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Libohovë të marrë të gjitha masat për ngritjen e strukturës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Teritorit Vendor, duke respektuar kriteret e arsimit, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

20.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të analizojë situatën e moszbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën Nr. 801/1 Prot., datë 19.12.2022, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave të ngarkuar për zbatimin e tyre. Të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për të përshpejtuar punën për zbatimin e rekomandimeve në proces zbatimi, si dhe për zbatimin e plotë të rekomandimeve të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si vijon:

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Libohovë të marrë masat e duhura për njohjen nga stafi të kuadrit ligjor në fuqi për MFK, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, hartimin e regjistrimit të riskut, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë efekt negativ në arritjen e objektivave të institucionit. Të hartohet gjurma e auditimit për të gjitha proceset kryesore të aktivitetit të institucionit.

6.1.Rekomandimi: Nëpunësi zbatues të marrë masa për hartimin dhe plotësimin e regjistrimit të aktiveve me të gjithë elementët e tij të domosdoshëm, me qëllim identifikimin në këtë dokument të të gjitha aktiveve të njësisë vendore, si dhe uljen e rriskut nga humbjet dhe keq menaxhimin e tyre.

8.1.Rekomandimi: Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të marrin masa për hartimin e raporteve periodike 4 muajor të monitorimit të zbatimit të buxhetit dhe këto raporte ti paraqiten për njohje këshillit bashkiak, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Menjëherë dhe vijimësi

B.2. Masa për shpërblim dëmi të lëna në auditimin e mëparshëm.

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Libohovë dhe Nëpunësi Zbatues, të ndjekin të gjitha procedurat e duhura ligjore, për arkëtimin e vlerës 76,000 lekë të përfituar padrejtësisht nga paga e grupit, përkatësisht vlerës 36,000 leke nga Z. L. B dhe vlerës 40,000 lekë nga Znj. E. L.

2.1. Rekomandimi: Bashkia Libohovë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës 237,418 lekë pa TVSH nga shoqëria "C" SHPK, për volume punimesh të likujduara, por të pakryera në fakt sipas kontratës Nr. 626 prot., datë 11.05.2020, me objekt "Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të qytetit Libohovë" Bashkia Libohovë. Vlera e mësipërme përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe njësisë vendore.

Menjëherë dhe vijimësi

C.3. Masa për uljen e borxhit tatimor, për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia.

Rekomandimet nr. 1.1, që i përkasin kategorisë masa për eliminim e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike, të lëna në auditimin e mëparshëm të cilat nuk janë zbatuar dhe nuk është marrë asnjë masë për arkëtimin e vlerës totale prej 25,044,459 lekë, por në thelb janë të njëjtat problematika në formë dhe në përmbajtje me rekomandimet e dhëna nga KLSH mbi auditimin e ushtruar për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, që i përkasin situatës së borxhit tatimorë. Në kushte të tilla këto rekomandime e kanë humbur efektin e tyre dhe nuk do të rikërkohej.

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkia Libohovë, të ndjek të gjitha procedurat e duhura

ligjore, për arkëtimin e vlerës 319,330 lekë, të cilat janë detyrime kontraktuale të pa paguara nga 5 qiramarrësit e tokës bujqësore, si vijon:

- 1.K. K për vlerën 26,62 lekë;
- 2.A. K për vlerën 127,995 lekë;
- 3.A. K për vlerën 7,095 lekë;
- 4.S. P për vlerën 55,440 lekë;
- 5.V. V, për vlerën 13,019 lekë.

Menjëherë dhe vijimësi

D. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet të tyre.

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Libohovë të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e dëmshpërblimit, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Menjëherë dhe vijimësi

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se për zbatimin e vendimeve gjyqësore për periudhën janar-dhjetor 2023 nga Bashkia Libohovë është shpenzuar vlera **10,261 mijë lekë, e cila konsiderohet efekt negativ financiar në buxhet.** Kjo vlerë i përket likuidimit të tre vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblime për dëmtim prone apo humbje jete. Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, ndikon pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore, praktika të cilat kanë sjellë humbjen e proceseve gjyqësore, bënë evidentimin e procedurave të bëra gabim, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Mos kryerja e kësaj analize nga Titullari është në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. (Trajtuar më hollësisht në pikën III.2.2, faqe 16-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Libohovë të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjeve gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e dëmshpërblimit dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se vlera progresive e debitorëve për taksat dhe tarifat vendore në datën 31.12.2023 është në vlerën **5,693,659 lekë** për **55** subjekte, që përfshin debitorët e viteve të mëparshme, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Libohovë. Përgjatë vitit 2023 nuk janë krijuar debitor të rinj. Për debitorët e mësipërm (theksojmë vetëm për kategorinë biznes) nga Sektori i Tatim Taksave Bashkia Libohovë, sipas dokumentacionit të administruar dhe vendosur në dispozicion, nuk janë bërë përpjekje duke mos aplikuar masa shtrënguese (vendosjen e barrës siguroese për pasuritë e luajtshme, si mjete transporti), nuk është vazhduar me masa të tjera shtrënguese në mënyrë shteruese, si bllokimi i aktivitetit të biznesit, bllokimi i shitjes së aktiveve në QKB, konfiskimi

i jo më pak se 50% të qarkullimit deri në kallëzim penal. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2 në nenin 89 në Kreu XI të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar; Pikat 1 dhe 2 në nenin 4 dhe neni 22/5 në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar; Kreu III në Udhëzimin nr.17, datë 20.06.2022 “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 16-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1.Rekomandimi: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Libohovë, të marrë masa për identifikimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin administrativ të bashkisë, me qëllim përditësimin e regjistrit të taksave dhe tarifave për bizneset, si dhe në vijim nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët.

-Sektori i Tatim Taksave Bashkia Libohovë të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët e mundshme ligjore për arkëtimin e debitorëve në vlerën **5,693,659 lekë**.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2024

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi i objekteve informale, u konstatua se vlera debitore për këtë taksë në mënyrë progresive në fund të vitit 2023 është **138,887 lekë** për 5 subjekte, nga të cilat 2 subjekte për vlerën 39,463 lekë janë krijuar në vitin 2023. Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Sektori i Shërbimit Urban Bashkia Libohovë, nuk janë marrë masa për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Gjithashtu ka munguar bashkëpunimi ndërmjet Sektori i Shërbimit Urban dhe Sektorit të Tatim Taksave Bashkia Libohovë, me qëllim që subjektet të cilët rezultojnë debitorë si rrjedhojë e mospagesës së TNI, t’i përcillen sektorit të Tatim Taksave, për të ndjekur procedurat ligjore (njoftim, bllokim të llogarive bankare, etj) për arkëtimin e TNI nga legalizimi i objekteve informale. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 4 të Paketës Fiskale për vitin 2023. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 16-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1.Rekomandimi: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Libohovë të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej **138,887 lekë**, me qëllim eliminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2024

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për kontratat e qiradhënies së aseteve, lidhur ndërmjet Bashkisë Libohovë me palë të treta konstatohet që:

Bashkia Libohovë në procesin e ligjshëm të administrimit të aseteve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre, për vitin 2023 ka gjithësej 39 kontrata qiraje aktive, nga të cilat: 3 kontrata janë lidhur me operatorët e telefonive celulare, 23 kontrata për dhënie me qira të pyjeve dhe kullotave dhe 13 kontrata për dhënie me qira të tokave bujqësore.

Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion të kontratave për dhënie me qira të tokës bujqësore, konstatohet se deri më datë 31.12.2023, për 7 kontrata nuk janë shlyer detyrimet në vlerën 285,586 lekë si dhe për 4 kontrata qiraje të pyjeve dhe kullotave nuk janë shlyer detyrimet në vlerën 88,417 lekë. Në fund të vitit 2023 vlera debitore nga kontratat e qirave është **374,003 lekë**, të cilat janë detyrime të njohura por të paarkëtuara nga Bashkia Libohovë. Ndaj këtyre subjekteve nuk janë marrë masa për arkëtimin e detyrimit të krijuar si dhe zgjidhjen e kontratës. Referuar kushteve të kontratës nenit 4, pika 4.2, pagesa e qirasë do të jetë vjetore dhe do të bëhet brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i kontratës për llogari të institucionit.

Gjithashtu, nëse nga subjektet refuzohet pagesa, po në zbatim të nenit 10, nga Bashkia zgjidhet kontrata për mos përmbushje të kushteve të saj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 16-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1.Rekomandimi: Sektori i Tatim Taksave në bashkëpunim me sektorin e Bujqësisë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitorë **374,003 lekë**, të cilat janë detyrime kontraktuale të papaguara nga 11 qiramarrësit e tokës bujqësore, si vijon:

- 1.M. N për vlerën 53,050 lekë.
- 2.S. B për vlerën 25,967 lekë;
- 3.E. N për vlerën 4,000 lekë;
- 4.A. T për vlerën 5,400 lekë;
- 5.K. K për vlerën 31,406 lekë;
- 6.A. K për vlerën 22,995 lekë;
- 7.A. K për vlerën 14,190 lekë;
- 8.S. P për vlerën 156,360 lekë;
- 9.V. V për vlerën 2,339 lekë;
- 10.S. N për vlerën 44,970 lekë;
- 11.D. R për vlerën 13,326 lekë.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2024

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë në Sektorin e Tatim Taksave për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar” rezultoi se në Bashkinë Libohovë dhe NJA për vitin 2023 janë taksuar 797 familje. Me qëllim vlerësimin nëse është bërë planifikimi saktë i taksave dhe tarifave për kategorinë “familjar”, u kryqëzua informacioni i administruar nga struktura e mësipërme me informacionin e gjendjes civile.

-Sipas gjendjes civile në Bashkinë Libohovë dhe NJA janë 2.349 familje.

-Kjo situatë ndikon negativisht në të ardhurat që mund të arkëtojnë Bashkia Libohovë nga kategoria “Familjar”. Konkretisht, nëse do të bënim përllogaritjet vetëm për tarifën e pastrimit dhe ndriçimit sipas paketës fiskale, për numrin e familjeve të pataksuara, do të kishim 1,440 lekë * 1552 familje sipas njësive dhe kategorive përkatëse, mesatarisht taksuar më pak = **1,769,280 lekë planifikuar më pak**.

-Gjithashtu situata e mësipërme tregon se Sektori i Tatim taksave Bashkia Libohovë nuk ka një regjistër të përditësuar të kategorisë “Familjar”, duke patur në konsideratë edhe gjeneralitetet (Adresën, sipërfaqen, qëllimin e përdorimit, të dhënat për taksapaguesin) që përcaktohen në VKM Nr. 132, datë 07.03.2018⁶, e ndryshuar, detyrim për t’u pasqyruar në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar”. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 7 në nenin 4, nenin 20, nenin 20-24 në Kreun IV të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar; Pikën 1 të nenit 12 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Pika 9 dhe 12 në Paketën Fiskale të Bashkisë Libohovë për vitin 2023. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 16-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1.Rekomandimi: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Libohovë në bashkëpunim me Administratorët e Njësive Administrative, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve të pataksuara me taksa/tarifa vendore, përditësimin e regjistrit të familjeve, me qëllim reduktimin e të ardhurave të munguara, si rrjedhojë e mostaksimit të plotë të kategorisë “Familje”, ku vetëm në përllogaritjen e tarifës së pastrimit dhe shërbimit për vitin 2023, rezultojnë **1,769,280 lekë** të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Libohovë.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave të realizuara nga taksat dhe tarifave vendore për vitin 2023, u konstatua se në fund të vitit 2023 në mënyrë progresive janë 840 familje debitorë për vlerën **11,524,426 lekë**, nga të cilat, në vitin 2023 janë krijuar 1,141,061 lekë. Pra në krahasim me vitin 2022, në fund të vitit 2023 kemi rritje të vlerës debitorë për taksat dhe

⁶ Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës.

tarifat për kategorinë “familje”, çka tregon për punë të pamjaftueshme të Bashkisë Libohovë në arkëtimin e taksave dhe tarifave të mësipërme.

Sa i përket familjeve debitore, rezulton se nga zyrat e taksave në NJA janë përcjellë debitorët në sektorin e tatim taksave pranë Bashkisë Libohovë, por konstatohet se nga Sektori i Tatim Taksave nuk është marrë asnjë masë ligjore (njoftimin e vlerësimit të detyrimit tatimor, bllokimin e llogarive bankare, etj) për arkëtimin e vlerës debitorë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3 në nenin 3, pikat 1 dhe 2 në nenin 4 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar; Pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Pikën 3 në nenin 6, nenin 76, pikën 2 në nenin 89, neni 117 në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Paketa Fiskale e Bashkisë Libohovë për vitin 2023. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 16-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Libohovë dhe Sektori i Tatim Taksave, të marrë masat e nevojshme, për të analizuar situatën e krijuar me efekt mosarkëtimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore nga abonentët familjarë, si dhe vlerësimin e mundësisë për lidhjen e marrëveshjes me agjentin tatimor UK Sh.A Libohovë me qëllim që taksat dhe tarifat vendore për kategorinë “Familjar” të mblidhen nëpërmjet faturës së ujit të pijshëm.

5.2.Rekomandimi: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Libohovë të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej **11,524,426 lekë**, me qëllim eliminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Sektorit të Tatim Taksave Bashkia Libohovë për arkëtimin e taksës së tokës bujqësore, u konstatua se vlera debitore në fund të vitit 2023 për taksën e tokës bujqësore është në vlerën **8,820,702 lekë**, e cila në krahasim me fillimin e vitit 2023 është rritur me 202,073 lekë. Sektori i Tatim Taksave Bashkia Libohovë arkëtimin e kësaj takse e mundëson vetëm kur familjari/personi që ka në përdorim/pronësi tokë bujqësore, aplikon pranë Bashkisë Libohovë për të marrë një vërtetim/shërbim të caktuar. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3 në nenin 3, pikat 1 dhe 2 në nenin 4 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar. Pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Pika 2 në nenin 89 në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Pika I.1.a në Paketën Fiskale të Bashkisë Libohovë për vitin 2023. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 16-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1.Rekomandimi: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Libohovë në bashkëpunim me Sektorin e Shërbimit Urban, të ngrejë një grup punë me specialistë të fushës, për hartimin e regjistrit të familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse dhe verifikimit në terren.

6.2.Rekomandimi: Sektori i tatim Taksave Bashkia Libohovë të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej **8,820,702 lekë**, me qëllim eliminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Sektorit të Tatim Taksave Bashkia Libohovë për arkëtimin e taksës së vaditjes, u konstatua se vlera debitore në fund të vitit 2023 për taksën e vaditjes është në vlerën **1,431,000 lekë**, e cila në krahasim me fillimin e vitit 2023 është rritur me 205,800 lekë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3 në nenin 3, pikat 1 dhe 2 në nenin 4 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar. Pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Pika 2 në nenin 89 në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Pika I.1.a në

Paketën Fiskale të Bashkisë Libohovë për vitin 2023. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 16-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1.Rekomandimi: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Libohovë të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej **1,431,000 lekë**, me qëllim eliminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Libohovë.

Menjëherë dhe në vijimësi

E. MASA DISIPLINORE.

E.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil: Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në V.K.M-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Libohovë**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

a. “Vërejtje” në zbatim të pikës “a” të nenit 58, për 2 punonjës;

1. Z. Xh. S, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, për mos marrjen e masave të plota për arkëtimin e debitorëve, në kundërshtim me nenin 93, 94, 95, 131 të parashikuara në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (Trajtuar më hollësisht në pikën III.2.2.5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2. Znj. F. B, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës, për anomalitë e konstatuara në hartimin e pasqyrave financiare dhe zbatimin e buxhetit, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Udhëzimi nr. 22, datë 30.07.2018 “ Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore”, pika 19 dhe pikat 22-23, etj. (Trajtuar më hollësisht në pikën III.2.2 dhe pikën III.2.3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

E.2. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.

Për **1- ish punonjësin** e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personi nuk është në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte “Vërejtje” për:

1. Znj. E. P me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës, për anomalitë e konstatuara në hartimin e pasqyrave financiare dhe zbatimin e buxhetit, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Udhëzimi nr. 22, datë 30.07.2018 “ Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore”, pika 19 dhe pikat 22-23, etj. (Trajtuar më hollësisht në pikën III.2 dhe pikën III.2.3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

V.ANEKSE

Aneksi nr.1 – Mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit trajtuar nga faqja nr.17 deri në faqen nr.37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Tabela nr.33, Faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2023 për investimet (Nga të ardhurat e veta + transfertën e pakushtëzuar)

Nr.	Emërtimi i i Objektivit	Emërtimi i i Subjektit	Data e lidhjes së kontratës	Nr. i faturës	Data e Fatutës	Vlera e detyrimit ne 31.12.2022	Shtesat gjate vitit 2023	Shlyerjet gjatë vitit 2023	Gjendja 31.12.2023
1	Rikonstruksion I rrugëve te brendshme te fshatit Suhe	B			04.12.2017	138,000			138,000
2	Rikonstruksion I ujesjellesave Zagorie	B			13.11.2017	74,400			74,400
3	Rikonstruksion Banese	V			28.12.2021	166,200	0	166,200	0
Totali i detyrimit						378,600		166,200	212,400

Burimi: Bashkia Libohovë

Tabela nr.12, Faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2023 për investimet (Nga transfertat të kushtëzuara, si investime nga Ministri të linjës, FSHZH)

Nr.	Emërtimi i i Objektivit	Emërtimi i Subjektit	Data e lidhjes së kontratës	Nri. i faturës	Data e Fatutës	Vlera e detyrimit ne 31.12.2022	Shtesat gjate vitit 2023	Shlyerjet gjatë vitit 2023	Gjendja 31.12.2023
1	Rikonstruksion dhe ndertim palestere ne shkollen 9-vjecare Avni Rustemi, Libohove	BOE E&R			07.12.2018	2,227,042	0	2,227,042	0
2	Rikonstruksion I murit mbajtes te shkolles 9-vjecare Labove e Poshtme	C sh.pk.			21.12.2020	48,000			48,000
Totali i detyrimit						2,275,042			48,000

Burimi: Bashkia Libohovë

Tabela nr.34, Faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2023 për mallrat dhe shërbimet (Nga të ardhurat e veta + transfertën e pakushtëzuar)

Nr.	Emërtimi i i Objektivit	Emërtimi i Subjektit	Data e lidhjes së kontratës	Nr. i faturës	Data e Fatutës	Vlera e detyrimit ne 31.12.2022	Shtesat gjate vitit 2023	Shlyerjet gjatë vitit 2023	Gjendja 31.12.2023
1	Mbikeqyrje punimesh per objektin "Mirembajtje kanale kulluese"	R-G			22.12.2020	38,128			38,128
2	Mbikeqyrje punimesh per objektin "Rikonstruksion I murit mbajtes te shkolles 9-vjecare Labove e Poshtme"	R-G			22.12.2020	16,787			16,787
3	Mbikeqyrje punimesh per objektin "Rikonstruksion I murit te varrezave Libohove"	R-G			22.12.2020	22,166			22,166
4	Mirembajtje ura e Bulos	T-D			08.07.2020	276,000			276,000
5	Mirembajtje e kanaleve kulluese	T-D			21.12.2020	1,906,399			75,600
6	Energji elektrike	FSHU			08.09.2022	10,841,536		2,100,000	8,741,536
7	Karburant	K			25.11.2022	384,220	910,525	1,294,745	0
Totali i detyrimit									9,170,217

Burimi: Bashkia Libohovë

Tabela 35, Lista e vendimeve gjyqësore të ardhura në financë dhe likuidimet e kryera prej saj për mbi pagesat e vendimet gjyqësore për çështje të tjera të ndryshme

Emri i kreditorit	Vendim Gjykate nr./dt	Objekti i Vendimit	Vlera e detyrimit sipas te Vendimit Gjykatës	Gjendja e palikujduara	Vendime të ardhura gjatë vitit 2023		Likujduar gjatë vitit 2023	Mbetja e date 31.12.2023
				31/12/2022	Nr dhe dt. vendimit	Vlera e vendimit		
1	2	3	4	5	6	7	8	9=5+7-8
F. R		Demshperblim per demin e shkaktuar ne kullote		7,940,037			3,615,743	4,324,294.00
A. D, D. D, K. D		Demshperblim si pasoje aksident ne pune me pasoje vdekje		5,437,212			5,437,212	
A.				1,208,727			1,208,727	

Total			14,585,976		10,261,682	4,324,294
-------	--	--	------------	--	------------	-----------

Burimi: Bashkia Libohovë

Aneksi nr.2 – Mbi hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare trajtuar nga faqja nr.38 deri në faqen nr.58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Rubrika: Anekse e Pasqyrave Financiare Bashkia Libohovë viti 2023

Aneks 3.1 Pasqyra F1. Pozicioni Financiar

Nr.	Referenca e	EMERTIMI	Ushtrimi I	Ushtrimi Paraardhes
Reshti	Logarive		Mbyllur	
1	A	A K T I V E T	1,352,708,419	1,348,550,178
2		I.Aktivët Afat shkurtër	161,299,118	181,493,057
3		1.Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre	78,079,062	67,060,331
4	531	Mjete monetare në Arke		
5	512,56	Mjete monetare në Banke		
6	520	Disponibilitete në Thesar	78,079,062	67,060,331
7	50	Letra me vlerë		
8	532	Vlera të tjera		
9	54	Akreditiva dhe paradhenie		
10	59	Provizione zhvlersimi letra me vlerë (-)		
11		2.Gjendje Inventari qarkullues	13,037,740	13,758,041
12	31	Materiale	3597872	95,720
13	32	Inventar I imet	9439868	13,662,321
14	33	Prodhim nre proces		
15	34	Produkte		
16	35	Mallra		
17	36	Kafshe në rritje e majmeri		
18	37	Gjendje të pa mbritura, ose prane të tretteve		
19	38	Diferenca nga cmimet e magazinimit		
20	39	Provizione përzhvlersimin e inventarit (-)		
21		3.Llogari të Arketushme	56,427,404	71,780,630
22	411	Kliente e llogari të ngjashme		
23	423,429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba		
24	431	Tatim e Taksa		
25	432	Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal		
26	433	Fatkeqsi natyrore që mbulohen nga shteti		
27	435	Sigurime Shoqerore		
28	436	Sigurime Shendetore		
29	437,438	Organizma të tjere shtetore		
30	44	Institucione të tjera publike		
31	465	Efekte për tu arketuar nga shitja e letrave me vlerë		
32	468	Debitorë të ndryshëm	37709035	36,929,950
33	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	18,718,369	34,850,680
34	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
35	49	Shuma të parashikuara për zhvleresim(-)		
36		4.Te tjera aktive afatshkurtra	13,754,912	28,894,056
37	409	Parapagime		
38	473	Llogari e pritjes të mardhenieve me thesarin		
39	477	Diferenca konvertimi aktive		
40	481	Shpenzime për t'u shperndare në disa ushtrime		
41	486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	13,754,912	28,894,056
42		II.Aktivët Afat gjatë	1,191,409,301	1,167,057,121
43	20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	7,017,614	7,017,614
44	201	Prime të emisionit dhe Rimbursimit të huave		
45	202	Studime dhe kerkime	7017614	7,017,614
46	203	Koncesione, Patenta, Licenca e të ngjashme		
47	21	2.Aktive Afatgjata materiale	790,757,854	791,460,776
48	210	Toka, T,roje, Terene		
49	211	Pyje, Plantacione		
50	212	Ndertesë e Konstruksione	272,570,167	270,454,477
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	482,824,048	482,824,048
52	214	Instalime teknike, makineri e paisje	11,202,532	8,954,273
53	215	Mjete Transporti	13,827,533	13,827,533
54	216	Rezerva Shtetore		
55	217	Kafshe pune e prodhimi		
56	218	Inventar ekonomik	10,333,575	15,400,445
57	24	Aktive afatgjata të demtuara		
58	28	Caktime të Aktiveve Afatgjata		
59	25-26	3.Aktive Afatgjata Financiare	76,399,726	76,399,726

60	25	Huadhenie e Nenhuadhenie		
61	26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet	76,399,726	76,399,726
62		4.Investime	317,234,107	292,179,005
63	230	Per Aktive Afatgjata jo materiale		
64	231	Per Aktive Afatgjata materiale	317234107	292,179,005
65	B	PASIVET(DETYRIMET)	80,352,906	94,528,005
66		I.Pasivet Afat shkurtra	80,352,906	94,528,005
67		1. Llogari te Pagushme	80,352,906	94,528,005
68	401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to		
69	42	Detyrime ndaj personelit	3,426,735	4,240,112
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
71	460	Huadhenes		
72	431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	163,086	165,775
73	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqerore	1,211,750	1,106,106
76	436	Sigurime Shendetsore	161,886	147,631
77	437,438,	Organizma te tjere shtetore		
78	44	Institucione te tjera publike		
79	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
80	464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere		
81	466	Kreditore per mjete ne ruajtje	23,925,502	22,747,375
82	467	Kreditore te ndryshem	13,754,912	29,191,056
83	4341	Operacione me shtetin(detyrime	37,709,035	36,929,950
84	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
85		2.Te tjera pasive afatshkurtra	0	0
86	419	Kreditore, Parapagime		
87	475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese		
88	478	Diferenca konvertimi pasive		
89	480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		
90	487	Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se titullit		
91		II.Pasivet Afat Gjata	0	0
92	Klase 4	Llogari te pagushme		
93	16.17,18	Huate Afat gjata		
94		Provizionet afatgjata		
95	Klasa 4	Te tjera		
96	C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	1,272,355,513	1,254,022,174
97	D	FONDI I KONSOLIDUAR :	1,272,355,513	1,254,022,174
98	101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	1,173,888,997	1,169,897,287
99	12	Rezultatet e mbartura	44,312,956	39,811,931
100	85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	54,153,560	44,312,956
101	111	Rezerva		
102	115	Nga Fondet e veta te investimeve		
	15	Shuma te parashikuara per rreziqe e Zhvleresime		
103	105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshme		
104	106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja		
105	107	Vlera e mjeëteve te caktuara ne perdorim	0	0
106	109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata	0	0
107		Te Tjera	0	0
108	E	TOTALI I PASIVEVE(B+C)	1,352,708,419	1,348,550,178

Aneks 3.2 PF.2 Pasqyra e Performancës Financiare.

Nr. Rreshti a	Nr. Llogarie b	P E R S H K R I M I I O P E R A C I O N E V E c	VITI 2023 1	VITI 2022 2
1	A	TE ARDHURAT	214,035,139	182,070,976
2	70	<i>I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET</i>	4,871,972	5,444,928
3	700	1.Tatimi mbi te Ardhurat	54,829	194,205
4	7000	Tatim mbi te ardhurat personale		
5	7001	Tatim mbi Fitimin	10,000	
6	7002	Tatim mbi Biznesin e vogel	44,829	194,205
7	7009	<i>Te tjera Tatime mbi te ardhurat</i>		
8	702	2.Tatimi mbi Pasurine	3,389,369	3,346,249
9	7020	Tatim mbi Pasurine e palujtshme	3,389,369	3,346,249
10	7021	Tatim mbi shitjen e pasurise se palujtshme		
11	7029	Te tjera tatime mbi Pasurine		
12	703	3.Tatime mbi mallrat e sherbimet brenda vendit	1,427,774	1,904,474
13	7030	Tatim mbi vleren e shtuar(TVSH)		
14	7031	Akciza		
15	7032	Takse mbi sherbimet specifike		
16	7033	Takse mbi perdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie	702	959
17	7035	Taksa vendore mbi perdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	1,427,072	1,903,515
18	704	4.Takse mbi tregtine dhe transakcionet nderkombtare	0	0

19	7040	Takse doganore per mallrat e importit		
20	7041	Takse doganore per mallrat e eksportit		
21	7042	Tarife sherbimi doganor e kaliposte		
22	7049	Te tjera taksa mbi tregtine e transaksionet nderkombtare		
23	705	5.Takse e rruges		
24	708	6.Te tjera Tatime e Taksa kombtare		
25	709	7.Gjoha e Kamat vonesa		
26	75	<i>II.KONTRIBUTE SIGURIME SHOQERORE E SHENDETESORE</i>	0	0
27	750	NGA TE PUNESUARIT		
28	751	NGA PUNEDHENESI		
29	752	NGA TE VETPUNESUARIT		
30	753	NGA FERMERET		
31	754	NGA SIGURIMET VULLNETARE		
32	755	KONTRIBUTE NGA BUXHETI PER SIGURIME SHOQERORE		
33	756	KONTRIBUTE NGA BUXHETI PER SIGURIME SHENDETESORE		
34	71	<i>III.TE ARDHURA JO TATIMORE</i>	2,688,526	2,911,294
35	710	1.Nga ndermarrjet dhe pronesia	884,700	801,773
36	7100	Nga Ndermarrjet publike jo financiare		
37	7101	Nga Ndermarrjet publike financiare		
38	7109	Te tjera nga ndermarrjet dhe pronesia	884,700	801,773
39	711	2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare	1,781,426	1,989,931
40	7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	1,302,350	1,289,370
41	7111	Te ardhura sekondare e pagesa sherbimesh		
42	7112	Takse per veprime gjyqsore e noteriale		
43	7113	Te ardhura nga shitja e mallrave e sherbimeve	456,700	685,800
44	7114	Te ardhura nga biletat		
45	7115	Gjoha, kamatvonesa, sekuestrime e zhdemtime	22,376	14,761
46	7116	Te ardhura nga transferimi prones,Legalizimi i ndertimeve pa leje		
47	719	3.Te tjera te ardhura jo tatimore	22,400	119,590
48	76	<i>IV.TE ARDHURA FINANCIARE</i>	0	0
49	760	Nga interesat e huadhenies se brendshme		
50	761	Nga interesat e huadhenies se Huaj		
51	765	Nga interesat e depozitave		
52	766	Nga kembimet valutore		
53	72	<i>V.GRANTE KORENTE</i>	205,754,339	173,714,754
54	720	1.Grant korent I Brendshem	205,754,339	163,970,274
55	7200	Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)	100,179,203	80,422,929
56	7201	Nga Buxheti per NJQP(Vendore)	27,400,594	
57	7202	Nga Buxheti per pagesa te posacme te ISSH	29,219,941	39,884,000
58	7203	Nga Buxheti per mbulim deficitit(ISSH E ISKSH)		
59	7204	Pjesmarrje e institucioneve ne tatime nacionale	4,221,645	3,641,355
60	7205	Financim shtese per te ardhurat e krijuara brenda sistemit		
61	7206	Financim I pritshe nga buxheti		
62	7207	Sponsorizime te brendshme(nga te trete)		210,060
63	7209	Te tjera grante korente te brendshme	44,732,956	39,811,931
64	721	2.Grant korent I Huaj	0	9,744,480
65		Nga Qeveri te Huaja		9,744,480
66		Nga Organizata Nderkombetare		
67		<i>VI.TE ARDHURA TE TJERA</i>	0	0
68	781	Te ardhura nga investimet ne ekonomi		
69	782	Rimarrje Shumash te parashikuara per aktive afatshkurtra		
70	783	Rimarrje Shumash te parashikuara per aktive afatgjata		
71	784	Rimarrje Shumash per shpenzime te viteve ardhshme		
72	787	Terheqje nga seksioni I investimeve		
73	73	<i>VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE</i>	720,302	
74	B	SHPENZIMET	159,881,579	137,758,020
75	600	I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE	58,669,817	51,612,376
76	6001	Paga, personel I perhershem	58,669,817	51,612,376
77	6002	Paga personel I Perkohshem		
78	6003	Shperblime		
79	6009	Shpenzime te tjera per personelin		
80	601	<i>II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE</i>	9,528,291	8,610,893
81	6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqerore	8,557,662	7,732,705
82	6011	Kontributi I Sigurimeve Shendetesore	970,629	878,188
83	602	<i>III.BLERJE MALLRA E SHERBIME</i>	32,512,017	21,493,916
84	602	Mallra dhe sherbime te tjera		
85	6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	800,520	816,924
86	6021	Materiale dhe sherbime speciale	2,459,351	1,471,220
87	6022	Sherbime nga te trete	6,956,429	4,277,582
88	6023	Shpenzime transporti	8,452,129	6,002,254
89	6024	Shpenzime udhetimi	63,260	103,020
90	6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	0	0
91	6026	Shpenzime per qeramarrje	0	0
92	6027	Shpenzime per detyrime per kompesime legale	10,515,347	6,046,400
93	6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua	56,000	0
94	6029	Shpenzime te tjera operative	3,208,981	2,776,516

95	603	IV.SUBVECIONE	0	0
96	6030	Subvecione per diference cmimi		
97	6031	Subvecione per te nxitur punesimin		
98	6032	Subvecione per te mbuluar humbjtet		
99	6033	Subvecione per sipermarrjet individuale		
100	6039	Subvecione te tjera		
101		V.TRANSFERIME KORENTE	30,270,021	41,931,825
102	604	1.Transferime korente te brendshme	296,580	201,475
103	6040	Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise	196,480	201,475
104	6041	Transferime korente tek institucione qeveritare te ndryshme	100,100	
105	6042	Transferime korente tek Sigurimet Shoqerore e Shendetsore		
106	6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurse		
107	605	2.Transferime korente me jashte	0	0
108	6051	Transferime Per Organizatat Nderkombetare		
109	6052	Transferime Per Qeverite e Huaja		
110	6053	Transferime Per institucionet jo fitimprurse te huaja		
111	6059	Transferime Te tjera korrente me jashte shtetit		
112	606	3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe	29,973,441	41,730,350
113	6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH		
114	6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	29,973,441	41,730,350
115		VI.SHPENZIME FINANCIARE	0	0
116	65	1.Shpenzime Financiare te brendshme	0	0
117	650	Interesa per bono thesarit dhe kredi direkte		
118	651	Interesa per huamarrje te tj. Brendshme		
119	652	Interesa Letra tjera vlere Qeverise		
120	656	Shpenz.nga kembimet valutore		0
121	66	2.Shpenzime Financiare te jashtme	0	0
122	660	Interesa per huamarrje nga Qeveri.te Huaja		
123	661	Interesa per financime nga Institucionet.nderkomb		
124	662	Interesa per huamarrje te tjera jashtme		
125		VII.KUOTA AMORTIZIMI DHE SHUMA TE PARASHIKUARA	0	0
126	681	Kuotat e amortizimit te AAGJ, te shfrytezimit		
127	682	Vlera e mbetur e AAGJ, te nxjerra jashte perdorimit e te shitura		
128	683	Shuma te parashikuara te shfrytezimit		
129	686	Shuma te parashikuara per aktivet financiare		
130	63	VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT	720,301	-126,760
131		IX.SHPENZIME TE TJERA	28,181,132	14,235,770
132	85	TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDDHES (Rezultati I Veprimtarise se vitit Ushtrimor)	54,153,560	44,312,956

Aneks 3.3 Formati nr.3 Pasqyra e flukseve monetare.

Nr. Reshti	Nr Rubrike	PERMBAJTJA	Periudha Raportuse	Periudha Paraardhese
(a)	(b)	(c)	(1)	(2)
1	I	VEPRIMTARITE E SHFRYTEZIMIT	10,039,796	11,346,399
2	1	Akordim Fonde Buxhetore per shpenzime korente (+)	99,258,003	69,772,727
3	2	Arketime e te hyra (Cash), gjate vitit ushtrimor		
4		Te hyra nga Tatimet e Doganat tatimore e Doganore(+)	4,871,972	5,444,928
5		Te hyra nga Kontributet e Sig. shoq. e shendets(+)	0	0
6		Te hyra nga ardhurat jotatimore (+)	2,688,526	2,911,294
7		Te hyra, Sponsorizime nga te trete,(+)	30,550,249	3,851,415
8		Te hyra, nga kredi e huamarrje afatshkurter(+)	.	
9		Te hyra nga Mjetet ne ruajtje(+)	1,267,127	4,156,231
10		Te tjera, arketuar(+)	31,604,000	42,929,000
11	3	Pagesa per Detyrime e Shpenzime korente		
12		Per detyrime e Shpenzime nga vitet e kaluara(-)		
13		Per detyrime e Shpenzime te viti ushtrimor(-)	-130,226,640	-81,918,660
14		Pagesat per mjetet ne ruajtje(-)		-152,838
15		Interesi I paguar(-)		
16		Tatime te paguara(-)		
17		Te tjera te paguara (-)	-29,973,441	-41,730,350
18	II	VEPRIMTARITE E INVESTIMEVE	3,287,670	2,193,818
19		Akordim Fonde Buxhetore per shpenzime Kapitale (+)	31,468,810	97,329,540
20		Te hyra nga Kredi dhe e huamarrje afatgjata(+)		
21		Te hyra nga shitja e Aktiveve Afatgjata (+)		
22		Te hyra nga interesat e huadhenies dhe nenhuadhenies(+)		
23		Pagesa per detyrime e Investime nga vitet e kaluara(-)		
24		Per detyrime e Investime te viti ushtrimor(-)	-28,181,140	-95,135,722
25		Huadhenie e Nenhuadhenie(-)		
26		Pjesmarrje ne kapitalin e vet(-)		
27		Dividente te paguar(-)		
28	III	TRANSFERTA E TE TJERA	-2,308,735	-111,633
29		Derdhje e Transferime te te Ardhrave ne Buxhet(-)		

30		Transferime ne buxhet te Fondeve te perdorura(-)	-2,308,735	-111,633
31		Levizje e brendshme e transfertat te tjera(+)		
32	IV	Rritja /Renia neto e Mjeteve monetare	11,018,731	8,504,418
33	V	Teprica ne fillim te vitit ushtrimor	67,060,331	58,555,913
34	VI	Teprica e Likujditeve ne fund te vitit ushtrimor	78,079,062	67,060,331

Aneksi 3.4 Llogaria 212 “Ndërtime konstruksione”

000/Lekë

Ndërtesa konstruksione (kosto historike) sipas inventarit fizik	Gjendja 01.01.2023	Shtesa (D)	Pakësi me (K)	Gjendja 31.12.2023
Godina e shkollës mesme	23,785,562			23,785,562
Godina e shkollës	21,220,827			21,220,827
Godina e kopshtit	2,500,000			2,500,000
Godina Shtëpia e Kulturës	5,356,602			5,356,602
Godina e bashkisë	10,057,250			10,057,250
Thertore	1,308,201			1,308,201
Varrezat publike	197,485			197,485
Muri Marinë	1,160,665			1,160,665
Këndi Sportiv (Avni Rustemi)	155,752			155,752
Rikualifikimi Urban i Qendrës së Qytetit Libohovë	136,496,966			136,496,966
Rikonstruksion dhe ndërtim palestere i shkollës 9-vjeçare “Avni Rustemi”	70,508,442	2.227.0		72,735,484
Vlerë tjetër	4,687,737			4,687,737
Tualetet Labovë e Sipërme	128,144			128,144
Shkolla Labovë e Sipërme	186,650			186,650
Dyqan Labovë e Poshtme	284,642			284,642
Shkolla Labovë e Poshtme	689,774			689,774
Shkolla Nepravisht e Poshtme	10,647,853			10,647,853
Shkolla Suhe	1,400,000			1,400,000
Shkolla Drino	1,500,000			1,500,000
Shkolla Bulo	1,050,928			1,050,928
Kryesia Bulo	11,356			11,356
Kopësht Çerdhe	129,684			129,684
Godina e shkollës 8 vjeçare Zhej	832,668			832,668
Godina e shkollës 8 vjeçare Hoshteve	500,000			500,000
Godina e shkollës 8 vjeçare Nderan	420,000			420,000
Godina e shkollës 8 vjeçare Sheper	763,897			763,897
Shtëpi Kulture Sheper	3,200,000			3,200,000
Godina e Shkollës	120,000			120,000
Godina e Shkollës	60,000			60,000
Godina e Shkollës	201,161			201,161
Restaurim i ambjenteve të brendshme të godinës së Bashkisë	775,340			775,340
Restaurim i murit mbajtës të varrezave	1,504,017			1,504,017
Rikonstruksioni i shkollave të Bashkisë	306,520			306,520
Rikonstruksioni i hyrjes së godinës së Bashkisë	523,582			523,582
Rikonstruksioni i murit mbajtës të shkollës 9-vjeçare Labovë e Poshtme 9120 (1)	788,646			788,646
Rehabilitimi i murit mbajtës të çezmës Gugumi, Nivan Zagorie	97,200			97,200
Totali	303,557.55 1	2,175,387	0	305,784,593

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Aneksi 3.5 Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”

000/lekë

Rrugë rrjete vepra ujore (kosto historike) sipas inventarit fizik	Gjendja 01.01.2023	Shtesa	Pakësime	Gjendja 31.12.2023
Kolektor i ujërave të Zeza	1,776,956			1,776,956
Ujësjiellësi Lagjia Kodër	2,054,335			2,054,335
Sistemim Asfaltim Qendra e Qytetit	32,025,644			32,025,644
Sistemim Asfaltim Rruga Hoxhallarë	15,058,535			15,058,535
Rruga e Lagjes Teqe	5,930,000			5,930,000
Rruga e Lagjes Marinë	11,745,572			11,745,572
Rruga Çuprel	5,648,339			5,648,339
Rruga Krakull-Agallinj	1,495,505			1,495,505
Kendi Sportiv	585,000			585,000
Rruga Lagjia Kalista	3,976,810			3,976,810
Ndërtim Ure	49,630			49,630

Pikë grumbullimit mbeturina	170,744		170,744
Pikë grumbullimi	44,884		44,884
Rruga Shkolla e mesme Kala	31,875,761		31,875,761
Murr Mbajtës Rruga Hoxhallarë	75,984		75,984
Rikonstruksioni i Kapitazhi Zhepës	4,975,663		4,975,663
Rikonstruksioni i Ujësjetës Bulo	950,739		950,739
Varrezat Publike	1,273,605		1,273,605
Varrezat e dëshmorëve	894,589		894,589
Kanali ujërave të bardha lagja Krakull	2,872,247		2,872,247
Rruga Kroj i Hoxheve	144,000		144,000
Rruga Hoxhallare Kroj Shtogjeve	1,994,681		1,994,681
Rruga Teqemehallë - Gjataj	447,996		447,996
Rruga Loçan	10,792,572		10,792,572
Rruga te Kisha	196,900		196,900
Depo Uji	4,413,578		4,413,578
Rikonstruksion i pjesshëm i Ujësjetës	663,120		663,120
Rruga te Fane Beqo	197,400		197,400
Rruga te përroi i Sinan Ruçit	146,000		146,000
Rruga Teqemehallë	4,967,399		4,967,399
Ujësjetësi Hoxhallarë	233,000		233,000
Rruga Çaushlinj	399,818		399,818
Urë te Varrezat Marine	21,000		21,000
K.U.B te Bujo Isufati	40,100		40,100
Rikonstruksion rruge të brendshme	5,678,924		5,678,924
Rikonstruksion rrjeti të brendshëm elektrik	1,198,890		1,198,890
Rrugë rurale Labovë e Poshtme	2,540,362		2,540,362
Ura Labovë e Poshtme	1,279,040		1,279,040
Rruge rurale Nepravisht i sipërm	1,728,740		1,728,740
Rrugë të brendshme Nepravisht i sipërm	2,659,019		2,659,019
Çesma Nepravisht e Poshtme	434,276		434,276
Rruge rurale Nepravisht e Poshtme	32,310,651		32,310,651
Ujësjetësi Nepravisht	222,880		222,880
Ujësjetësi Stegopol	9,172,088		9,172,088
Rrugë të brendshëm Stegopol	598,412		598,412
Rruga Suhe-Stegopol	20,768,035		20,768,035
Ujësjetësi Suhe	961,664		961,664
Rrugë të brendshme Suhe	1,802,951		1,802,951
Rrjeti i ndriçimit rrugor Suhe	192,000		192,000
KUZ Drino	167,000		167,000
Ujësjetësi Drino	7,904,100		7,904,100
Rrugë të brendshme Drino	363,105		363,105
Rikonstruksioni i rrjetit të ndriçimit rrugor	636,000		636,000
Ura Bulo	16,210,935		16,210,935
Rrugë rurale Bulo	1,026,285		1,026,285
Rrugë të brendshme Bulo	1,282,298		1,282,298
Rrjeti i ndriçimit rrugor Bulo	372,727		372,727
Rrugë të brendshme	485,389		485,389
Rrugë të brendshme	335,327		335,327
Kanali Ujitës i Cinit	6,548,126		6,548,126
Rikonstruksion Rruga Kthesa e Lab-Lab e Kryqit	142,221,948		142,221,948
Rezervuari Suhe	3,538,925		3,538,925
Suhe Valare Gjokastër (Rezervuari, Suhe Cine, Dofti)	21,311,788		21,311,788
Ujitja me Rezervuari Labovë	986,540		986,540
Ujitja me lumin Suhe	4,362,142		4,362,142
Rikonstruksioni i KUB Stegopol	345,600		345,600
Rikonstruksioni i rruga e kthesës-Ura e Suhes Lot I	58,216,850		58,216,850
Rikonstruksioni Depo Uji Bulo	200,533		200,533
Rehabilitim i kanaleve Rezervuari Lot II	15,202,065		15,202,065
Rrugë të brendshme Labovë e Sipërme	974,601		974,601
Rikonstruksioni rrugës kthesa e Nepravishtës - Fushë Nepravishtë	12,739,770		12,739,770
Skema Ujitëse Suhe Vazhdim Mbarim	20,362,890		20,362,890
Rruga Nivan-Hoshteve	5,000,000		5,000,000
Rruga Nivan-Topovë	5,000,000		5,000,000
Ujësjetësi Sheper	3,500,000		3,500,000
Ujësjetësi Nivan	2,500,000		2,500,000
Kanalizim Ujrash të Zeza/Bardha	3,703,464		3,703,464
Rezervuari Sheper	4,542,274		4,542,274

Kanalet Ujitëse Sheper	4,689,740			4,689,740
Kanalet Ujitëse Poliçan	986,790			986,790
Vlerë Tjetër	8,296,835			8,296,835
Rikonstruksion Qendra e Fshatit Sheper	1,846,320			1,846,320
Rikonstruksion i rrugëve të brendshme	3,822,913			3,822,913
Rikonstruksioni i ujësjellsave	623,340			623,340
Rikonstruksion i Çezmës Libohovë	108,626			108,626
Shërbime tek kanale kulluese të dyta	246,164			246,164
Rikonstruksioni i ujësjellësit të fshatit Bulo	490,560			490,560
Rikonstruksion i vatrave të kulturës Zagori	990,296			990,296
Rikonstruksion i rrjetit të jashtëm të ujësjellit Libohovë dhe Suhë	1,257,780			1,257,780
Sistemim i ujrave të zeza të fshatit Drino	602,171			602,171
Rikonstruksioni i rrjetit të ndriçimit publik në lagjen Hoxhallarë dhe Çuprel Libohovë 1110 (1)	541,639			541,639
Rehabilitimi i skemës ujitëse të Bulos si dhe kanalit kullues K-1-76 Fushë Nepravishtë 1110 (1)	37,213,245			37,213,245
Ndërtim hidranti	99920			99920
Rehabilitimi i një pjesë të ujësjellësit Stegopul	99600			99600
Rehabilitimi i çezmes së rezervuarit Sheper	99600			99600
Rikotsruksioni i ujësjellësit Suhe	1,173,168			1,173,168
Mbikëqyrje punimesh “Sistemimi i ujërave të zeza dhe të bardha fshati Nivan Zagori”	106,000			106,000
Ndriçimi marine	816,000			816,000
Totali	633,837,427			633,837,427

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë.

Aneksi 3.6 Llogaria 214 “Instalime teknike, pajisje vegla pune”

Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune (kosto historike) sipas inventarit fizik	Gjendja 01.01.2023	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2023
Fikëse zjarri	3,500			3,500
Fikëse zjarri	3,500			3,500
Amplifikator	65,000			65,000
Mikrofon + stativ	70,000			70,000
Organo elektrike	123,000			123,000
Bateri	150,000			150,000
Saksofon	25,098			25,098
Prozhektor pistolette	12,558			12,558
Mjet JCB Skrep	4,018,800			4,018,800
Aparat Ripërsëritës	250,000			250,000
Ripërsëritës Televiziv Satelitor	380,000			380,000
Elektro pompë	170,000			170,000
Çisterne Plastike	40,000			40,000
Çisterne 5 KË	60,000			60,000
Pomp Uji	118,800			118,800
Elektropompë ujësjellës NP	1,296,048			1,296,048
Panel elektrik NP	217,600			217,600
Pompa Suhe	1,002,250			1,002,250
Fikëse zjarri	35,880			35,880
Vlerë Tjetër	742,167			742,167
Kontenier	930,000			930,000
Set i kuzhinës (sobë furrë, pjekje lavaman lavastovilje)	432,000		432,000	Transferuar qarkut
Frigorifer banak	211,200		211,200	Transferuar qarkut
Frigorifer të mëdhenj	408,000		408,000	Transferuar qarkut
Lavatriçe profesionale	576,000		576,000	Transferuar qarkut
Kaldaj pa kalorifer dhe tubacion shpërndarës	810,444			810,444
Kontenier mbeturinash	280,800			280,800
Kontenier mbeturinash	298,800			298,800
Kosha plastik	36,000			36,000
Kosha metalik	465,600			465,600
Stola druri		1,774,800		
Kosha mbeturinash		480,000		
Kosha plastic te vegjel		1,470,000		
Totali	13,233,045	3,724,800	1,627,200	15,330,645

Burimi: Bashkia Libohovë

Aneksi nr.3 – Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm trajtuar nga faqja nr.58 deri në faqen nr.64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Pasqyra e realizimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

Nr	Emërtimi	Rekomandimet në numër:				Nga rekomandimet gjithsej: Sa me dëme ekonomike:							
		Rek. gjithsej	Nga rekomandimet janë:			Rekomanduar Gjithsej		Zbatuar arkëtuar		(Në proces)		Pa zbatuar	
			Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Proces zbatimi	Pa zbatuar	Nr. pers	Nëmijë/lek	Nr. pers	Nëmijë/lek	Nr. pers	Nëmijë/lek	Nr. pers
1	Masa organizative	24	9	1	14								
2	Shpërblim demi	2			2	3						3	313
3	Masa efekt adm. e fondeve publike	1			1								
4	Masa për uljen e borxh tatimor	2			2								25,363
5	Masa disiplinore	2	2										
	Totali	31	11	1	16	3						3	25,676

Nga rekomandimet gjithsej: Sa për eliminimin e efekteve negative				
Rek. Gjithsej	Zbatuar	Në proces	Pjesërisht	Pa zbatuar
Në mijë/lek	Në mijë/lek	Në mijë/lek	Në mijë/lek	Në mijë/lek
5,962				5,962

Burimi: Bashkia Libohovë

Për sa më sipër paraqitet Raporti Përfundimtar i Auditimit.

KONTROLLI I LARTË I SHTETI